**76** "Interior Minister (Xhafer Deva) denied the German request, and informed the Jewish leadership that Germans had accepted his decision (not to supply the list) and was not necessary to supply it. It matters little which version is accepted as the result was the same, i.e., the Albanians stood up to the Nazis and denied them the list…(Deva) assured them that as long as the Albanian Government had any power, they had nothing to be afraid of. The subsequent events showed the veracity of this statement". H. Sarner, op. cit., pp.42-43.

(Note: Encouraged by this outcome, the Albanian Government rejected a second Nazi demand, refusing to adopt the worthless "occupation mark". A third request involving the consigning to German authorities of the gold reserves of the Bank of Albania, at that time held in Rome (Italy) "as a precautionary safety measure ", was also denied. The Germans, however, took possession of those reserves, since at that time (October 1943), Rome was under German occupation. The gold reserves were finally found in Germany, in 1945, and were returned to Albania after 50 years).

**77** Quoted by A. Kotani, The Hebrews…, p. 79.

**78** Archives. Box 153 (1944) File 152, pp. 23-24. Also: Box 152/2 (1944) File 223, pp. 166-169.

**79** Archives. Box 153 (1944) File 172, pp. 9, 18, 20, 21, 23, 25, 26, 27. Here, an explanation is necessary. The Albanian historian, Sh. Sinani provides us with the following information: "Several versions claiming '…it is true that (in 1942) the Albanian Waffen SS "Skanderbeg" Division turned over some 200 Jews in Kosova to the Nazis…' have not been confirmed. Furthermore, the dates given (1942) do not stand up to the scrutiny of the facts. The "Skanderbeg" Division was formed in Spring, 1944, and the Bergen-Belsen – where those prisoners were supposed to go – did not exist in 1942. In addition, stresses Sinani, quoting Dr. Michele Scarfatti (Director of the Jewish Center for Contemporary Documentation (Milan,Italy) '…regarding the deportation of the Jews from Prishtina in 1944, we must say that the information and the related documentation we now possess, indicate that the arrests were done by the "Skanderbeg" SS Division under the direct order of the German authorities, without any involvement on the part of the authorities of Tirana' ("Grazie Albania", Bota Shqiptare, January 27-February 9, 2006).

"And now? Two years ago (2005) Dr. Altskin, a researcher at the U.S.Holocaust Museum, handed me a document of the U.S. Army, dated 1947, together with a photocopy of the original in German, as part of a correspondence stretching between 1943 and 1944. The document reads: 'NOKN-General-Slave labor, p. 27, WIII, Abwehrlage (Situation of defense), point 4, Verhaftuingen (arrests): The SS Division arrested 510 Jews, communists, helpers of partisans (Bandenhelfer), and persons suspicious in political respect (politische Verdachtinge). They were taken in custody (Sichorung-verwohrung) in the division's prisoner camp, and 249 of them were transported to Germany's labor camps (?).'"

Sinani was precise and transparent when he wrote: "(The confusion, intentional or not)…comes to an end with the discovery of the transportation lists ("Tranportliste") prepared in Prishtine, exactly in August 1944. In this document, the SS Division "Skanderbeg" was in charge of 'Transport des communisten und partizanen'. The list is found in the Archives, Box 153 (1944) File 172, pp. 10-38. The first part of the list contains 239 names. The second part of the list contains 249 names. In addition, there are two annex-lists, as part of the same operation mentioned in the document of MMS. The SS Division "Skanderbeg" has accompanied them (neither delivered nor executed) to the Saimiste concentration camp, near Belgrade, (not to Bergen-Belsen). In the

original, next to each name there is a number." (*There are 32 names of Jews altogether.* S.R.)

"It results that the number of deported Jews accompanied by the SS Division "Skanderbeg" is 32. The list contains 519 names (both lists and the two annexes) The rest of the deportees are Albanians, arrested as communists, partisans, and anti-Nazi elements also a few antifascist Serbs and Montenegrins. There are no Roma (gypsies) in this list, nor other categories condemned to disappear by the Nazi racist doctrine of the "final solution". Sh. Sinani. "Albanians and the Shoah…" pp. 6-8)

**80** Johanna (Gerechter) Newmann. "A Tribute to the Albanian People", LIRIA (Boston) April 1995, p. 7.

**81** A. Kotani, The Hebrews…, p. 88-89.

**82** Archives. Box 152 (1944) File 223, pp. 166-169.

**83** The Arditi Family was arrested in Shkoder and deported. They were killed on the way to the Mathausen Nazi camp. With them were also the 17 year old student Zyhdi Repishti, and the 30 year old dentist Alush Dibra, two non-Jewish communist sympathizers.

**84** H. Sarner. op. cit., p. 46.

**85** Bashkimi (Tiranë), June 7, 1945, p.1 (Translated by Stephen Schwartz)

**86** "Albania Tolerates its 300 Jews, pretending they do not exist", Oct. 11-17, 1973, p. 21.

**87** Ministry of Foreign Affairs (of Albania) Archives. Year 1950 File 128, dated 18 November, 1950. "The Political Department to the Albanian Legation in Moscow." …If a request is made by the Israeli Legation regarding the repatriation of Albanian Israelis, your answer should be that this problem does not exist for the Government of the PR of Albania…"; and on May 26, 1951: " The Political Department to All Legations"…In Albania, there are a few Israelis with Albanian citizenship who have asked to return to Israel, and since their political attitude in general is not good, this problem, at this time, is not under consideration…"

**88** The General Directorate of Archives of the Republic of Albania, Tirana, Albania, Guidebook (Pegi: Tiranë, 2006) Introduction, p. VI.

**89** H. Sarner, op. cit., 69, quoting the Encyclopedia Judaica. See also Note 86.

**90** The New York Times, April 11, 1991, p. 4. Also: Mark Lieberman. "They feel very strongly that they are Albanian citizens – and they are extremely proud of that fact. What we can do, and are doing, is to help them discover their buried Jewish roots. "The Jews of Albania" quoted by Merry Ukraichik in: Illyria (N.Y.) Dec. 6, 1995, p. 5.

**91** Sh. Sinani, "Albanians and the Shoah…" p. 3.

**92** Second Part. Index of Names. pp. 90-202.

**93** Sh. Sinani, "Albanians and the Shoah…" p. 3.

**94** Quoted by Sami Repishti. "Albanians Protected the Jews During the World War II", Illyria (N.Y.) May 9, 1992, p. 6.

**95** "Jews to Albanians: Thank you!" Illyria, #370, 6 August, 1995, p. 7.

**96** Quoted by Marjorie Senechal. "Jews and Albanians: A personal view", LIRIA (Boston) August 1995, p. 5. "Albania was the only country in Europe which had a larger Jewish population at the end of the war (WW II) than before it." Miles Lerman, Director, US Holocaust Memorial Museum. The statement was also repeated by Michael Berenbaum, director of the Research Institute.

**97** Ened Janina. "Sofer: You cannot imagine…" Shekulli (Tiranë), 11 mars 2006, p. 1.

**98** See: Rilindja (Geneva, Switzerland) January 30, 1996, p. 1.

**99** Abraham Foxman. See: Illyria (N.Y.) Nov. 11, 1997, p. 3.

**100** Illyria (N.Y.), September 6-8, 2005. As early as 1999, J.Goldfarb wrote: "The predominantly Moslem country, where religious differences have always been played down, shielded its own Jewish community so vigilantly that not one single Jew, foreign or Albanian, fell into the hands of the Nazi occupiers." See: New Jersey Jewish Press, April 8, 1999, p, 21.

**101** "BESA (The Sacred Pledge) among the Albanian People", SFIDE (Tiranë 2007), pp. 150-153.

**102** Joseph Jakoel, "What was Albania for the Jews?" Illyria (N.Y.) Jan. 29, 1995, p. 16.

**103** Stephen Schwartz: "The remarkable spirit of tolerance that has been the hallmark of interfaith relations in Albania has played a major role in the treatment and the position of the Albanian Jewry…a fascinating relationship." See. S. Repishti, op. cit., p. 7.

**104** Rabbi Chaim Hoffman, op. cit., p. 21. In 1994, the Very Rev. Father Arthur E. Liolin, chancellor of the Albanian Orthodox Archdiocese in America, wrote:" …Both have tasted of collective tragedies and suffered the harsh judgment of stereotypes, whose harm has sheathed their psyche with the defensive armor of cohesiveness…Grief and genocide have been the lot of one, assimilation and derision have been the lot of the other. The two continue to strive in transcending untold humiliation…May their deeds be blessed by God and remembered and imitated by all." "Of Albanians and Jews", Illyria, (N.Y.) Feb. 6, 1994, p. 5.

A century and a half before, the father of modern Albania, Ismail Kemal Vlora, in his capacity as Turkish Governor of the Province of Tulcea (Romania) during 1867-71, described the situation of the Jews of Romania during his tenure: "They had neither the right to own or cultivate land, nor to reside in rural communities. They were not permit-ted to exercise the commerce that they wished, were obligated to live by humble means, and were subject to the worse persecutions. After the year 1866, these persecutions became so frequent and cruel that they finally shook the conscience of the civilized world. We, being the closest witnesses of these atrocities could no longer remain indifferent to the sufferings of these unfortunate people, and recognized the humane duty to help them…

It is unfortunate and criminal to vex and persecute an entire people only because of their origin and race…The Jews of Romania and Russia are not humiliated because (of the inferiority) of their race, blood or religion, but because of the laws of the countries where they live. It is the restrictions imposed upon their actions that oblige them to live in the way they presently do… These considerations, coupled with the respect that all Mos-lems owe to the race from which have derived the truths of all religions, and all the knowledge owned to humanity through revelation, prompted us to seek some solution to the unfortunate situation of the Jewish people in Romania." MEMOIRS. (Constable and Co. Ltd.: London, 1922, p. 72 (Courtesy of Agron Alibali). Illyria (N.Y.) June 11, 1997, p. 5).

**106** The late Bishop Fan S. Noli, head of the Albanian Orthodox Archdiocese in America, in a Sermon to the faithful delivered in the Albanian Orthodox Cathedral of Boston, Ma., had this to say: " Both Israel and Albania are two small countries. Both of them have ancient roots. Both have a history of toil and suffering. And, both have preserved their respective identities and cultures, in the face of numerous challenges and crises over the centuries. These similarities form a common bond between the Jews and the Albanians." Quoted by Peter R. Prifti, "Review of a Book Review". (Paper: 2006), p. 4 Unpublished.

The Israeli Prime Minister, Shimon Perez, addressing his Albanian guests in Jerusalem in 1995, summarized it: "Geography divides us, but history unites us."

Kristaq Jorgo
Fakulteti i histori-filologjisë
Universiteti i Tiranës
kristjorgo@yahoo.com

# Mbi identitetin etnik të Millosh Gjergj Nikollës
# About Ethnic Identity of Millosh Gjergj Nikolla

*"Ai që i thotë jo, vetvetes nuk mund t'i thotë po Zotit."*
**Hermann Hesse**, "Lexime të çastit"

*"Véri frynë pa mshirë, si veri që frynë;*
*unë i a mbylla derën t'eme me rreze mos të hyjnë*
*me m'a fikë ket dritë*
*me m'a ngrî ket shpirt*
*me m'a dridh për ndjesijë tjetër*
*me m'a joshë me andërr të vjetër."*
**Migjeni**, "Kangë në vete"

**I.**

Në esenë e vet "Poshtërimi në Ballkan", Ismail Kadare ndër të tjera shkruan:

"Loja me prejardhjet është, jashtë çdo dyshimi, një nga kotësitë foshnjarake ballkanike. Por kjo nuk do të thotë aspak se provokimi vetë, mund të quhet foshnjarak. […] Shqiptarët nuk janë aspak të mbrojtur nga ethe të tilla. Shembulli i prejardhjes të hamendësuar joshqiptare të Migjenit është një nga më kuptimplotët. Ajo ka qenë për një kohë të gjatë tabu. Të thuhej se Millosh Gjergj Nikolla, ishte me zanafillë joshqiptare, me sa dukej malazeze, kjo merrej si fyerje. Në të vërtetë, jo vetëm nuk ka asnjë fyerje, por ka qenë nder për botën shqiptare, që mundi të magjepste e ta bënte të vetin një nga talentet më të mëdhenj të kohës. Rasti i Migjenit tregon se universi shqiptar bashkë me gjuhën shqipe, ai univers e ajo gjuhë që ne e kemi bërë zakon ta shkelim me këmbë, ka fuqi thithëse e integruese tepër të fortë. Migjeni, për nga prejardhja, për nga studimet, e për nga gjuha, mund të ishte një shkrimtar jugosllav. Vendi fqinj mund t'i jepte atij hapësirë e mundësi, në dukje, më të madhe se Shqipëria e sertë, e varfër dhe kryeneçe. Por ai, jashtë çdo përfitimi, madje kundër tij, e bëri zgjedhjen e vet. Ajo zgjedhje ishte rrënjësore, e sinqertë, e plotë. I dashuruar "tragjikisht", siç shkruan, pas botës së shqiptarëve, (ka gjasë që viset e Perëndimit, për të cilat ai kishte gjithashtu një "dashuri tragjike", iu dukën më të kapshme nëpërmjet Shkodrës së shqiptarëve sesa zonës sllave), Migjeni nuk e kujtoi kurrë zanafillën e vet. Do të mjaftonte kjo që, në qoftë se dikujt duhej t'i mbetej hatri (në këtë gadishullin tonë hatërmbetës), këta do të ishin malazestë e jo shqiptarët. Askush nuk ka të drejtë t'i kërkojë askujt pohimin apo mohimin e prejardhjes së vet. E drejta e pohimit është po aq e ligjshme sa ajo e mohimit."[1]



Ky citat reflekton në mënyrën më të përmbledhur e më të qartë spektrin pothuaj 80-vjeçar të qëndrimeve të opinionit shkencor e të atij publik në përgjithësi lidhur me identitetin etnik të Millosh Gjergj Nikollës – Migjenit (1911-1938): ekzistencën e pikëpamjeve të ndryshme mbi këtë çështje (prejardhje shqiptare ose joshqiptare: malazezo-maqedonase), dominimin kohëgjatë të njërës pikëpamje, të së parës mbi tjetrën, ashpërsinë me të cilën ato janë ndeshur, rëndësinë shumë të madhe që i është dhënë çështjes, ndikimin shumë të fortë të kontekstit politiko-nacional mbi të, si dhe relativizimin që ftohet t'i bëhet asaj, duke nënvizuar karakterin personal e jo publik të problemit si dhe parëndësinë e tij thelbësore krahasuar me identitetin letrar padyshueshmërisht shqiptar të Migjenit, duke e parë zgjidhjen në pranimin e pikëpamjes së 'dobët', të tezës mbi prejardhjen joshqiptare të poetit që shihet si më e gjasshme, por duke pranuar njëherësh edhe sigurinë jo fare të sigurt e qartësinë jo krejt të qartë që, siç duket, vijon të mbretërojë mbi çështjen ende sot.

**II.**

Së pari, ne duhet të qartësojmë kuptimin që do t'i jepet këtu termit *identitet etnik*.

Dallojmë dy përbërës nga pikëpamja e subjektit bartës: *identitet etnik individual* dhe *identitet etnik grupor* si dhe tri nivele, shkallë a gradë të shfaqjes së tij: *identitet etno-kulturor*, *identitet etno-social*, *identitet etno-shpirtëror*.

Në trajtë të thjeshtëzuar këto shkallë mund të paraqiteshin kështu: *grupi/individi i ç'prejardhje është, grupi/individi ç'thotë/ç'thonë se është, grupi/individi ç'ndjehet intimisht se është*.

Debati mbi përkatësinë etno-identitare të Millosh Gjergj Nikollës ka marrë jetë më së shpeshti nisur prej një përfytyrimi që e sheh çështjen a konceptin e identitetit etnik si një

të dhënë të fiksuar, të thjeshtë e statike, ndërkohë që kemi të bëjmë me një gjendje-proces, të përbërë dhe dinamik.

Kombi konceptohet sot njëzëshëm si një bashkësi sociale, përkatësia në të cilën e grupit a e individit, pra identiteti etnik i tyre është rezultat i proceseve të socializimit dhe edukimit të entitetit më të madh mbi entitetin/entitetet më të vogël/vegjël ndërthurur këto me proceset e përfytyrimit/vendimit që këta të fundit – individi, familja, grupi, kombi – kanë/fitojnë/marrin për vete dhe për të tjerët.

Në këtë kuptim, përkatësia etno-identitare e çdo entiteti, njëherësh sa `trashëgohet´ a fitohet, aq ndërtohet e vetëndërtohet. Ndërtimi e vetëndërtimi i ndjenjë-vetëdijes së përkatësisë së caktuar etno-identitare mund të çojë ose në fuqizimin ose në dobësimin apo edhe braktisjen e saj për hir të një tjetre. (Me këtë të fundit nuk kemi pa dyshim parasysh një akt krejt arbitrar, krejt të pashkak a krejt të përnjëhershëm).

Vështruar në këtë kontekst kanë po aq rëndësi dhe nuk mund të shihen ndarazi përbërëset e identitetit etnik: ajo etno-kulturore apo fondi themelor i tipareve etnike (grupi/individi *i ç'prejardhje është*) – elementi bazal, përbërësja etno-sociale (grupi/individi *si paraqitet, ç'thotë/ç'thonë se është*) – elementi performativ dhe përbërësja etno-shpirtërore (*grupi/individi ç'ndjehet intimisht se është*) – elementi dinamizues.

Në një moment të dhënë një një individ a grup, nën tërheqjen, miklimin, pranimin, ndikimin, detyrimin, shtrëngimin a dhunën e rrethanave të caktuara mund të fillojë të ndjehet i ndryshëm nga ç'është ndjerë, (më tej) të shpallet i ndryshëm nga ç'është shpallur dhe (me kohë edhe) të bëhet i ndryshëm nga ç'ka qenë. Kemi në këtë rast procesin e *akulturimit etnik*. Ashtu siç mund të ndodhë edhe procesi i përkundërt – ai i *rikulturimit etnik*, i rikthimit në identitetin e hershëm, njëherë – individualisht dhe/ose kolektivisht, pjesërisht a plotësisht të braktisur.

Nëse do të ishte trajtuar nga kjo perspektivë problemi i identitetit etnik të Millosh Gjergj Nikollës, atëhere nuk do të ndodhte që ai të reduktohej në pohimet e tipit *Migjeni i ç'prejardhje është / nuk është*. Përmes këtij reduktimi janë bërë në thelb të papërdorshme apo janë harruar edhe një varg dëshmish të botuara, të cilat në mënyrë të qartë jepnin informacion të dorës së parë mbi identitetin etnik të poetit.

Megjithatë, përtej arsyes së reduktimit të problemit a kërkimit të një përgjigjeje të thjeshtë, fakti që paqartësia a më mirë fuqia e paplotë e njerës pikëpamje a e tjetrës për të triumfuar plotësisht e jo ndërmëdyshazi ka mbijetuar kaq gjatë, dëshmon se të dhënat mund të kenë qenë/jenë jo të plota, një pjesë prej tyre ambige dhe problemi në thelb pak më i ndërlikuar se ç'mund të jetë pandehur.

**III.**

Duke mbajtur parasysh *strukturën e trefishtë* të identitetit etnik, për të cilën sapo u fol, bëhet e vetëkuptueshme se një përgjigje krejt e qartë e pyetjes mbi identitetin etnik të Millosh Gjergj Nikollës – Migjenit (ashtu si të çdo individi papërjashtim) apo më saktë një konfirmim absolutisht i pakundërshtueshëm i njërës a tjetrës pikëpamje apo i një pikëpamjeje të ndërmjetme, nuk duhet të kërkohet e nuk mund të pretendohet jashtë dëshmive të drejtpërdrejta të personit në fjalë, të cilat, veçanërisht në rastin e personaliteteve të mëdha e atyre krijues në mënyrë të posaçme, mbeten përcaktuese.

Dëshmi dokumentare, në të cilat Migjeni të shprehet mbi identitetin e vet etnik nuk ka, ose të tilla nuk na kanë mbërritur; kemi ndërkaq dëshmi të tërthorta, të të tjerëve, por këto mund të shërbejnë vetëm si mbështetëse të dëshmive të drejtpërdrejta e do të parashtrohen vetëm më pas.

Ekziston ndërkaq një *dëshmi e drejtpërdrejtë, veçse specifike dhe potenciale* – dëshmia *letrare*, e cila interpretohet tri mënyrash:

1. Sipas pikëpamjes mbizotëruese, të parashtruar e të mbështetur nga pjesa më e madhe e studiuesve, vepra letrare e Migjenit flet në mënyrë të qartë për identitetin etnik shqiptar të autorit të saj, e shënjuar e tëra, veç shprehjes gjuhësore, nga një tematikë, problematikë e frymë shqiptare e dalluar: "Vepra e tij nuk na lejon të dyshojmë për origjinën shqiptare të Migjenit. Këtë ajo e vërteton dhe e sqaron pasi është kryesisht me frymë, ndjenja dhe dashuri shqiptare, për njeriun shqiptar."[2]

2. E kundërshton këtë tezë një rrymë e mendimit kritik, e ngushtë por me një përfaqësues të shquar: Arshi Pipën. Sipas Pipës: "Ai (*Migjeni-K.J*) nuk e dinte shqipen mirë. Tekstet e tij janë të mbushura me gabime ortografike, madje elementare, dhe sintaksa e tij është larg të qenit shqipe tipike. […] Prandaj, mund të pohohet se, nëse Migjeni i takon letërsisë shqipe në sajë të gjuhës në të cilën ai shkruan, stili dhe skeleti i mendjes së tij janë thelbësisht sllavë. Ndeshemi me një fenomen të hibridizmit kulturor: shpirtin sllav që flet shqip."[3]

Përpos kësaj, sipas Pipës, çështjen e identitetit të tij etnik Migjeni e tematizon në mënyrë eksplicite në poezitë e ciklit "Kangët e Përndimit".

3. Së fundi, sipas një pikëpamjeje, e cila njëherësh pajtohet me - e njëherësh kundërshton të dyja të parat, Migjeni nuk është shprehur asnjëherë në veprën e vet mbi prejardhjen e tij etnike, me gjasë joshqiptare: "[…] Migjeni nuk e kujtoi kurrë zanafillën e vet."[4]

**IV.**

Dëshminë letrare e cilësuam të drejtpërdrejtë, *por* potenciale dhe specifike. Potenciale në kuptimin jo doemos të pranishme; specifike në kuptimin jo imediatisht të lexueshme.

Këtu bëhet i detyrueshëm një zgjerim i fokusit të problemit.

Vlerësohej para gati tri dekadash se: "... lidhur me veprën letrare të Millosh Gjergj Nikollës – Migjenit, mbetet të bëhet edhe shumë. Aq më shumë kur dihet se, edhe përpos opusit të vogël të vëllimit letrar migjenian, ne sot e tërë ditën akoma nuk kemi kritikë, mendim, për secilën vjershë dhe novelëz-tregim të tij."[5]

Ky vlerësim mund të pësëritej me ndryshime të pakta dhe sot. Arsyet e një gjendjeje të tillë, ndërkohë që marrë *in toto* ndihmesat në fushë të migjenologjisë janë rritur ndjeshëm, mund të jenë disa. Kryesorja sipas nesh, sa i takon sidomos studimit të poezisë së Migjenit është e rendit metodologjik dhe ka të bëjë me raportin që kritika ka vënë që në gjenezë dhe trashëguar pastaj besnikërisht deri në ditët tona me veprën e Millosh Gjergj Nikollës.

Ky raport apo më saktë kjo paradigmë, pothuaj të gjitha kontributet mbi veprën e Migjenit, sado të dallueshëm në vështrim të parë, përpos të gjitha varianteve në të cilat shfaqet, mund të mblidheshin në një paradigmë të vetme, në paradigmën e *mimes-it*: vepra si pasqyrim i jetës intime të poetit, si pasqyrim i botëvështrimit të tij[6], si pasqyrim i realitetit historiko-shoqëror të kohës në të cilën ai ka jetuar, ose si pasqyrim i ndërthurur i dy a tri përbërësve: jetë, botëvështrim, realitet.

Është besuar ndër të tjera kjo perspektivë leximi do të ndihmonte në interpretimin e veprës dhe se do të shërbente të nxirrnim prej saj njëherësh maksimumin e informacionit mbi jetën dhe botëvështrimin e autorit.

Që këtej ajo 'mosdëshirë' për t'ia nënshtruar analizës letrare krijimet në një trajtë qartësisht të përveçuar, për ta trajtuar sidomos veprën poetike si një të tërë organike. Dhe me të vërtetë: nëse "Vargjet e lira" nuk janë gjë tjetër në thelb pos një biografi jetësore-shpirtërore e poetizuar e autorit, ç'do të na ndalonte, madje ç'nuk do të na shtynte të bënim një të tillë lexim.

Rezultati i një qasjeje të tillë mund të përmblidhej në një fjalë të vetme: varfërim i veprës, i domethënies estetike të saj.[7]

Ne kemi bindjen se kjo qasje themelore metodologjike ka sjellë edhe një rezultat të dytë, në të vërtetë aspak të pritshëm: varfërimin po ashtu, madje shtrembërimin e informacionit biografik e botëkuptimor mbi individin Millosh Gjergj Nikolla si dhe të informacionit historiko-shoqëror që ato, poezitë, mund të mbajnë ndryrë në vete.

Në këtë lloj paradigme nuk ka në vetvete asgjë kundërshkencore dhe ajo vijon të mbrohet edhe sot nga autoritete në lëmë të teoririsë së letërsisë e të poezisë lirike posaçërisht. Problemi nis kur një qasje e tillë absolutizohet, domethënë kur leximi i botës poetike bëhet p.sh. përmes grilës së të dhënave të botës reale, çka mund të çojë dhe çon në një pjesë të rasteve në deformim të së parës nga e dyta. P.sh. nëse të nisur më fort nga paragjykimi se nga bindja që Migjeni ka një prejardhje etnike joshqiptare nisim t'i interpretojmë krijimet e poetit si refletim të tjetërsisë së tij entike apo të ambiguitetit të tij (gjithnjë të supozuar) etno-identitar. Apo nëse "të bindur„ që Migjeni nuk e njihte mirë shqipen fillojmë të shohim në çdo devijim nga normat gjuhësore jo një trajtë, me gjasë, funksionale, por doemos një gabim gjuhësor të rëndomtë etj.

Kjo nuk do të thotë se të dy botët duhen parë si të papërputhshme, por ato duhet të shqyrtohen në krye të herës si krejt të mëvetësishme. Vetëm kështu dhe vetëm nëse analiza provon që konfiguracioni i përvijuar në botën poetike të unit lirik paraqet analogji të qenësishme me konfiguracionet jetësore, botëkuptimore e të kontekstit historiko- shoqëror të botës së autorit empirik, vetëm me këtë parakusht pra mund të pretendojmë se krijimi poetik na jep të dhëna reale mbi autorin e tij.

Nga kjo perspektivë, duke u përqëndruar në veprën, në tekstin, në tekstet e veçantë, duke i përfillur ato si universe të mëvetësishëm, jo vetëm do të mund të shmangnim varfërimin e domethënies estetike të tyre, por, paradoksalisht, do të mund të shkodonim një informacion shumë më tepër të pasur dhe më të vërtetë mbi njeriun që i krijoi, mbi botëvështrimin e tij, mbi kontekstin historiko-social me të cilin vepra e tij ka lidhje të drejtpërdrejta.

**V.**

Do të përpiqemi ta njëmendësojmë e ta verifikojmë këtë pozicion tonin përmes analizës së një prej krijimeve poetike të Migjenit, poezisë "Kangë në vete". Është zgjedhur poezia në fjalë pasi mund të merret si më përfaqësuesja lidhur me çështjen në shqyrtim.

Metoda që do të ndjekim do të jetë kjo: Në krye të herës do të parashtrojmë leximet kryesore që i janë bërë poezisë "Kangë në vete" duke parashtruar kundërargumenta që çojnë në falsifikimin e tyre.

Më tej do të trajtojmë më vete kryefaktin biografik – atë të prejardhjes shqiptare – joshqiptare që pretendohet se na zbulon poezia "Kangë në vete". Do të përpiqemi ta vendosim atë në kontekstin e të gjitha burimeve që kemi në dorë.

Në fund do të parashtrojmë në vija të përgjithshme një skemë të re leximi të poezisë "Kangë në vete", skemë e cila, sipas nesh, jep një provë më shumë mbi gjenialitetin poetik të të autorit, na sqaron përfundimisht mbi identitetin etnik të tij, duke na mundësuar kështu të ndryshojmë, të korrigjojmë e të plotësojmë një pjesë të dijes sonë mbi njeriun dhe poetin Millosh Gjergj Nikolla.

**VI.**

"Kangë në vete" është poezia e vetme e ciklit homonim të vëllimit "Vargjet e lira", vëllim i cili, në botimin e parë (të papërfunduar krejtësisht) të vitit 1936 kishte këtë struk-

turë: "Parathanja e parathanjeve", "Kangët e Ringjalljes", "Kangët e Mjerimit", "Kangët e Përndimit", "Kangë në vete", "Kangët e Rinís"[8].

KANGË NË VETE

*Véri frynë pa mshirë, si véri që frynë,*
*dhe si hajn në shtëpijat e kojshive hynë*
*edhe për çudí*
*këta kojshitë e mi*
*sa mirë e presin... megjithse nuk asht ditë vere*
*ato në gjuhë të huej i thonë: mirë se erdhe!*
*Véri frynë dhe me acarim u premton pallate te kristalta*
*kojshive të mijë që u a kande shum andrrat e thata -*
*dhe u thotë kështu:*
*stërgjyshnit e ju'*
*qenë fatosa të vertetë dhe u banë flija*
*për fe dhe atdhe dhe i merituen këto premtimet e mija.*
*Dhe kojshitë e mi që i kam far'e fis,*
*nipat e stergjyshnavet meleza dhe te letë,*
*nipa donë me mbetë,*
*nipa të vertetë*
*me atdhe e fe ndër andrrat e thata*
*që t'i meritojnë premtimet e kristalta.*
*Véri frynë pa mshirë, si véri që frynë;*
*unë i a mbylla derën t'eme me reze mos të hynë*
*me ma fikë ket dritë*
*me ma ngri ket shpirt*
*me ma dridh për ndjesijë tjetër*
*me ma joshë me andërr të vjetër.*

Të shumtë janë autorët që janë marrë në mënyrë më fort a më pak të përqendruar apo kalimthi me poezinë "Kangë në vete". Ne kemi identifikuar tri skema kryesore leximi të saj. Ato do t'i parashtrojmë sipas rendit kronologjik. (Emërtimi i skemave, sado që synon të pasqyrojë thelbin e tyre, është i një natyre konvencionale).

**A. Skema psiko-intime: Arshi Pipa**

Skema e Pipës, më fort se na ofron një kuadër interpretimi të poezisë, përdor disa pak detaje të saj në mbështetje të leximit të përgjithshëm që i bëhet korpusit poetik të Migjenit. Sipas Pipës, siç del qartë prej shën.6, renditja e poezive në "Vargjet e lira„ është bërë jo sipas parimit kronologjik (të kohëkrijimit), por *sipas një parimi logjik*: " Poeti qi rrëfen ndër vargje historín e jetës së vet, Migjeni ka pasë kujdes t'u api ktyne kangëvet at zhvillim logjik nepërmjet të cilit jeta merr kuptim."

"Kangë më vete" është një refuzim kategorik i thirrjes joshëse për "andrrat e vjetra": nacionalizmi dhe feja. Për poetin e deziluzionuar nuk mbetet asgjë tjetër përveç dashurisë, të cilën ai e invokon me pasion si një strehë të fundit."[9]

"I çmagjepsun, çveshun nga flatrat përgjithmonë, shpirti pushon tash te nata, i vetëm. "Kanga në vete" asht ky monolog i lodhun. Ironija mundohet me i dhanë pak puls jetës por nuk ja del. Asht prap erë përjashta… fryn pa mëshirë. E ndërsa ajo erë u përsëritë tjervet "andrrat e thata" të lashta, në krahnorin e tij të zbrazun jehon përmortshëm. E atê e kapë friga e ja mbyllë derën e zemrës qi të mos ja fiki at fitil të mbramë drite qi i ka mbetë."[10]

Duke qenë, sipas nesh, larg thelbit të poezisë, Pipa ka ndërkaq plotësisht të drejtë kur e cilëson, si asnjë studiues tjetër, "Kangë në vete" *një monolog*, paçka se ky monolog nuk është, siç do të kemi rast të bindemi, *i lodhun*.

**B. Skema etno-politike: Dhimitër Shuteriqi, Gjovalin Luka, Vehbi Bala**

Fjalët-kyç të kësaj skeme janë *fashizëm, Jugosllavi, origjinë malazezo-maqedone e Migjenit*.

"Veç nga shoqet e vendosi poeti "Këngën në vete", që formon, tek, një ndarje më vehte në vëllimet. Aty, Migjeni padit fashizmin, që "si hajn në shtëpijat e kojshive hynë", - të "kojshive" jugosllavë. Migjeni dënon shovinizmin serbomadh, me parrullën e tij "për fe e atdhe", që gënjen njerëzit me "andrra të thata" e me "premtime të kristalta". Me fjalë të tjera, pezmatime të mëdha i presin ata jugosllavë që i çelën dyert fashizmit në vend të tyre. Sa për poetin, ky ia "mbylli derën", ky nuk u gënjye nga fashizmi:[11] "[Në vargun 13: *Dhe kojshitë e mi që i kam far'e fis*, kemi një] : Aluzion për lidhjet e gjakut që kishte familja e M[igjenit] me serbët."[12]; "Migjeni ishte prej familje ortodokse të Shkodrës e këta ortodoksë janë përgjithësisht sllavë me origjinë (malazez, maqedon etj.). Prandaj i quan "farefis" jugosllavët."[13]

Nëse, po në këtë vijë arsyetimi, "Poeti – me fjalët e Shuteriqit – është i ashpër për jugosllavët që nuk po i bëjnë rezistencë", ç'kuptim ka vendimi i unit lirik 'unë i a mbylla derën t'eme me reze"? Është ai zë i një individi, të themi i poetit, apo i një bashkësie? Sikur të marrim rastin e parë, ndeshim në kundërvënien "unë" vs. "gjithë të tjerët". ("Kojshitë" do të interpretohej me të drejtë, nga ky këndi leximi, si "bashkëkombasit e mi", të gjithë ata, pa përjashtim.) Për ta shpëtuar interpretimin nga ky qorrsokak Shuteriqi bën sqarimin e menjëhershëm: "Domosdo, e ka fjalën te udhëheqësit; këta janë që i thonë "mirë se erdhe" fashizmit". Mirëpo kundërvënia "unë" vs. "të tjerët" nuk le shteg për një veçim të tillë. Pastaj, do të mund të pyetej, po individë të tjerë, si Migjeni, me lidhje farefisnie me kojshitë sllavë, ç'qëndrim mbajnë ndaj "Vérit"? Nëse uni lirik është, në të kundërt, zëri i një bashkësie, kjo mbetet të jetë ajo shqiptare. E tëra, pa përjashtim? "Domosdo, *nuk* e ka fjalën te udhëheqësit?", do të mund të "përgjigjeshim" me Balën.

Kryesorja është që, në asnjë prej poezive të Migjenit, uni lirik në trajtën "unë" nuk del si përfaqësues i një grupi. Për këtë poeti përdor trajtën e shumësit "ne/na".

Ne nuk e dimë datën e krijimit të poezisë, por me siguri ajo është redaktuar jo më vonë se fundi i 1935-s. Pak si vështirë që Migjeni, ashtu si pothuaj gjithkush në këtë kohë, të ketë intuituar realisht rrezikun e ideologjisë e të politikës fashiste. Ky u bë i qartë për shumëkënd e për poetin vetë veçse më vonë. Edhe prozat me temë antifashiste të Migjenit janë ndër të fundit krijime të tij.

Sa i takon *stërgjyshnave* sllavë, kur ata u shfaqën në këto anë, Perandoria Romake e Perëndimit tash thuajse nuk ekzistonte më. Më tej, feja e Perandorisë Romake ishte tjetër nga ajo e 'farefisnave sllavë'. Për 'atdhe' të përbashkët aq më pak mund të bëhet fjalë. E nëse duam ende të këmbëngulim në këtë skemë, duke kërkuar në një tjetër drejtim, në një *Véri* tjetër, nazist atëbotë, shtrohet sërisht pyetja e thjeshtë: Ku është lidhja e vjetër 'për fe e atdhe' e *stërgjyshnave* sllavë me *stërgjyshnat* 'arianë'? Për cilën fe e për cilin atdhe të përbashkët të paradisa-shekujve bëhet fjalë? Është fare e qartë që edhe vetëm këto vërejtje janë të afta të rrëzojnë kryekrej skemën interpretuese të Shuteriqi-Lukajt.

**C. Skema urbano-ideologjike: Moikom Zeqo (Petro Janura)**

Kjo skemë lind në përpjekje për të shmangur 'thelbin kompromentues' që është në bazë të skemës paraardhëse, atë të prejardhjes 'joshqiptare' të Migjenit: uni lirik komshinjtë tani janë shqiptarë, klerikë katolikë posaçërisht:

"Së fundi duam të japim një interpretim të ri të poezisë "Këngë më vehte". Kjo poezi tepër e rëndësishme është në fakt e vetmja e ciklit homonim (ciklet e tjera janë prej disa poezish). Ky cikël-poezi flet për fqinjët, komshinjtë, për të cilët Migjeni shënon në varg: "Komshinjtë e mij që i kam farefis", pra janë shqiptarë e jo të ndonjë kombësie tjetër, siç ka thënë pa përgjegjësi ndonjë studiues. Për ta kuptuar më saktë këtë theksojmë se shtëpia e Migjenit ka qënë përballë kishës së madhe në Shkodër – ky fakt lidhet me gjenezën e shpjegimin e mesazhit të poezisë, sepse poeti krijon antitezën sfiduese e të pamëshirshme për disa nga priftërinjtë që u bënë "orakuj" e pararojë të fashizmit rrezikun apokaliptik të të cilit Migjeni e shpall dhe në skicat "Të korrat" apo tek "Husarët n'Adriatik" Kjo duket qartë dhe në përmendjen në varg të motos "Për fe dhe atdhe", të komshinjve (priftërinjve) që theksohet shpesh në shtypin klerikal të Shkodrës, tek "Hylli i Dritës", revistë që kish si parafjalë fjalët latine "Ubi spiritus domini, ibi libertas" ("Ku është fryma e zotit është liria"). Poezia për të cilën flasim është e para poezi antifashiste shqiptare në vitet '30, pra nga më kryesoret e "Vargjeve të lira""[14].

Ndjehet në këto rreshta ndikimi i paragjykimit antiklerikal e antikatolik në veçanti, lehtësia me të cilën vendosen



**Ish shtëpia e Migjenit në Shkodër.**

raporte të pandërmjetshme mes jetës reale e poezisë; mbi të gjitha 'normalizimi' i hipersforcuar i vargut problematik 13: "*Komshinjtë e mij që i kam farefis*" – pra janë shqiptarë e jo të ndonjë kombësie tjetër" (!). Më e logjikshme e më me kuptim në kuadër të kësaj skeme do të ishte që leximi i vargut të redaktohej pakashumë kështu: "*Komshinjtë e mij që i kam farefis*" – ata - 'kojshitë e mij' [përderisa unë jetoj në Shqipëri] janë natyrisht shqiptarë, jo të ndonjë kombësie tjetër e përderisa i kam farefis, shqiptar i bie të jem edhe unë."

E orientuam në këtë mënyrë disi naive leximin, për të thënë se në çfarëdo forme të jepet, interpretimi që themelohet mbi barazimin *kojshi = farefis = un lirik = shqiptarë* është thjesht i pambajtshëm. Se ku të çon këmbëngulja në një barazim të tillë e bën të qartë diskuri i stërsforcuar e thuajse haluçinant i P. Janurës, përndryshe një nga punëtorët e shquar në lëmë të migjenologjisë: "Vetëm prej fjalisë "*…kojshitë e mi që i kam far'e fis*" s'do të thotë se del pohimi se kjo është një dëshmi e tij mbi origjinën e vet slave ortodokse. Ai në Jugosllavi, në Tivar, kishte motër, pra kishte "far'e fis". Kjo është e vetmja dëshmi personale e poetit dhe atë duhet besuar para çdo hipoteze tjetër. Në qoftë se poeti do të thoshte vetëm "kojshitë e mi", atëherë do të ishim para një dileme sa i përket kombësisë, pse kojshitë në Shqipërinë e Veriut janë popujt jugosllavë, por fakti se ai thotë "kojshitë e mi që i kam far'e fis", kjo është provë se ai ekskluzivisht bën fjalë për familjen e nënës së tij që ishte prej Tivarit e të motrës së vet, e për shqiptarët e Malit të Zi, të Kosovës e të Maqedonisë, pra s'e përjashton origjinën e tij shqiptare. Për këtë arsye ai thotë "kojshitë e mi që i kam far'e fis', pra "far' e fis" nga ana e nënës, e të motrës dhe të shqiptarëve në Jugosllavi, kjo

si një veneracion karshi memories së nënës së vet që e kishte lënë jetim, të motrës që u kujdesua për shkollimin e tij në Tivar e për shqiptarët e Maqedonisë që i donte si bashkëkombas."[15]

Megjithë pikat e dobta të skemës së Zeqos, mund të duket, në vështrim të parë, se ka fakte historikë që shkojnë në mbështetje të variantit të tij të leximit.

"*Në maj-qershor të '32-shit diplomatët italianë ndërmorën një nismë të rëndësishme për t'i lidhur katolikët shqiptarë me Italinë. Duke marrë shkas prej festimeve në Padova të qindvjetorit të shtatë antonian, qe organizuar një udhëtim (a shtegtim) i 313 shqiptarëve katolikë në Itali: 48 klerikë e motra, mes të cilëve të gjashtë ipeshkvit shqiptarë; 155 vetë të ardhur nga qytete të ndryshme të Shqipërisë; 110 malësorë prej visesh katolike. Qeveria italiane e favorizoi udhëtimin duke marrë përsipër organizimin e kujdesshëm për gjithëçka, duke ua paguar falas të gjitha malësorëve e duke u bërë zbritje çmimesh pjesëmarrësve të tjerë. E gjithë vizita, që zgjatë tri javë, qe studiuar deri në hollësi, për t'u lënë përshtypjen shqiptarëve se Italia s'donte tjetër prej tyre veç t'i mirëpriste. […] Përgjegjësve italianë të këtij udhëtimi iu duk se qëllimi u arrit. Shqiptarët morën pjesë në manifestimet fetare masive në Padova, në Venecia, u pritën në Vatikan, shkuan në Xhenacano që të faleshin po te ajo Zojë e Këshillit të Mirë që adhurohej në Shkodër, u pritën nga Musolini. Udhëtimi qe organizuar më shumë që t'u bënte përshtypje se sa që të kuptonin, dhe kështu qe marrë edhe prej ndonjë shqiptari. […] Një letër e të vetmit françeskan italian që punonte në Shqipëri, italianit Kamilo Libardi, drejtuar konsullit italian në Shkodër, është treguese e një gjendjeje shpirtërore, sidoqë duket e shkruar për t'u bërë qejfin autoriteteve konsullore: "kam folur me malësorë të ndryshëm të kthyer nga udhëtimi në Itali. U ka bërë një përshtypje të tillë sa rrezik t'u fluturojë mendja. Më shumë se emocionet fetare, vizita te Duçja, parada mbretërore, lopët e përmirësimit racor […], të gjitha këto e kanë ngacmuar tmerrësisht fantazinë e këtyre njerëzve të varfër e fisnikë…*"[16]

Lidhur me këtë dëshmi historike le të bëjmë disa arsyetime:

1. Uni lirik dhe *kojshitë* së toku me *Vérin* duhet të jenë të *të njëjtit* besim. Përndryshe, nëse nuk do të ishte kështu, përse do të duhej ta synonte edhe unin lirik *Véri*? E besimi i 'alter-ego-s' së unit lirik, Millosh Gjergj Nikollës, dihet se është *tjetër* prej besimit të *Vérit*.

2. *Véri*, po pranojmë për hir të arsyetimit se simbolizon fashizmin, shfaqet në poezi si një fuqi e vjetër, madje e stërvjetër, përderisa ka komunikuar me *stërgjyshnat* e nipave të sotëm, bashkëkohës të unit lirik. *Véri* është jo vetëm një fuqi e stërvjetër, por që thuajse nuk ka ndryshuar që në krye të herës. Fashizmi? Padyshim jo. Një paraardhës i tij? Nëse po, cili? Perandoria Romake? Po e pranojmë këtë në pajtim me faktin e ditur të burimit trashëgimor që fashizmi italian shihte në Perandorinë Romake. Çështja është se historia na dëshmon raporte aspak miqësore të Romës me *stërgjyshnat* e shqiptarëve të sotëm, 'husarët' e Mbretërive Ilire. Migjeni vetë, në një krijim tjetër të tij na e pohon këtë:

"*Madhshtia e detit më bani të mendoj sub eternitas. E humba ndjenjën e kohës në të cilen jetoj dhe më shkoi mendja té stërgjyshnat tonë husarë që mu në két ujë, nder këto dallga husarojshin dhe plaçkitshin anijet e pasuna të romakvet. Kush mund ta parashifte se dikur, mbas mija vjetë, stërnipat e këtyne husarve ilirë me sternipat e romakve të pasun, kush e mendonte se do bahen, miqë, dhe miqë kaqë të sinqertë?! Nga miqsia e madhe të rroken e të puthen, t'i ndihmojnë shoqi-shoqit me rasen e ndoj disfates.*"[17].

3. Pastaj, përse do t'i duhej Migjenit që fashizmin ta shenjonte simbolikisht me leksemën 'Véri', e cila, përveç 'pamëshirësisë', madje në bashkëshoqërim të pandashëm me të, denoton pashmangshëm, madje *në radhë të parë*, drejtimin (gjeografik) prej nga fuqia që ajo simbolizon vjen kah *shtëpijat e kojshive* e të asaj të unit lirik, shkurt e qartë veriun? E pra, fashizmi, nëse *Véri* simbolizon atë, në Shqipërinë e Shkodrën e kohës së poetit 'frynte', nëse 'frynte', bash nga *Përndimi* e jo nga *Véri*.

Ka një pikë realisht të qëndrueshme në skemën e Zeqos. *Kojshitë* nuk janë, sipas tij, përbërës të një entiteti politik tjetër, rrjedhimisht të ndodhur larg në hapësirë; nuk kemi pra një entitet-*kojshi*, por kojshi individualë, shtëpitë e të cilëve ndodhen pranë asaj të unit lirik. Është e vërtetë që Migjeni, siç na kujton Luka, flet në njërën prej prozave të tij për *entitete politikë-kojshi*, por këta kojshi – të vërehet mirë – janë (e s'mund të ishin ndryshe) 'kojshitë' tonë e jo 'kojshitë' e mi si në rastin e poezisë "Kangë në vete": "*Çdo gja që s'ka krye asht kufomë, e kufoma s'e ka vendin në mes të gjallvet. Kufoma duhet varrosë. Përndryshe e përlyemja me të ka për të qenë katastrofale. E katastrofa asht katastrofë! Nuk kursen! Zhduk kombe! (Kombi ynë me të vërtetë s'u zhduk. Por arsyeja asht vetëm se edhe kojshitë tonë t'afërm (*nënv. ynë – K.J.*) qenë pak a shum të një fati si na).*"[18]

**VI.**

Skemat e leximit të parashtruara deri tani, përveç pikave të dobta, një pjesë të të cilave i vumë në pah, nuk u japin përgjigje një vargu pyetjesh, që teksti në mënyrë të detyrueshme shtron.

Po cekim vetëm disa:

1. Nëse *Véri* përfaqëson fashizmin a nazizmin, e që për më tepër *frynë pa mshirë*, a mund të jetë ky dikur, në një moment, periudhë diçka e mirë, jo vetëm e mirë po e kërkuar, e dëshiruar madje? Logjika normale thotë 'jo', por

teksti i përgjigjet 'po' kësaj pyetjeje. Ndryshe si do të mund të interpretohej vargu 4: '*sa mirë e presin... megjithse nuk asht ditë vere*'? Pra në ditë vere i pamëshirshmi *Véri* qenkërka i mirëpritur (!), e këtë – të vërehet mirë – e thotë, çka domethënë e pranon a e justifikon, edhe vetë uni lirik, ai që don t'ia mbyllë derën *Vérit*.

2. *Véri* hyn si *hajn* në shtëpijat e kojshive e ky nuk është veç konstatim i unit lirik, pasi për këtë janë të vetëdijshëm edhe vetë kojshitë (!). Ç'do të thotë të hysh si hajn në një shtëpi? Do të thotë të mos jesh i asaj shtëpie, të hysh pa lajmëruar, të hysh fshehurazi, të hysh së fundi me qëllim të keq. Po kjo mund të ndodhë nëse ka një ndalim, madje një ndalim të fortë. Nëse ndaluesit nuk janë kojshitë – të zotët e shtëpive, cila duhet të jetë fuqia ndaluese? Ku ndodhet ajo?

3. *Véri* hyn për të vjedhur e të zotët e shtëpisë e mirëpresin. Ç'duhet të kërkojë të vjedhë një hajn që i zoti i shtëpisë, duke e ditur që do të vidhet, ta mirëpresë?

Në ç'rast mund të jetë logjik ky konfiguracion mëse i çuditshëm?

4. *Véri* vjen nga larg, pa mshirë, si hajn, me acarrim dhe u thotë kojshive të unit lirik se stërgjyshnit e tyre janë bërë fli për atdhe – e lemë mënjanë hëpërhë fenë – e prandaj i kanë merituar premtimet e *Vérit*. Pyetja shtrohet: për cilin atdhe? Përgjigjja vjen vetiu: për atdheun e *Vérit* pa dyshim, përndryshe, përse do të duheshin fundja premtimet? A nuk kanë vlejtur premtimet, bash për t'i kandisur stërgjyshnat të bëhen fli për një atdhe që… nuk ka qenë i tyre? Por që u është mbushur mendja, më saktë që premtimet ua kanë mbushur mendjen se … qenkërka dhe i tyre? Po atdheu i vërtetë i stërgjyshnavet ku është?

5. Për cilin atdhe i fton *Véri* tash *nipat e stërgjyshnavet meleza dhe të letë* të bëhen fli? Për cilin atdhe tjetër, pos për të njëjtin, për të vetin, për të *Vérit*? Po atdheu i nipave ku është? Ku ndodhen ata? E përse *Véri* fryn pa mshirë, pse hyn si hajn, pse flet me acarrim?

6. Cili atdhe e ka kërcënuar në kohën e stërgjyshnave *Vérin* e kundër cilit atdhe ka luftuar ai? Po tani, në kohën e nipave, kundër cilit atdhe lufton *Véri*?

7. Nëse Véri i ka bërë për vete të gjithë kojshitë e unit lirik, ç'punë i prish atij mungesa e njërit, e fillikatit un lirik? Dhe ç'do të humbte ky po të bëhej si nipat e tjerë? Dhe ç'kërkon *Véri* pa mshirë, *si hajn, me acarrim* prej këtij? [*me m'a fikë ket dritë / me m'a ngrî ket shpirt / me m'a dridh për ndjesijë tjetër / me m'a joshë me andërr të vjetër.*]. Për ç'dritë është fjala? Për *ç'shpirt* është fjala? Për ç'ndjesijë tjetër është fjala? Po *andrra e vjetër* cila është?]

Këtyre e të tjerave pyetje asnjëra prej skemave të deritashme të leximit të poezisë nuk u jep përgjigje. Në të vërtetë këto pyetje as që shtrohen.

**VII.**

Le të marrin në shqyrtim tani faktin kryesor të biografisë jetësore të Migjenit që, sipas një lagjeje migjenologësh, zbulon poezia "Kangë në vete", atë të përkatësisë së tij etnike dhe të përpiqemi ta ballafaqojmë këtë fakt me të dhënat që tradita studimore na ofron.

Qëndrimet janë tre:

1. **Prejardhje etnike e padyshimtë shqiptare**: Skënder Luarasi, Petro Janura, Rinush Idrizi, Moikom Zeqo etj.

Mbrojtësi i parë e kryesor i kësaj hipoteze, S. Luarasi, te i cili në të vërtetë mbështeten edhe më të shumtët e migjenologëve të kësaj bindjeje, na bën ndër të tjera me dije:

"I gjyshi (*i Milloshit – K.J.*) Nikolla Dibrani – quhej me këtë mbiemër gjenerik, se familja e kishte origjinën nga Dibra e Madhe, nga fshatrat orthodhokse shqiptare të Rekës (po nga ajo krahinë ku ka lindur edhe poeti e patrioti shqiptar Josif Jovan Bagëri) – qe përngulur në Shkodër nga mezi i shekullit të 19-të. Kemi plot kësi familje të përngulura në këtë qytet të Veriut: Gjergaj, Trimçev, Siliqi, Banushi, Kadiqi, Dibra, e tjera. Nikolla Dibrani qe murator nga mjeshtëria dhe thonë se mori pjesë në ndërtimin e kishës orthodhokse në Shkodër. Kur shkonte si murator nëpër katundet e ndryshëm, në Mal të Zi, Nikolla u njoh dhe u martua me një vajzë nga Kuçi, me Stankë Milanin, e cila kishte edhe ajo si gjithë banorët e asaj krahine, shqipen për gjuhë amëtare. Nikolla Dibrani, kur humbi jetën në Mal të Zi, aty nga moti 1876, la pas dy bij: Gjokën (Gjergjin) dhe Kriston, fare të vegjël."[19]

2. **Prejardhje etnike (thuajse) e padyshimtë sllave**: Dhimitër Shuteriqi, Gjovalin Luka, Arshi Pipa etj.

Përkundër bindjes gjerësisht të përhapur se është A. Pipa formuluesi i parë (e mbështetësi më i madh) i hipotezës së prejardhjes etnike joshqiptare të Millosh Gjergj Nikollës, kronologjikisht një kontribut i tillë u takon dy migjenologëve të tjerë: Dh. Shuteriqit e Gj. Lukës.

Pikëpamjet e Shuteriqit dhe të Lukës u parashtruan më lart. Ndërkaq Pipa është më eksplicit: "I lindur shqiptar [*besojmë në kuptimin 'shtetas shqiptar' - K.J*] në një familje me prejardhje sllave, pastaj i arsimuar në një mjedis kulturor sllav, ai u takua prapë me Shqipërinë dhe me kulturën shqiptare si një i rritur. Gjuha që foli në shtëpi ishte serbo-kroatishtja, ndërsa në seminar ai mësoi rusisht. Ai nuk e dinte shqipen mirë."

Për t'u siguruar se as Shuteriqi, as Luka e as Pipa (dy të fundit shkodranë) nuk 'krijojnë' nga vetja, sjellim një fragment nga monografia e cituar e dela Rokës "Kombësia dhe feja në Shqipëri (1920-1944)", në të cilën bëhet fjalë për çështje të lidhura me bashkësinë ortodokse të Shkodrës si dhe të raporteve fetare e politike të Mbretërisë Serbo-Kroato-Sllovene me të: "Pak muaj pas Kongresit të Beratit, sidoqoftë, një problem praktik i një fare rendësie bëri që të kalonte në plan të dytë përcaktimi i çështjeve që ishin më shumë, si të thuash doktrinale. Ky ishte problemi i shtetasve

shqiptarë ortodoksë që nuk e quanin veten pjestarë të kombësisë shqiptare, për të cilët shpallja e autoqefalisë shqiptare ishte një nxitje e mëtejshme për të kërkuar mbrojtës të jashtëm. Ishte fjala […] për një pakicë serbësh e malazezësh të përqendruar në Shkodër (6000 vetë)."[21]

Bëhet fjalë pra për pakicë serbe e malazeze. Dhe padyshim që nuk nënkuptohet me të vetëm popullsia e fshatit minoritar Vrakë, i cili gjithë-gjithë mund të kishte jo më shumë se 500 frymë, por me gjasë tërë bashkësia ortodokse e Shkodrës apo një pjesë shumë e madhe e saj.

3. **Prejardhje etnike e paqartë përkundër "aspiratave kombëtare shqiptare" të padyshimta**: Andrea Stefi.

Stefi na jep një nga dëshmitë më interesante lidhur me çështjen: "Siç dihet historikisht Millosh Gjergj Nikolla u lind në Shqipni nga prindër që banuen në Shkodër, por u kulturue sistematikisht në Jugosllavi. Me vërtetue fiziollogjikisht gjakun shqiptar të tij nuk disponoj asnji të dhanun të konsiderueshme, për faktin se atëhere as jam interesue direkt o indirekt, sepse e shifje në gjiun tonë me ndjenja e aspirata kombëtare shqiptare. Ajo ti mbetet kujdo: po jo mue, për të cilën pikë laj duertët, po jo si Pillati biblik, po me dlirësi patrioti e njeriu vullnet-mirë."[22]

Le të shënojmë këtu se prej shumë kohësh në ligjërimin shkencor nuk flitet më për identitet etno-gjenetik [*"fiziollogjik„ – me termin e Stefit*]: identiteti etnik nuk është një vlerë e bashkëlindur, por një vlerë e bashkëndarë. Gjithësesi dëshmia e Stefit, mik intim i Migjenit, ka një rëndësi të posaçme, pasi në njëfarë mënyre, me ambiguitetin e vet, i rektifikon të dy qëndrimet kundërshtare si 'gjenuine', si jo të sajuara duke i shërbyer kështu përpjekjes për ta ndriçuar problemin në tërë kompleksitetin e tij real.

Të vërehet se deri më tash, në pajtim me traditën, ne kemi bërë fjalë për *prejardhje etnike* të Millosh Gjergj Nikollës (në kuptimin e thjeshtëzuar, njëpërmasor: *Migjeni i ç'prejardhjeje është*) dhe jo për *identitet etnik* të tij: Migjeni *i ç'prejardhjeje është – ç'thotë se është – ç'ndjen intimisht se është*.

Gjithësesi, në mbyllje të këtyre dëshmive, ne mund të arrihet në përfundimin se *ekziston një problematikë e identitetit etnik te Migjeni* në kuptimin e plotë a organik të termit.

Vetë këmbëngulja e S. Luarasit a nuk është e orientuar si kundërshtim i një pikëpamjeje tjetër, ndonëse ajo nuk përmendet? Dhe një pikëpamje e tillë, e ndryshme, madje e kundërt, u pa se ka ekzistuar.

Cila është e vërteta? Kjo pyetje për ne ka kuptim të shtrohet vetëm në trajtën: *Ç'na thotë vetë Migjeni për këtë çështje?*

**VIII.**

Dëshmi dokumentare, në të cilat Migjeni të shprehet mbi identitetin e vet etnik nuk ka, ose të tilla nuk na kanë mbërritur; kemi ndërkaq dëshmi të tërthorta, të të tjerëve, një pjesë e të cilave u parashtruan më lart, por këto mund të shërbejnë vetëm si mbështetëse të dëshmive të drejtpërdrejta.

Ekziston ndërkaq një dëshmi e drejtpërdrejtë specifike, dëshmia letrare, e cila interpretohet tri mënyrash:

1. Sipas pikëpamjes mbizotëruese, të parashtruar e të mbështetur nga pjesa më e madhe e studiuesve, vepra letrare e Migjenit flet në mënyrë të qartë për identitetin etnik shqiptar të autorit të saj, e shënjuar e tëra, veç shprehjes gjuhësore, nga një tematikë, problematikë e frymë shqiptare e dalluar: "Vepra e tij nuk na lejon të dyshojmë për origjinën shqiptare të Migjenit. Këtë ajo e vërteton dhe e sqaron pasi është kryesisht me frymë, ndjenja dhe dashuri shqiptare, për njeriun shqiptar."

2. E kundërshton këtë tezë një rrymë e mendimit kritik, e ngushtë por me një përfaqësues të shquar: Arshi Pipën. Sipas Pipës : "Ai (*Migjeni-K.J)* nuk e dinte shqipen mirë. Tekstet e tij janë të mbushura me gabime ortografike, madje elementare, dhe sintaksa e tij është larg të qenit shqipe tipike. […] Prandaj, mund të pohohet se, nëse Migjeni i takon letërsisë shqipe në sajë të gjuhës në të cilën ai shkruan, stili dhe skeleti i mendjes së tij janë thelbësisht sllavë. Ndeshemi me një fenomen të hibridizmit kulturor: shpirtin sllav që flet shqip."

Përpos kësaj, sipas Pipës, çështjen e identitetit të tij etnik Migjeni e tematizon në mënyrë eksplicite në poezitë e ciklit "Kangët e Përndimit".

3. Së fundi, sipas një pikëpamjeje, e cila njëherësh pajtohet me - e njëherësh kundërshton të dyja të parat, Migjeni nuk është shprehur asnjëherë në veprën e vet mbi përkatësinë e tij etnike, thënë më saktë, mbi përkatësinë e tij etnike sllave: "[…] Migjeni nuk e kujtoi kurrë zanafillën e vet."

Ç'do të mund të thuhej më tej në këto kushte?

**IX.**

Mbi bazën e vëzhgimeve të kryera deri këtu ne jemi tashmë të bindur:

1. se Millosh Gjergj Nikolla është ndeshur fort përgjatë jetës me problematikën e identitetit të vet etnik, çka na afron me tezën e Pipës si dhe me tezën e Shuteriqi-Lukajt;

2. se kjo problematikë gjendet e mishëruar në veprën e tij letrare, çka na largon prej tezave të Luarasit, të Zeqos, të Kadaresë etj. dhe na afron sërish me atë të Pipës;

3. se në veprën letrare të Migjenit *nuk pasqyrohet drama* e përkatësisë etno-identitare të autorit: *dramë të tillë nuk ka*, apo nëse ka pasur ajo është zgjidhur kaherë, përpara se Millosh Gjergj Nikolla të nisë të krijojë veprën që njohim;

4. se përkundër dramës në këtë vepër *gjen reflektim zgjidhja* a ndriçimi që autori i jep problemit të identitetit të vet etnik, si dhe të identitetit të grupit në të cilin bën pjesë, pikëpamje që na ndan nga Pipa;

5. se kjo zgjidhje nuk shkon në vijën e pranimit të një ambiguiteti etno-identitar, aq më pak të një dysie etno-identitare, çka na çon në kundërshtim përfundimtar me një pjesë të tezës së Pipës dhe na afron me thelbin e pikëpamjes së Luarasit si dhe të asaj të Kadaresë, kur ai flet për 'zgjedhje të sinqertë, të thellë, të plotë';

6. se problematikën e identitetit të vet etnik Migjeni nuk e trajton asfare në poezitë e ciklit "Kangët e Përndimit", siç ngulmon Pipa, por në poezinë "Kangë në vete", veçse krejt ndryshe nga ç'pretendojnë Shuteriqi, Luka, Bala, Janura, Zeqo etj.

Së pari, prej këtyre përfundimeve sikur del se të gjithë kanë pjesërsisht të drejtë e njëherësh janë pjesërisht në gabim. Pikërisht kështu: e vërteta e komplikuar e identitetit etnik të Migjenit shfaqet si shumë e të vërtetave të pjesshme të shpërndara. Veçse jo si një shumë mekanike: këtyre të vërtetave u mungon një përbërës, përbërësi që ka aftësinë t'i lidhë ato – pjesët në një të tërë jetësore.

Së dyti, siç shihet, thelbi i tezës sonë përmblidhet në përfundimin e fundit. Argumentimi i këtij përfundimi lyp demonstrimin e pambështetësisë të tezës së Pipës nga njera anë dhe, nga ana tjetër, shtjellimin e një skeme të re interpretuese të poezisë "Kangë në vete", të ndryshme nga skemat interpretuese të Shuteriqit, Lukës, Janurës, Zeqos etj.

Me çështjen e parë, pra me kritikën e interpretimit që Pipa i bën poezive të ciklit "Kangët e Përndimit" nuk do të merremi këtu. Ne synojmë të provojmë ndërkaq se shqetësimet mbi problemin e identitetit etnik Migjeni i reflekton *ekskluzivisht* në poezinë "Kangë në vete", pra në asnjë krijim tjetër të tij. Nëse dëshmohet besueshmërisht e argumentuar kjo hipotezë, paradigma pipaiane është në mënyrë implicite e qortuar. Ndërkaq, paradigmat shuteriqiane, zeqojane etj. duhet edhe në vijim të qortohen në mënyrë eksplicite.

**X.**

E kemi cilësuar tekstin poetik migjenian – *tekst konspektiv*, me çka kuptojmë atë tip teksti që mundëson një maksimum të domethënieve përmes një minimumi të shenjave gjuhësore.

Teksti konspektiv, për vetë natyrën e tij, ofron një shumësi maksimale nga të cilësuarat *Leerstellen* ('vende', 'hapësira', sekuenca tekstore 'bosh'), për 'mbushjen' e të cilave ai 'i bën apel' lexuesit.

Pyetjet që ne shtruam në pikën VII të sprovës e informacionet që rrjedhin sosh, së toku me të tjera informacione të shumta burojnë pikërisht prej këtyre *Leerstellen*. Për më tepër, struktura e tekstit konspektiv ka një natyrë të tillë që informacionet të cilat ai në një formë impicite emeton janë me lehtësi ndërsubjektivisht të verifikueshme.

Le të bëjmë ekspicit ndonjë tjetër prej këtyre informacioneve të 'fshehur'. Themi 'ndonjë tjetër' pasi jo pak të tillë ne zbuluam apo intriguam në pikën IV:

1. Kojshitë e unit lirik i drejtohen *Vérit* në *gjuhë të huej*. *Gjuha është e huej* për kë? Pa dyshim ajo është *e huej për kojshitë*, por edhe për unin lirik, si farefis i tyre. Duke qenë ndërkaq *gjuha e Vérit*.

2. Gjuha me të cilën kojshitë flasin me *Vérin*, është e huaj, jo amtare si të thuash për ta, por ata ama e flasin dhe e kuptojnë. *Kojshitë komunikojnë edhe në atë gjuhë të huej*, siç del se e kupton dhe komunikon *edhe* në të po ashtu vetë uni lirik.

3. Fjalët e premtimet *me acarrim* që *Véri* u thotë e u bën kojshive shqiptohen natyrisht në këtë *gjuhë të huej*, në gjuhën e *Vérit*. Është uni lirik në rolin e interpretit ai që na i sjell ato në gjuhën tjetër, në gjuhën e tekstit, gjuhë e cila i bie të jetë gjuha e unit lirik dhe e kojshive, *gjuhë e huej* për *Vérin* ndërkaq.

4. Kojshitë e unit lirik i karakterizon një amnezi e plotë. Është *Véri* që u rrëfen atyre për *stërgjyshnat*. Kojshitë nuk kanë kujtesë historike, a më saktë kujtesa e tyre historike është robinë e *Vérit*. Përkundrazi uni lirik e ka këtë kujtesë, vëçse ajo është e përkundërt me kujtesën që *Véri* u fal *me açarrim* kojshive. Dhe duhet të jetë bash kjo humnerë kujtesash që ushqen qoftë agresivitetin e *Vérit* ndaj unit lirik, qoftë rezistencën e tij, qoftë satirën e dhimbshme të tij ndaj *kojshive* - farefis.

5. *Véri* është një fuqi shekullore, e pandryshueshme, përderisa ai ka fryrë njësoj siç fryn tani edhe në kohën e *stërgjyshnavet të kojshive*, pra këtu e shekuj më parë. Kujtesa e tij është totale, synimi i tij është i njëjtë.

6. *Véri* është vërtet një fuqi shekullore, veçse në raportet e tij me *kojshitë* duket se ka në mes një ndërprerje. E thënë më qartë, përdërisa Véri u sjell ndërmend *nipave-stërgjyshnat*, duket se lidhjet e Vérit me *kojshitë*, për të mos thënë synimet e Vérit ndaj kojshive kanë qenë posaçërisht të fuqishme në dy momente: në krye të herës, në kohën e *stërgjyshnave* dhe tani, në kohën e *nipave*. Përndryshe do të duhej të bëhej fjalë edhe për gjyshër, edhe për etër.

7. Kjo ndërprerje në mes, kohësisht mjaft e gjatë, duhet të jetë shkaktuar jo për vullnet të *nipave*, aq më pak të *Vérit*, por për vullnet të fuqive a ngjarjeve eprore, të cilat duhet t'ia kenë bërë të pamundur Vérit të fryjë drejt *kojshive* të unit lirik pa pushim.

8. Ndërprerja megjithatë nuk duhet të ketë qenë e plotë, pasi, të ishte ashtu, gjyshërit dhe etërit do t'u kishin lënë ndopak kujtesë, një tjetër kujtesë ndoshta, një kujtesë pa *Véri nipave*. Një kujtesë të tillë *nipat* nuk e kanë, prej nga del se kujtesa e gjyshërve, e etërve ka qenë po ashtu një kujtesë me *Véri*.

9. Shtëpitë e *kojshive* të unit lirik së toku me shtëpinë e këtij të fundit *janë i gjithë vendi* drejt të cilit fryn *Véri*? Natyrisht jo. Së pari, pse po të ishte kështu, Véri, nëse mbajmë parasysh dashamirësinë e pacak të *kojshive* të

unit lirik ndaj tij, do të qe krejt si në shtëpi të vet, s'kishte pse të hynte si *hajn* e as të premtonte diç me *acarrim*; së dyti, pse përtej komshijve – krejt të afërmve hapësinorisht, sado i vogël qoftë vendi, ka gjithnjë banorë të tjerë, jo komshij, të ndodhur më larg e akoma të tjerë ende më larg. Tani shtrohet pyetja: ç'gjuhë e ç'atdhe e ç'fe duhet të kenë këta banorë të tjerë të vendit? Të njëjtën gjuhë me kojshitë e unin lirik – *gjuhën e vendit*, por kojshitë e uni lirik kanë edhe një gjuhë *tjetër* – gjuhën e *Vérit*; të njëjtin atdhe me atdheun e kojshive e të unit lirik – atdheun e *vendit*, por kojshitë "kanë" edhe një "tjetër atdhe" – atdheun e *Vérit*; të njëjtën fe me fenë e kojshive e të unit lirik? Jo, pse *kojshitë* e uni lirik kanë të njëjtën fe me *Vérin*. Dhe ky, pikërisht në emër 'të gjuhës së përbashkët' – *të huej* ama për kojshitë, në emër 'të atdheut të përbashkët' – sipas fjalëve të *Vérit* ama, e siç duket, sidomos në emër 'të fesë së përbashkët', e cila nuk mund të jetë si atdheu e gjuha 'e dyfishtë', i nxit *me acarrim e premtime të kristalta* kojshit (e unin lirik) të bëhen fli si *stërgjyshnat*. Kundër kujt? Kundër kujt tjetër përpos kundër *banorëve të tjerë të vendit*?

**XI.**

Skemat interpretuese të trajtuara më lart jo vetëm që nuk i qëndrojnë siç u pa kritikës në mëse një rast, jo vetëm nuk u japin përgjigje një vargu pyetjesh të domosdoshme që teksti shtron, jo vetëm nuk 'ndriçojnë' informacionet e 'fshehura', por nuk marrin në shqyrtim edhe një varg çështjesh 'formale', të cilat një analizë tekstore e kujdesshme e poezisë do t'i bënte të detyrueshme.

Në bazë të këtyre çështjeve qëndrojnë disa agramatikalitete, apo thyerje të normës gjuhësore (grafematike, fonetike, morfologjike, semantike, sintaksore) e të asaj poetike. Një pjesë e tyre janë 'eleminuar' në procesin e transmetimit të tekstit nga njëri botim në tjetrin, sipas formulës lasgushiane 'gabohen përsëri gabimet e gabuara dhe shtohen të tjera gabime'. Eleminimi i agramatikaliteteve, veçanërisht të rëndësishëm në rastin e veprës migjeniane e posaçërisht të rëndësishëm, madje thelbësorë për leximin mbushamendas të poezisë "Kangë në vete", është përligjur, kur heshturazi kur në mënyrë të shprehur, me bindjen se tekstet e Migjenit përmbajnë shumë 'gabime gjuhësore', rrjedhojë kjo e 'mosnjohjes dhe e moszotërimit mirë të shqipes' prej tij.

Kemi pasur rastin të vemë në dukje lidhur me këtë çështje se të ashtuquajturit 'gabime' në tekstet e Migjenit janë në shumicën e rasteve funksionalë.[23]

Një shkollë e interpretimit na mëson ndërkaq se pikërisht në deformime të tilla, në devijime të tilla të normës mund të fshihet kryeçelësi, zbulimi dhe përdorimi i të cilit do të na lehtësojë dekodifikimin ndërsubjektivisht të verifikueshëm të mesazhit tekstor, afrimin kah *intentio operis* dhe përmes tij pastaj kah *intentio auctoris*.[24]

Për ç'deformime është fjala?

**XII.**

Në krye të herës le të themi se teksti i poezisë "Kangë në vete", i dhënë në pikën VI të kësaj trajtese nuk pasqyron vullnetin autentik të autorit. Ai përmban një varg variantesh të redaktimit e të transmetimit, të cilat, siç do të shihet në vijim, vullnetin autorial e kanë deformuar jo pak.

Kemi pasur mundësinë të sigurojmë autografin e poezisë, të cilin e riprodhojmë besnikërisht më poshtë:

KANGË NË VETE
***Véri frynë pa mshirë, si véri që frynë,***
*dhe si hajn në shtëpijat e kojshive hynë -*
*edhe për çudí*
*këta kojshitë e mi*
*sa mirë e presin... megjithse nuk asht ditë vere*
*ato në gjuhë të huej i thonë: mirë se erdhe!*
*Véri frynë dhe me acarrim u premton pallate te kristalta*
*kojshive të mijë që u a kande shum andrrat e thata -*
*dhe u thotë kështu:*
*stërgjyshnit e ju'*
*qenë fatosa të vertetë dhe u banë flíja*
***për fé dhe atdhé** dhe i merituen këto premtimet e mija.*
*Dhe kojshitë e mi që i kam far'e fis,*
*nipat e stergjyshnavet meleza dhe te letë,*
*nipa donë me mbetë,*
*nipa të vertetë*
***me atdhe e fé** ndër andrrat e thata*
*që t'i meritojnë premtimet e kristalta.*
***Véri frynë pa mshirë, si veri që frynë;***
*unë i a mbylla derën t'eme **me rreze mos të hyjnë***
*me m'a fikë ket dritë*
*me m'a ngrî ket shpirt*
*me m'a dridh për ndjesijë tjetër*
*me m'a joshë me andërr të vjetër.*

Me karaktere të nxirë kemi shenjuar ato vargje, ato sintagma a fjalë, të cilat, në radhë të parë kanë pësuar deformimet më të rënda, e të cilat, njëherësh përmbajnë a reflektojnë agramatikalitetet a thyerjet kryesore të normave, ku do të përqendrohet vëmendja jonë pas pak.

Me karaktere të pjerrët sinjalizojmë ndërkaq sintagma veçanërisht të rëndësishme për skemën tonë të leximit të poezisë.[25]

**XII.**

Kemi identifikuar në poezinë "Kangë në vete" gjashtë tipe agramatikalitesh a thyerjesh të normave:

**a. Thyerje të normës poetike**

Agramatikaliteti poetik – term pune ky – ka lidhje me faktin e pazakontë, për të mos thënë unikal, të ndërtimit të

një cikli poetik me një poezi të vetme në përbërje. Kemi pra një thyerje të çuditshme, në mos krejt të pakuptueshme të një norme universale.

E lehtëson disi anormalitetin fakti se "Kangë në vete„ nuk lajmërohet si cikël i veçantë, siç do të duhej, në krye të vëllimit, por ndahet, dhe nuk kishte si të mos ndahej e të ishte njëherësh vizualisht e veçuar prej ciklit paraardhës "Kangët e Përndimit„ si të gjithë ciklet e tjerë (normalë) me një fletë, e cila mban titullin e „ciklit", të njëjtë me të poezisë së vetme të tij "Kangë në vete„.

"Kangë në vete„ si titull i ciklit, në kuptimin "Kangë e veçuar„„ e ndarë prej simotrave", „havaz më vete" (Shuteriqi) mundëson diferencimin e poezisë homonime prej të tjerave, në kontekstin e vëllimit. Ndryshe, në ç'tjetër mënyrë mund të realizohej ky diferencim? Nga kjo perspektivë agramatikaliteti zbutet edhe më. Autori s'ka ndërmend të lajmërojë një cikël të ri, që në thelb nuk ekziston, por veç të njëmendësojë ndarjen, veçimin e njërës prej poezive të vëllimit nga të tjerat, gjë vërtet e pamundur në një tjetër mënyrë dhe me një titull tjetër.

Veçse këtu lind pyetja: "Kangë në vete" në kuptimin "kangë e veçuar" mirëqëndron si titull cikli, por ç'kuptim do të kishte sintagma si titull poezie? Kjo e fundit është veçuar tashmë nga të tjerat; përse do të duhej të veçohej, përmes titullit, për të dytën herë dhe për më tepër, formalisht në të njëjtën mënyrë a me të njëjtin mjet? Dhe ç'mund t'i thotë lexuesit të një "kange" një titull i tillë, "kangë e veçuar"?

Si titull poezie në përgjithësi dhe akoma më tepër si titull i poezisë në fjalë, sipas nesh, një sintagmë e tillë ngjan e pakuptueshme, për të mos thënë e pamundshme: është krejt jashtë konceptit migjenian të titullimit të krijimeve të veta, titujt e të cilëve, pa asnjë përjashtim, sintetizojnë në një trajtë, të themi, *kerygmatike* matricat bazë të teksteve gjegjës.

Nga kjo perspektivë, titulli i poezisë që veçohet nga të gjitha të tjerat, do të duhej të ndiçonte në mënyrë sintetike pikërisht shkakun e këtij veçimi. E këtë ndriçim sintagma "Kangë në vete„ (si titull i poezisë) në kuptimin "kangë e veçuar", nuk e jep: ajo na ofron përkundrazi një tautologji absolute: kjo është një këngë e veçuar sepse është një këngë e veçuar.

Sipas mendimit tonë, të cilin do të përpiqemi ta shtjellojmë më pas, sintagma "Kangë në vete„ tjetër gjë shënjon si titull i ciklit dhe tjetër gjë si titull i poezisë homonime me të.

**b. Thyerje të normës sintaksore**

V.1: *Véri frynë pa mshirë, si véri që frynë*. Sintaksorisht një varg krejt i pazakontë ky, i ngatërruar. Nuk do të ishte i tillë nëse pjesa e dytë e tij do të përsëriste, në trajtë të përforcuar, informacionin që jep e para. Në të vërtetë nuk kemi një sqarim, por një krahasim, çka e bën shprehjen pothuaj tautologjike (veriu fryn pa mëshirë, si veriu që fryn). Nuk do të kishim një situatë të tillë nëse do të mungonte përemri lidhor "që", mungesë e cila do ta transferonte theksin logjik të sintagmës nga fjala "fryn" tek fjala "véri" për t'i dhënë asaj kuptimin "si(ç) véri frynë" (veriu fryn pa mëshirë, si(ç) fryn veriu. Do të theksohej në këtë rast cilësia inherente e objektit, 'pamëshirësia'. Fjalëza "që" e bën ndërkaq transferimin e theksit logjik të pamundur dhe vargun, ashtu siç është, në vështrimin e parë, të pakuptueshëm.

**c.Thyerje të normës sematike**

V.20: *unë i a mbylla derën t'eme me* ***rreze*** *mos të hyjnë*. Fjala 'rreze' do të duhej të kishte këtu padyshim si kuptim të parë atë të fjalës 'reze' – 'shul' a 'rrip i shkurtër hekuri me një grep, që mbërthehet në derë, në dritare etj. për ta mbyllur, duke e futur grepin në një unazë"[26]. Veçse jo vetëm në të folmen e Shkodrës e në gegnishten veriperëndimore në përgjithësi, por në asnjë nga të folmet e shqipes, 'rreze' nuk del si variant fonetik i 'reze'. Kemi të bëjmë me një dukuri të idiolektit të veprës. *Reze* është 'shndërruar' në *rreze*. Konteksti i ngushtë vargor 'e detyron' trajtën 'rreze' të shenjojë atë çka 'reze' shenjon – e kështu ajo mund të konsiderohet një *variant fonetik autorial* i kësaj fjale, por, siç do të përpiqemi të provojmë në vijim, trajta 'rreze' shenjon njëherësh atë çka për shqipfolësin nuk mund të mos shenjojë: "fill i hollë drite"[27].Ky agramatikalitet i dyfishtë semantiko-fonetik është i qëllimtë, pra mëse funksional në strukturën e përgjithshme të poezisë.

**d.Thyerje të normës morfologjike**

1. v.19: *unë i a mbylla derën t'eme me rreze mos të* ***hyjnë***. Kryefjala në njëjës (*Véri frynë pa mshirë…*) në vargun pararendës, e përforcuar kjo me trajtën e shkurtër 'i' ( unë i a mbylla…) do të kërkonte doemos kallëzuesin po në njëjës (mos të hynë), siç është fundja edhe në vargun e dytë dhe siç është redaktuar pothuaj në të gjitha botimet e poezisë duke supozuar se kemi të bëjmë një lajthitje të autorit. Do të shohim se edhe në këtë rast 'lajthitja' është e vetëdijshme dhe plotësisht funksionale.

**e. Thyerje të normës fonetike**

V.19: *Véri frynë pa mshirë, si veri që frynë*; kemi këtu dy variante fonetikë të fjalës me të cilën nis vargu. Variantit normativ 'Véri' të gegnishtes veriperëndimore i rri përkundër varianti jonormativ 'veri' (variant ndërkaq i përgjithshëm i toskërishtes dhe i vetmi normative i shqipes standarde), i cili, pa shenjën diakritike mbi grafemën 'e' nuk mund të shqiptohet ndryshe veçse me theks në rrokjen fundore, pra si 'verí'.

**f. Thyerje të normës grafematike**

V.17: *me atdhe e fé ndër andrrat e thata*. Është fjala për

mungesën e shenjës diakritike mbi grafemën 'e' tek 'atdhe', fjalë e cila pesë vargje më lart del në trajtën 'atdhé': *për fé dhe atdhé dhe i merituen këto premtimet e mija*. Në të vërtetë kemi të bëjmë këtu me një agramatikalitet *grafematiko-fonetik*, pasi mosprania e shenjës diakritike shënjon edhe një ndryshim kuantitativ: zanorja e gjatë 'é' tek 'atdhé' (v.12) është 'rrëgjuar' në zanoren normale 'e' në v.17: *me atdhe e fé ndër andrrat e thata*. Mund të mendohet se kemi të bëjmë me një harresë e rëndomtë të autorit në procesin e redaktimit të tekstit. Sipas bindjes sonë edhe ky agramatikalitet është funksional.

**XIII.**

Do të përpiqemi tani të ndriçojmë karakterin funksional të agramatikaliteteve.

**a. Funksioni i agramatikalitetit poetik**

Si mund të shenjojë sintagma "Kangë në vete" tjetër gjë si titulli i ciklit dhe tjetër gjë si titull i poezisë homonime me të?

Migjeni mendojmë se ka shfrytëzuar aftësinë e sintagmës "në vete" për të qenë ambivalente në vështrimin semantik. Këtë interpretim tonin e përforcon fakti se, në të gjithë veprën e poetit sintagma "në vete" nuk del *asnjëherë* në kuptimin "e veçuar nga të tjerat", por gjithmonë në kuptimin "e një veprimi a gjendjeje në vetvete": Kangë Përndimi, kangë njeriu të dehun nga *besimi në vete...*; *Humba në vete* vetvetiu…; zhytem *në veten teme*, fundosem në një subjektivizëm më t'ekstremtë; Shëtis, shëtis *i fundosun në vete*; Fjala misër *përmbanë në vete* legjenda…; Sa fort Dila që *i ndjen* të 17 vjetët *në vete*!; Me ke të rri, si të rri, e si të jetoj vazhdonte *tue mejtue në vete*; E Kola […] në mjerimin e tij u qesh dhe *tha në vete*; M'u hiq! - *britte* mâ shum *në vete* tue tundë kryet; E Lilusha *thellte në vete*"; Bjerri *besimin në vete*.

"Kangë në vete" është pra një *kangë* e pështpëritur ndër vete, një monolog i brendshëm i unit lirik, përmes të cilit ai nuk i drejtohet askujt, veç vetes, një kangë krejt e vëçantë përballë të gjitha të tjerave, të cilat nuk e ndrydhin 'në vete', por e shpallin, madje buçimshëm mesazhin.

Përse ky diskrecion kaq i madh i poetit? Arsyeja duhet të jetë ekzistenca e një problemi të madh, krejt të veçantë, thellësisht intim, absolutisht të rëndësishëm, të pashmangshëm, e një problemi veç kësaj, që duhet e mund të trajtohet vetëm një herë, vetëm në një poezi. Cili mund të jetë ky problem? Ka ardhur radha tashmë të sqarohet

**b. Funksioni i agramatikalitetit sintaksor**

Pakuptueshmëria e ngatërrimi hutues sintaksor i vargut të parë të poezisë (*Véri frynë pa mshirë, si véri që frynë,*) mund 'të shmangen' vetëm përmes dy 'rrugësh':

1. të pranojmë se *Véri* i parë simbolizon diçka të ndryshme që nuk ka fare të bëjë me *vérin* e dytë - atë (erën) që fryn. Por teksti vetë 'nuk ka fuqi' të na tregojë se ç'është pikërisht kjo diçka;

2. të pranojmë se kemi të bëjmë me dy homonime, se *Véri* i parë denoton diçka krejt tjetër nga ç'denoton *véri* i dytë. Por në shqipen një homonimi e tillë nuk njihet. Veç në mos paçim të bëjmë me një homonimi bilinge! Në të vërtetë kemi bindjen se kështu është.

Të arsyetojmë: *Kojshitë* i drejtohen *Vérit* në *gjuhë të huej*. Véri është pra diçka e huaj, një fuqi e huaj të themi. Por emri i një diçkaje të huaj, së cilës i drejtohemi në gjuhë të huaj, në gjuhën e vetë diçkasë, duhet të jetë normalisht a domosdoshmërisht *fjalë e asaj gjuhe*.

Por e cilës gjuhë? Në cilën gjuhë bashkimi tingullor *Véri* ka një kuptim, ekziston si fjalë më vete? *Véri* është njëra nga trajtat e paradigmës së lakimit të fjalës së serbokroatishtes *véra* (= fe, religjion, besim): *vér-a, vér-e, vér-i, vér-u, vér-o, vér-om, vér-i*[28]. Shërben si argument i fortë në mbështetje të kësaj hipoteze vargu 5 i poezisë: "*sa mirë e presin... megjithse nuk asht ditë vere*". Mbi anormalitetin e këtij vargu në kontekstin e tërë strofës, nëse supozojmë se Véri simbolizon fashizmin apo një fuqi tjetër, të çfarëdoshme – kjo nuk ka rëndësi, por e cila është doemos e rrezikshme, e pamëshirtë, ne patëm rastin të bëjmë fjalë më lart. Hipoteza jonë e shmang ndërkaq këtë anormalitet. Kujtojmë që *vere (vére)* është po ashtu një trajtë e paradigmës së lakimit të fjalës serbokroatishte *véra*. Vargu 5 do të mund të lexohej në këtë kontekst edhe kështu: "*sa mirë e presin... megjithse nuk asht ditë vere*"=megjithse nuk asht ditë kremte, ditë feje, ditë feste fetare, ditë në të cilën *Véri* (=struktura fetaro-kishtare ortodokse e ritit sllav, [e ritit të bashkësisë ortodokse të Shkodrës]) nuk mund të mos jetë e mirëpritur."

Por ajo, në të vërtetë, tradicionalisht ka qenë strukturë politiko-fetaro-kishtare, bërthama e serbizmit si fuqi shoviniste, në radhë të parë ndaj shqiptarëve, që nga kohët e Perandorisë së Nemanjëve, me detyrë asimilimin fetar dhe etno-kulturor të tyre.

Për ne teksti, në mënyrë gati të pashmangshme, na çon në përfundimin se me *Véri* aty simbolizohet jo fashizmi e as ndonjë 'izëm' tjetër përveçse shkurt e qartë *serbizmi*.

**c. Funksioni i agramatikalitetit semantik**

V.20: *unë i a mbylla derën t'eme me* ***rreze*** *mos të hyjnë*. Është fare e qartë tani që një pjesë e fjalëve-kyçe të poezisë bartin detyrimisht krahas kuptimit të drejtpërdrejtë edhe një kuptim të figurshëm. Por ato duhet të jenë 'të afta' për këtë. Dhe nëse nuk qëllojnë ashtu duhet 'të aftësohen' përmes deformimit për një funksion të tillë të dytë. Ky është rasti i fjalës *reze*, e cila duke mos mundur të hyjë, siç është, në lidhje koherente *edhe me aspektin e figurshëm të fjalëve* që e rrethojnë: *shtëpijat* (=hapësirat a banesat e shpirtit), *derë* (=portë e banesës së shpirtit), *Véri* (=erë shpirtërore

tjetërsuese) etj. 'shpërndërrohet' në *rreze*.

**d. Funksioni i agramatikalitetit morfologjik**

V.20: *unë i a mbylla derën t'eme me rreze mos të* ***hyjnë***. Tashmë *Véri* i ka bërë tërësisht për vete *kojshitë* e unit lirik, të cilët *nipa donë me mbetë, nipa të stergjyshnavet meleza dhe të letë. Véri* e *kojshitë* janë pra *një*. Këta jo vetëm janë tjetërsuar, jo vetëm identifikohen me *Vérin*, por edhe i bashkohen atij në betejën për tjetërsimin e unit lirik që ka vendosur të rezistojë. Pikërisht ky konfiguracion i ri shenjohet në mënyrë të përkryer përmes mospërputhjes së kallëzuesit në shumës *hyjnë* me kryefjalën në njejës *Véri*.

**e. Funksioni i agramatikalitetit fonetik**

V.19: *Véri frynë pa mshirë, si veri që frynë*. Le ta përqasim edhe një herë këtë me vargun nistor të poezisë: *Véri frynë pa mshirë, si véri që frynë*. Ne nuk e dinim në krye të herës se ç'ishte *Véri*. Përpos të tjerash, edhe 'turbullimi' sintaksor i këtij vargu ishte njëri ndër sinjalet që na e mundësoi zbulimin. Tashmë që ne e njohim identitetin e *Vérit*, nevoja për 'turbullim' sintaksor nuk ekziston më. Nuk ka pse të ekzistojë më homonimia bilinge, mundësuese e turbullimit. Kështu *véri* duhet të bëhet e bëhet *veri*, me theks pra në rrokjen fundore.

**f. Funksioni i agramatikalitetit grafematik**

V.17: *me atdhe e fé ndër andrrat e thata*. Renditja e ndryshme e fjalëve *fe, atdhe*, në këtë varg përqasur me v.12: *për fé dhe atdhé dhe i merituen këto premtimet e mija*, si dhe "rrëgjimi" i 'e'-së së gjatë në fjalën *atdhe* shenjojnë ndryshimin mes dy epokave në raportet e *Vérit* me *kojshit*: të epokës së raporteve me *stërgjyshnat* e të epokës së raporteve me *nipat*, çështje për të cilën folëm në pikën X.6. Në epokën e parë del se të rëndësishëm kanë qenë të dy përbërësit [të dy të theksuar, zanorja fundore e gjatë], por i pari në radhë ai i *fé*-së. Në epokën e dytë, kalohet shpejt në shqiptimin e *atdhe* [zanorja fundore jo e gjatë], kështu që përbërësja *fé*, ndonëse e dyta, del sërish kryesorja. Ne theksuam në pikën VII.2 që *Véri* mund të hyjë si *hajn* në shtëpijat e *kojshive*, ndonëse krejt i mirëpritur prej tyre, vetëm "nëse ka një ndalim, madje një ndalim të fortë. Nëse ndaluesit nuk janë kojshitë – të zotët e shtëpive, cila duhet të jetë fuqia ndaluese? Ku ndodhet ajo?". Mbetet që fuqia ndaluese të jetë një atdhe *tjetër, atdheu ku tash nipat ndodhen*, kundër të cilit *Véri* lufton, e për rrjedhojë lidhja e vetme 'esenciale', e pacënuar mes *Vérit e kojshive* të ketë mbetur *fé*- ja.

Problem në linjën e skemës sonë të leximit mund të paraqesë epiteti *meleza* i vargut 14: "*Dhe kojshitë e mi që i kam far'e fis, / nipat e stergjyshnavet meleza dhe te letë*,". Shuteriqi e Luka i japin fjalës përkatësisht kuptimet 'kodoshë, rrufjanë' e 'dallaverexhinj, të pabesë'.[29] Veçse, ndërkaq, kemi edhe një kuptim tjetër, më të përhapur e më të përgjithshëm të fjalës 'melez', kuptimi i cili hyn në rezonancë pikërisht me idenë që ne po kundërshtojmë, atë të një përkatësie etno-identitare të dyfishtë: "Melez,-e *mb.* 1. I lindur nga prindër që u përkasin dy racave të ndryshme, mulat; që ka dalë nga kryqëzimi i dy racave të ndryshme, i përzier; hibrid. Racë meleze. Fytyrë meleze.„

Nëse përcaktori *melez* do të kishte vërtet kuptimin *i përzier, hibrid*, vështruar nga pikëpamja e koherencës kuptimore, strofa e tretë semantikisht do të dilte mëse të turbullt. Dhe me të vërtetë, nëse *stërgjyshnit* kanë qenë, po themi etnikisht të përzier, si do të mund të lexoheshin vargjet: E *këta kojshitë e mi [...]/nipat e stërgjyshnavet meleza dhe të letë/ nipa donë me mbetë/nipa të vertetë/me atdhe e fe ndër andrrat e thata/që t'i meritojnë premtimet e kristalta*. Pra nipat e stërgjyshërve *të përzier* (etnikisht) dhe *të lehtë* (nga mendja) duan të mbeten nipa të vërtetë, edhe ata si stërgjyshërit pra, *të përzier* (etnikisht) dhe *të lehtë* (nga mendja).

Shtrohet pyetja: a mund të kemi dy epitete të bashkërenditur, njëri prej të cilëve me karakter absolutisht tregues (*melez* = i përzier etnikisht) ndërsa tjetri me karakter absolutisht vlerësues (*i letë* = që i sheh gjërat në mënyrë të përciptë, që nuk gjykon thellë, që nuk i merr punët në mënyrë serioze, mendjelehtë[31]), për më tepër kur këto cilësi mëtojnë t'i kenë edhe të tjerë? Për t'u shprehur më qartë, është e plotëkuptimtë të thuhet: "nipat duan të mbeten të lehtë (nga mendja) ashtu si stërgjyshërit e tyre; por sa kuptim ka të thuhet: „nipat duan të mbeten melezë, etnikisht të përzier, ashtu si stërgjyshërit e tyre?" E tërë strofa i mëshon aspektit qartësisht vlerësues në linjën ironike, kështu që një element me një përmbajtje absolutisht treguese aty do të ishte një trup i huaj, një trup i huaj të cilin konteksti semantik i strofës nuk e pranon. Mbetet të pajtohemi se fjala *meleza* ka në varg përmbajtjen kuptimore që asaj i japin Shuteriqi e Luka.

**XIV.**

Është krejt i qartë, sipas nesh, në kontekstin e të gjitha vlerësimeve të bëra deri më tani, konfiguracioni i botës poetike të unit lirik në poezinë "Kangë në vete". Por le t'i risjellim në vëmendje disa prej elementeve kryesore të këtij konfiguracioni duke i përqasur tash me elemente të botës së autorit empirik, Millosh Gjergj Nikollës.

1. *Véri* përfaqëson një fuqi agresive – teksti, sipas nesh, mundëson identifikimin e saj me *serbizmin* – që ka synuar e synon akulturimin fetar dhe etnik të një bashkësie tjetër (shqiptare në thelb, përderisa njëra prej gjuhëve të saj, jo e huaja, na thotë po teksti, është gjuha e tekstit vetë, shqipja) përreth unit lirik. Kjo veprimtari e *Vérit* ka qenë e vazhdueshme, por e përqendruar në dy epoka: a. në një epokë të hershme, paradisashekullore, të *stërgjyshnavet* dhe b. në epokën e tashme – e të tashmes së tekstit – në epokën e *nipave* e të unit lirik.

Një pjesë e *kojshive* të unit lirik (*stërgjyshnat e nipat*) i janë nënshtruar, nën presionin agresiv të *Vérit*, krejt akulturimit fetar, më shumë a më pak akulturimit etnik dhe njëfarësoj atij gjuhësor.

Ballafaqimi i botës së sllavëve të Jugut me botën iliro-arbëroro-shqiptare njeh, deri në kohën e Millosh Gjergj Nikollës, dy epoka kruciale: a. epokën e Perandorisë së Nemanjëve e të Car Dushanit dhe b. atë të pas themelimit të shtetit të pavarur shqiptar. Në të dyja epokat është kisha serbe – bariqendër politike e shtetit serb – bërthama e serbizmit si fuqi shoviniste, në radhë të parë ndaj shqiptarëve me detyrë asimilimin fetar dhe etno-kulturor të tyre.

**A.**

*"Zgjerimi i shtetit serb në drejtim të viseve shqiptare përbën një konstante të politikës së tij në mesjetën e mesme (shek. XII-XIV).*[32]

*"S'ka dyshim që kur flitet për gjendjen e trevave shqiptare nën sundimin serb, lind nevoja të bëhet që në fillim një dallim midis atyre që e përjetuan atë në një mënyrë të zgjatur, siç qe rasti i trevave veriore, dhe atyre që hynë në përbërje të shtetit serb për një periudhe të shkurtër disavjeçare. […] Ndryshe nga ç'ndodhi me trevat shqiptare, greke etj., në jug të tyre (të Kosovës, Malit të Zi (Zetës) e të Maqedonisë veriore – K.J.), ku pushtimi serb qe një fenomen kalimtar e si i tillë kaloi pa lënë pasoja të qëndrueshme, në këtë brez verior ku realizoheshinn në mesjetë kontaktet e popullsisë autoktone shqiptare me popullsitë e ardhura slave, sundim i tejzgjatur dyshekullor i shtetit serb u pasqyrua në ndryshime të ndjeshme në fushat shoqërore, politike e etnokulturore."*[33]

*"Shenjat evidente të një politike të caktuar fetare (dhe jo vetëm fetare) të shtetit serb, që e vinte këtë ballëpërballë me popullsitë e nënshtruara shqiptare, duken që në […] Kodin e Stefan Dushanit, hartuar, siç dihet, më 1349. Në nenin 6 të këtij neni lexohet: "[…] Në qoftë se ndonjëri nuk dëgjon të konvertohet në besimin e vërtetë, ai do të dënohet me vdekje, siç parashkruhet në veprat e Etërve të Shenjtë […]. Kush nuk do të konverohet do të humbasë krejt pasurinë e tij, kurse ai që do të kthehet në fenë e vërtetë do ta marrë përsëri pasurinë e konfiskuar."*[34]

*"Këmbëngulja e katolikëve dhe e ortodoksëve të ritit bizantin për të ruajtur identitetin e vet fetar, për të cilin flitet aq qart në Kodin e Dushanit, ishte në radhë të parë këmbëngulja e një popullsie joserbe për të ruajtur identitetin e vet etnokulturor."*[35]

**B.**

*"Në bazë të marrëveshjes së tutelës së pakicave nga ana e Lidhjes së Kombeve, që Shqipëria e kishte nënshkruar, këto pakica kishin të drejtë të kishin priftërinj të kombësisë e të gjuhës së vet. Një muaj para Kongresit të Beratit, Visarion Xhuvani, arkimandrit i Durrësit dhe metropolit i ardhshëm i Kishës ortodokse shqiptare, kish mundur të siguronte nga qeveria e Tiranës pëlqimin për emërimin e ardhëm të një peshkopi serb, Viktor, për pakicën slave të Shkodrës. […] Por historia e peshkopit serb u sugjeronte edhe grekëve dhe rumunëve të paraqitnin kërkesën për priftërinj për pakicat e tyre në Shqipëri. […] Autoritetet e Tiranës u frikësuan nga krijimi i një gjendjeje e cila, nag pikëpamja e tyre, ishte fort e rënduar dhe sigurisht më e keqe nga e mëparshmja: jo vetëm grekët do të kishin përsëri peshkopë të tyre në Shqipëri, pasi vitet e fundit ishin përzënë andej që të gjithë, por edhe jugosllavët dhe rumunët do ta kishin këtë të drejtë. Për një fare kohe qeveria shqiptare mori në konsideratë hipotezën për të thirrur një kongres të ri ortodoks që të shfuqizonte vendimet dhe masat e atij të Beratit. Se sa qeveritarët e Beogradit e kishin për zemër çështjen e peshkopit sllav të Shkodrës u vu re porsa Tirana, që s'e kishte njohur ende Viktorin, kërcënoi se do ta largonte jashtë kufijve. Jugosllavët për këtë ishin të predispozuar të prisnin marrëdhëniet diplomatike me shqiptarët, çka u shmang nga këta të fundit që kërkuan ndërmjetësimin e Romës, Parisit e Londrës pranë interlokutorëve të tyre dhe, më së fundi, pranuan qëndrimin në Shkodër të Viktorit në cilësinë e "mikut" të Shqipërisë dhe jo si prift i lidhur me patrikanën ortodokse serbe. Problemet e pakicës së vogël sllave nuk ishin pa rëndësi as për Beogradin, dhe as për Tiranën: trupat jugosllave kishin qëndruar në Shqipërinë e veriut nga viti 1918 deri më 1921 dhe rreziku i vazhdueshëm i Shtetit të vogël shqiptar në vitet e para të jetës së pavarur kish qenë ai i një copëtimi të tij ndërmjet grekëve në Jug dhe sllavëve (Sërbisë, Malit të Zi dhe pastaj Jugosllavisë) në Veri, për të mos përmendur synimet e popujve të tjerë pak a shumë fqinj."*[36]

2. Uni lirik është krejt i vetëdijësuar mbi akulturimin e pjesshëm etno-fetaro-gjuhësor të bashkësisë së vet, e njeh historinë e këtij procesi të gjatë dhe sa i takon atij vetë, është i rikulturuar etnikisht, në mbrojtje të shpirtit e ndjesisë etno-identitare të origjinës.

*"Më 28 qershor 1933, Seminari Orthodhoks i Shën Jan Theologut në Bitolje (Monastir), me të drejtë publike, […] e shpalli kandidat t'aftë për shërbim kishëtar, për mësim të fesë, dhe për studime intelektuale të lartë në fakultete universitarë. […] Nga kjo kohë në Bitolje dimë me të vërtetë se Milloshi, i cili ndjente dashuri të thellë për atdhenë e tij, ishte shkruar shqipëtar në atë shkollë, e dinte që atëhere gjuhën shqipe "siç e di çdo shkodran i shkolluar (për të përdorur shprehjen e një bashkënxënësi tiranas atëhere në Bitolje), hiqej shqipëtar; dhe grupi i studentëve shqiptarë, ndër të cilët Milloshi kishte shokë të ngushtë Jordan Misjan, Mirko, Nikolla dhe Zaharia Kadiqin, dhe Pandi Papanastasin nga Pogradeci, e njihte për eksponentin e tij moral."*[37]

*"Siç e përshkruan Pandi në ditar [*R. Idrizi na bën me dije se ka shfrytëzuar një ditar të P. Panastasit ruajtur nga Lasgush Poradeci – K.J.*], atij (*Migjenit – K.J.*) i kishte mbetur në mend pohimi i udhëtarit francez Zhari, që thotë se ndjenja kombëtare "ky nacionalizëm që ka mbijetuar dhe fituar mbi turkun dhe që njihej mirë e fort në shek.XIX, më i dukshëm ishte te shqiptarët. Nuk ishte as vetëm gjuha, as vetëm tradita apo historia, apo vetëm feja, por është koshienca kombëtare tek ata. Gjuha, feja, tradita, historia shërbejnë për të formuar, për të ruajtur ose për ta rritur ndërgjegjen kombëtare, porse ndjenja personale është vendimtare dhe jeton tek ata."*[38]

3. *Véri* e së toku me të edhe *kojshi-far'e fis* synojnë ta bëjë për vete unin lirik, ta tjetërsojë përmes premtimesh dhe atë, por ky i kundërshton fort këtë përpjekje.

*"Milloshin, Pandin, Jordanin, Teofanin, Vasilin e shokë të tjerë i zinte mëngjesi duke diskutuar. Manastiri ishte treva që ushqente intensivisht formimin e këtyre të rinjve. Çdo temë që hynte në bisedat e tyre merrte një ngjyrë politike, merrte një nerv patriotik […]. Milloshi merrte pjesë gjallërisht në këto diskutime dhe* ***e ndiente veten të çliruar plotësisht nga ato ankthe dhe detyrime familjare****. (*nënv. Ynë – K.J.*)"*[39]

*"Nga Podgorica po ay dajë që i pati nxjerrë bursën për në seminar, përpiqet tani, ndoshat pa e pyetur fare të nipin, t'i sigurojë një bursë për në fakultetin theologjik të Oksfordit me anën e Kishës Autoqefale Shqiptare, me gjithë se ay e dinte që më pare se Milloshi nuk dëshëronte të bëhej prift. Këtë qëndrim të Milloshit ne e dime me të vërtetë nga t'afërmit e tij. […] Siç e dimë, në pranverën e këtij viti (1933 -K.J.) u shtetëzuan gjithë shkollat në Shqipëri, si të minoritarëve a të huajat, si ato klerikale a nën kontrollin e kishës. Vraka është një fshat nja dy orë larg Shkodrës dhe përbëhej atëhere nga nja tetëdhjetë familje bujqsh slave, të varfër e të shfrytëzuar gjer në palcë; këto familje janë t'ardhura këtu prej kohësh e mbajnë akoma gjuhën, zakonet e kostumet e tyre, dhe shkollën, në të cilën jepeshin mësimet në gjuhën sërbe. Ministria e dërgoi Milloshin në s hkollë të shtetëzuar që t'i jepte tani mësimet në gjuhën shqipe.*

*Kur i erdhi Milloshit emërimi për këtu, konsullata e Mbretërisë jugosllave në Shkodër u përpoq edhe një here t'ia kthente mëndjen dhe e këshilloi përsëri të shkonte në Jugosllavi, ku mund të shërbente si prift në Banat ose të studjonte theologji në Beograd."*[40]

4. Ky qëndrim anti-*Véri* i unit lirik, qëndrim që duket paksa i përveçëm, ngjall reaksionin e tërbuar qoftë të *Vérit*, qoftë të (një pjese të) *kojshive far'e fis*.

*"Kur i erdhi Milloshit emërimi për këtu, konsullata e Mbretërisë jugosllave në Shkodër u përpoq edhe një here t'ia kthente mëndjen dhe e këshilloi përsëri të shkonte në Jugosllavi, ku mund të shërbente si prift në Banat ose të studjonte theologji në Beograd.*

*Mirëpo Migjeni ju përgjegj me gjuhën e një patrioti, duke thenë se, si shqiptar që ishte, dëshëronte të vihej në shërbim të atdheut e të popullit të vet. Kështu ngjau që e regjistruan në "librin e zi" të konsullatës; dhe së motrës më së voglës fare, Olga Nikollës, që studjonte në Sarajevo, në klasën e fundit të gjimnazit, ja prenë bursën ato dy muaj para matures, pa i dhënë kurrfarë shpjegimi.*

*Në këtë qëndrim, në qëndrimin patriotik të Milloshit në lidhje me shkollën shqipe, pra, gjejmë shkakun përse konsulli Bozheviqi, sekretari i tij Nikoliqi, ndonjë fare e fis i tij që simpathizonte me ata, si orthodoks a se vërtet me origjinë Malazeze, ordhodhoksët serbomanë, ish-mësuesit e shkollës sërbe, klerikët e ndezur prej konsullatës, dhe tok me këta edhe klerikët katolikë fanatikë dhe katolikët kundërshtarë të shkollës së shtetëzuar shqipe, banorët fanatikë të qytetit e të fshatit – të gjithë këto mbeturina të Mesjetës ia nisën kryqëzatës së shëmtuar kundër mësonjësit të ri të gjuhës shqipe Millosh Gjergj Nikollës. Ata shkuan aq larg në ligësinë e tyre sa të çpifnin se Milloshi një ditë kish hequr nga muri ikonën e Shën-Savës, protektorit të shkollave sërbe, dhe e paskësh shkelur faqe nxënësve!*

*Me të vërtetë, në fillim banorët e Vrakës, të ndezur nga armiqt e shkollës së shtetëzuar, e pritën shumë keq mësuesin e ri, si një armik të tyre, dhe i sillnin në çdo rast llojlloj ngatërresa: ja ndalonin nxënësit e nxënëset të vinin në mësim, bënin çmos që të mos ia furnizonin klasat me dru në dimer, që të mos ia kënaqnin në asnjë mënyrë nevojat, e të mos ia plotësonin asnjë mungesë. [...] Në Shkodër, ndër të rinjtë që shoqëroheshin të enthusiazmuar me Migjenin, përveç Jordan Misjas, të cilin e kishte patur shok shkolle në Monastir, ishin edhe dy të tjerë: biri i konsullit Bozheviqit, dhe Vojo Kushi. Këta të dy ishin shokë të pandarë të Milloshit. Një ditë biri i konsullit erdhi fshehurazi në shtëpinë e Milloshit dhe i tha: "Babai më ka dhënë urdhër të mos shëtis e të mos flas me ty, por unë të dua si vlla. Më fal!" E kur piqeshin udhës, në drejtim të kundërt, djaloshi sërb e shikonte me bisht të syrit dhe ulte kokën i turpëruar. Milloshi e shikonte dhe ay, dhe vinte buzën në gaz i mallëngjyer. […] Në verë të vitit 1935 […] kërkoi vizën nga konsullata jugosllave e Shkodrës. Këtu ia refuzuan kategorikisht."*[41]

*"[…] Teufik Gjyli na informon "Shumë ikona të vjetra dhe të prishura të kishës, ishin mbledhë në një qoshe, sepse prej kohësh ajo ndërtesë e vogël e shkollës ish njoftë si anekse e saj… E një nga ato ikona ish shkaku i shpërthimit të mnisë së kishës kundër mësuesit të shkretë, tue u ba çashtje me anë të konsulates jugosllave në Shkodër dhe Legatës në Ministrinë e Punëve të Jashtëme në Tiranë. E kjo…s'mori fund me gjithë bindjen e prokurorit për pafajësinë (e Migjenit)… Deri që u transferue (…) nuk pati asnjë që ankohej kundër tij, përpos Nikolla Mrenoviqit, shërbëtor i legatës jugosllave në Tiranë. Djali i këtij, nxë-*

*nës i Milloshit (familja e tij banonte në Vrakë atëherë dhe u shpërngul mbas një viti), padashje theu një nga ikonat (…). Mrenoviqi, që ishte armik i përbetuem i të gjithë ortodoksëve që bisedonin shqip, në mënyrë të veçantë i Migjenit, e përdori këtë ndodhi për të ngrit akuzën."*[42]

Dëshmitë biografike, historike, politike, religjioze si dhe ato brendatekstuale (të shumta, por te të cilat ne nuk u ndalëm) bindin se bota poetike e unit lirik të "Kangë në vete" paraqet analogji themelore me botën intime, botëkuptimore e historiko-sociale të autorit empirik, Millosh Gjergj Nikollës.

Me këtë krijim Migjeni ka dashur të na japë e na ka dhënë, në mënyrë super të koduar, të kriptuar mund të thuhej më mirë, përgjigjen e tij rrënjësisht të qartë, të plotë, të thellë e univoke për mundimin tonë të kahershëm, pyetjen mbi identitetin e tij etnik.

**XV.**

Para përfundimit të kësaj trajtese, në mbështetje të hipotezës sonë, shtojmë disa argumente ndërtekstualë:

**a. paratekste mjedjanë**

Nëse identifikimi brendatekstor që iu bë *Vérit* të poezisë "Kangë në vete", thënë përgjithshëm, me *serbizmin*, me thelbin e tij të gjithëkohshëm si *shovinizëm antishqiptar* e me trajta të veçanta që ai ka marrë përgjatë historisë, mund të duket për një çast paksa i kërkuar, gjejmë në traditën letrare shqiptare paramigjeniane të paktën një rast ku dëshmohet i njëjti identifikim, tashmë krejt eksplicit.

E kemi fjalën për poezinë "N'dekë të shoqit t'em Gj.Sh"[43] të Ndre Mjedës, disa prej strofave të së cilës i sjellim këtu:

*O prill i ri; ku Iliri*
*Zotnoi nji ditë ma së parit,*
*E kombi i huej s'e shtiri*
*Detin për n'tokë t'Shqiptarit;*
*Por lir'e fuqiplote*
*Shqypja dykrenore urdhnote,*

*Kur Topja i madh flamorin*
*Tand kundra t'huejit qiti,*
*Shqype, e kah ti krahnorin*
*T'mësuemit nën zgjedhë valviti,*
*E ndrroi n'liri robnimin*
*Nën* ***Vérin*** *e Prendimin.*

*Lëshohej ku i dekës ish shtegu*
*Mbi çeta t'Anadollit*
*I rrëmbyeshëm Skanderbegu*
*Si shkulmet e Devollit,*
*Si valët e j'projt që maja*
*Lëshon, e npër fushë bje rrkaja.*

*Pa t'gëzue përsëri, moj Shkodër,*
*Që m'bane djalë t'Shqypnisë*
*E n'hije t'njasaj kodër*
*Mburojës s'Iliris:*
*Eshtnat me i lanë, e urime*
*Me pritë prej kuj n'gjuhë time.*

Biografët e dom Ndre Mjedës dëshmojnë për nderimin e posaçëm që Migjeni kishte ndaj personalitetit të tij si dhe për vlerësimin po ashtu të lartë ndaj krijimtarisë letrare mjedjane. Lidhja ndërtekstuale e "Kangë në vete" me këtë poezi të Mjedës nuk mund të vihet sipas nesh në dyshim, jo vetëm për shkak të përkimit të përmbajtjes metonimike në thelb të njëjtë të fjalës Véri, por edhe për një varg përkimesh të tjera lehtë të konstatueshme, të cilat na krijojnë bindjen se "N'dekë të shoqit t'em Gj.Sh." e D. Ndre Mjedës duhet të ketë qenë një nga burim-frymëzimet për konceptimin e poezisë "Kangë në vete".

**b. paratekste biblikë**

Hasim në poezinë "Kangë në vete„ një varg reminishencash të qarta biblike, të cilat nuk kanë të bëjnë vetëm me një pjesë të fjalëve-kyçe të poezisë, si: *veri, portë, shul (reze), hajdut (hajn), shpirt*, apo me fjalë të tjera-kyçe që mund të konsiderohen me përgjegjëset biblike sinonime kontekstuale, por, ç'është më e rëndësishmja, edhe me konfiguracionin themelor të krijimit migjenian, siç u përpoqëm ta skicojmë, çka na e forcon bindjen në vërtetësinë e tij:

***a.*** *"Unë thashë: "Shoh një kazan dhe po i fryjnë zjarrit nën të. Gryka e tij është drejt Jugut. Zoti m'u përgjegj: "Nga Veriu do të vijë gjëma kundër tërë banorëve të vendit." (Jeremia, 1, 14)*

***b.*** *"Në kohët e fundit mbreti i Jugut dhe mbreti i Veriut do të shtyjnë njëri-tjetrin, dhe mbreti i Veriut do të sulet kundër tij si stuhi, me karroca, kalorës dhe me shumë anije. Do të hyjë nëpër vende të ndryshme, do të vërshojë e do të kalojë përmes." (Danieli, 11, 40)*

***c.*** *"Ja, njerëzit që ke në gjirin tënd janë si gratë. Portat e vendit tënd do të hapen patjetër para armiqve të tu. Shulat do t'i gllabërojë zjarri. Nxirr ujë për rrethimin. Forcoji vendet e fortifikuara." (Naumi, 3, 13)*

***d.*** *"Kush është ortak me hajdutin, e urren shpirtin e vet. Ai mund të dëgjojë një mallkim, por nuk tregon asgjë." (Proverbat, 29, 24)*

***e.*** *"Lëvdoje Perëndinë tënd, o Sion! / Ai i forcoi shulat e portave të tua; / i bekoi bijtë e tu që janë në gjirin tënd." (Proverbat, 147, 113)*

Thënë përmbledhtas, vargjet biblikë të sipërcituar tematizojnë me të njëjtat fjalë-kyçe, me trope fort të ngjashëm, me një strukturë kronotopike analoge, me një konfiguracion të përafërt të figurave-personazhe, pikër-

isht dramën e madhe të pushtim-akulturimit etnik prej një fuqie agresive të një entiteti, të dorëzimit tjetërsues para saj të një pjese të tij dhe të rezistencës shpirtërore ndaj saj të pjesës tjetër, dramë kjo që përbën edhe temën madhore të poezisë migjeniane "Kangë në vete" si dhe dëshminë e tij konspektivisht të plotë e të pakundërshtueshme mbi identitetin etnik të vetin dhe të bashkësisë ku bën pjesë.

**XVI.**

Në esenë "Ca kujtime mbi atë Gjeçovin" Faik Konica duke vënë në dukje ndër të tjera se françeskani i madh "ish lindur në një kufi gjuhërash, në një kufi ku sot mbaron shqipja dhe nis një tjetër" nënvizonte se "folësit e shqipes në vijën më të përparuar janë stërnipërit e atyreve që me qëndrimin e tyre në Kohën e Mesme dhe pastaj ndaluan të mprapsurit e vijës më tëhu," çka duhet t'u njihet si "një lavdi".[44]

Përveç se një poet gjenial i letërsisë shqipe Millosh Gjergj Nikolla është edhe një hero i shqiptarësisë. Nëse atë Shtjefën Gjeçovi – pjesë e një grupi, i cili në kufijtë ekstremë të arelit gjeografik të bashkësisë etnike ka arritur t'i bëjë ballë fuqisë së fortë të akulturimit etnik – është rasti i individit që me jetëveprën e vet jep dëshmi lapidare të përkatësisë së vet etno-kulturore, Migjeni ndërkaq – pjesë e një grupi që i është dorëzuar shumë a pak fuqisë së egër të akulturimit – është rasti i një individi paradoksalisht meritues i një lavdie po aq, në mos dhe më të madhe.

Ai jo vetëm e njeh këtë gjendje, jo vetëm nuk e pranon atë, jo vetëm shpërfill mirësitë që mund të vinin nga një qëndrim i kundërt[45] e që nuk munguan, jo vetëm është i vetëdijshëm për pasojat e rënda të zgjedhjes së vet, jo vetëm merr parasysh armiqësinë agresive "të të vetëve" – sllavë, mërinë mospranuese të të 'vetëve' – filosllavë e moskuptimin shpërfillës të të vetëve - shqiptarë, por i kundërvihet ballas autoritetit asimilues, ndeshet po ballas me të 'vetët' e prodhon për hir të vetvetes e të vetëve dëshmi shpirtërore lapidare të përkatësisë etno-kulturore të origjinës, një vepër poetike të nivelit epror, me të cilën, i bën të mundur sa vetes aq edhe grupit përtejperiferik e pothuajse të çbërë të hyjë i rikulturuar etnikisht bash në qendrën e sistemit letrar e kulturor kombëtar shqiptar.[46]

Migjeni, për ta mbyllur këtu sprovën tonë, nuk është pra 'shpirti sllav që flet shqip' (Pipa); ai është poeti i madh, trashëgues i shpirtit shqiptar dikur përgjysmë të sllavizuar që shqiptarizohet i tëri sërish; një hero, thamë pak më lart, një kryehero, themi tani – i shqiptarizmit.

**Shënime Bibliografike**

1. Ismail Kadare, *Poshtërimi në Ballkan*, Onufri, Tiranë, 2004, 59-60
2. Petro Janura, vep. cit, f.12
3. Arshi Pipa, *Miti i Perëndimit në poezinë e Migjenit*, cit. nga: Arshi Pipa, Për Migjenin. Tri esse, Princi, Tiranë, 2006, f. 60, 61.
4. Ismail Kadare, vep. cit., f. 60
5. Ali Aliu, *Rreth kritikës mbi veprën e Migjenit*, në: Migjeni, Vepra 4. Kritikë, Botimi i dytë, Zgjodhi e përgattiti për shtyp rrahman Dedaj, Rilindja, Prishtinë, 1980, f. 28
6. Në vitin 1944, Arshi Pipa, njëri ndër kritikët e parë të thelluar të Migjenit, do të formulonte kështu paradigmën e vet interpretuese: "Janë në këtë vëllim (*"Vargjet e lira" – K.J.*) gjithsejt 41 vjersha të ndame ndër gjashtë kapituj si vijon: "Kangët e Ringjalljes", "Kangët e Mjerimit", "Kangët e Përndimit", "Kangë në vete", "Kangët e Rinís" dhe "Kangët e fundit".

Kjo ndamje, mund të vrehet lehtë, nuk asht kronologjike por logjike. Janë përmbledhë në nji grup ato kangë që janë gjiní mes tyne. Edhe rendimi i ktyne asht bâ sipas nji plani. Poeti qi rrëfen ndër vargje historín e jetës së vet, Migjeni ka pasë kujdes t'u api ktyne kangëvet at zhvillim logjik nepërmjet të cilit jeta merr kuptim. E mbasi poezí e jetë te poeti i njimendtë janë synonime, e shofim Migjenin tue modelue jetën e vet mbas melodís së mbrendëshme. Kur vdes poezija e tij ka vdekë edhe aj. Burue nga rrajët e thella të jetës, poezija i prîn asaj tue e tejkalue: njef fatin e vet para se me e pasë jetue deri në fund." Arshi Pipa, *Historija e dhimbshme e shpirtit të ri*, Kritika, 1944, 3, 113

Pas gati gjashtë dekadash S. Hamiti, pohon në thelb mbijetesën e paradigmës pipaiane: "Nuk mund të thuhej se Migjeni, në cilësitë e tij themelore s'u kuptua në shfaqjen e tij. Asokohe kritiku i ri, më vonë kritiku i njohur, Arshi Pipa, që më 1944, duket që i pari artikuloi poetikën e Migjenit. Por, është fat i keq për kritikun e për shkrimtarin, që një mënyrë e tillë e leximit nuk u vazhdua për kaq decenie.

Rendi logjik i grupimit të vjershave në nivel të parë nxjerr në shesh temat themelore – kurse në nivelin tjetër një rrjedhë të rrëfimit në vargje të historisë jetësore të autorit e të ideve të tij." Sabri Hamiti, *Studime letrare*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Botime të veçanta. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Libri 21, Prishtinë, 2003, f. 499.

7. Nënvizonte me të drejtë Ali Aliu: "Një si e metë karakteristike dhe kryesore rreth mendimit kritik mbi veprimtarinë letrare të Migjenit, pa dyshim është prirja dhe synimi i tij për t'i thjeshtësuar dhe reduktuar ngjyrat dhe shtresat refleksivo-kuptimore që ndërthen në vete kjo vepër dhe, për të nvjerrë përherë vetëm një ide, vetëm një kuptim, vetëm një porosi. Për një shkrimtar siç është Migjeni ynë kjo është e pamundur. Për më shumë, një prirje e tillë do ta varfëronte nga nuancat e shumta këtë vepër." Po *aty*, f. 17.
8. Të ashtuquajturat "Kangët e fundit" (të shkruara thuajse të gjitha në vitin 1937) iu shtuan vëllimit në botimin e dytë të tij (1944). Nuk ka dëshmi të besueshme që kjo përfshirje të jetë bërë me vullnetin e autorit. Dimë ndërkaq me siguri të plotë se titulli i 'ciklit' nuk është autorit, por i botuesve.
9. Arshi Pipa, *Miti i Perëndimit në poezinë e Migjenit*, cit. nga: Arshi Pipa, *Për Migjenin. Tri esse*, Princi, Tiranë, 2006, f. 60-61.
10. Arshi Pipa, *Historija…*, cit nga: Arshi Pipa, *Për Migjenin. Tri esse*, Princi, Tiranë, 2006
11. Dhimitër Shuteriqi, *Antologji e letërsisë shqipe*, Shtëpia Botonjëse "Naim Frashëri", Tiranë, 1948, f. 385.
12. Migjeni, *Vepra*, Mbledhë e pajisë me shënime nga Gjovalin Luka, "Naim Frashëri",Tiranë, 1954, f. 57.
13. Dhimitër Shuteriqi, po *aty*, f. 385.
14 Moikom Zeqo, *Të dhëna të reja mbi jetën dhe veprën e Migjenit*, "Kombi", 26 shtator 1991, f. 4.
15. Petro Janura, *Vepra e Migjenit*, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 1985, f.12.
16. Roberto Moroko dela Roka, *Kombësia dhe feja në Shqipëri (1920-1944)*, "Elena Gjika", tiranë, 1944, f. 152-153.
17. Migjeni, *Veprat*. Mbledhur dhe redaktuar nga Skënder Luarasi, Ndërmarrja shtetërore e botimeve "Naim Frashëri", Tiranë, 1961, f. 221.

18. Migjeni, Veprat. *po aty*, f. 145.

19. Skënder Luarasi, *Jeta*, në: *Migjeni, Veprat*. Mbledhur dhe redaktuar nga Skënder Luarasi, Ndërmarrja shtetërore e botimeve "Naim Frashëri", Tiranë, 1961, f. 7-8

Ne do të vijojmë të japim më poshtë pak a shumë të plotë dëshminë e S. Luarasit: së pari, pasi ajo është një ndër pak burimet e rëndësishme dhe autoritative biografike mbi Millosh Gjergj Nikollën; së dyti, pasi kjo dëshmi, përkundër kësaj, shpesh 'harrohet', shpërfillet a bëhet si e mosqenë dhe, së treti, pasi ka aty fakte të shumta e tejet interesante, të cilat dëshmojnë pikërisht natyrën komplekse të problemit të identitetit etnik të Millosh Gjergj Nikollës, pikëpamje të cilën kjo spovë përpiqet ta argumentojë.

20. Arshi Pipa, *vep.cit.*, f. 54.

21. Roberto Moroko dela Roka, *vep. cit.* f. 56-57.

22. Andrea Stefi, *Shënime mbi veprën e Migjenit*, dorëshkrim, Arkivi i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë - Akademia e Shkencave, Tiranë, 1954, f. 4.

23. Konspektiviteti, dendësimi maksimal i mendimit, ka si rrjedhojë të drejtpërdrejtë jonormalitetin gjuhësor, domethënë thyerjen e rëndomtë të trajtave normative të kodit semiotik primar.

Sa më mirë zotërohet ky kod aq më fort përligjen thyerjet e normës gjuhësore, dhe e anasjellta. Në rast të moszotërimit të (mirë të) gjuhës, agramatikalitetet normalisht nuk mund të përligjen, janë të pafunksionalizuara (të pafunksionalizueshme), thënë ndryshe, gabime gramatikore të mirëfillta. Në rastin e një teksti konspektiv nuk mund të kemi thyerje të papërligjura të normës. Në një tekst konspektiv, shenja gjuhësore merr një *vlerë të shumëfishtë* dhe bëhet i detyrueshëm për këtë arsye respektimi maksimal i vullnetit të autorit.

Mbizotëron te Migjeni logjika e vizionit (i cili është mjaft i përqendruar) mbi logjikën gjuhësore normative. Në procesin e veshjes gjuhësore të këtij vizioni ndodhin thyerje të normës, por këto thyerje janë gjithnjë funksionale. Është pak të thuash se Migjeni e njeh mirë shqipen; ai *e sundon* atë. Detyrohemi të pohojmë se përcaktimet mbi gjoja njohjen elementare të shqipes nga Migjeni dëshmojnë për një moskuptim të rëndë të specifikës së tekstit letrar në përgjithësi e të atij migjenian (konspektiv) në mënyrë të veçantë.

Nëse Migjeni nuk do ta njihte mirë shqipen, ai jo vetëm nuk do të kundërshtonte, por do të kërkontë një korrektim gjuhësor të një kompetenti. Kujdesi për besnikërinë e riprodhimit të dorëshkrimeve, protestat e përsëritura ndaj redaksive në rastet kur ato vinin dorë në tekstet gjatë botimit, kërkesa për të korrektuar vetë, pas dy redaktimeve të botuesit bocat e vëllimit "Vargjet e lira" etj., dëshmojnë për vetëdijen e njohjes së mirë të shqipes. Reagim të ashpër dhe të menjëhershëm ndaj dhunimit të tekstit nuk mund të ketë një krijues që vuan, sado pak, nga kompleksi i moszotërimit të gjuhës në të cilën shkruan.

Pyetja që duhet të shtrojmë për zgjidhje është kjo: Vetëm natyra konspektive e veprës ka mundësuar, gjegjësisht ka përligjur agramatikalitetet? Apo këtë prirje të *sjelljes së lirshme* me kodin semiotik parësor e përforcon moszotërimi i mirë metodik i tij si rrjedhojë e mosshkollimit në gjuhën shqipe?

Duke përcaktuar si shkak organik të agramatikaliteteve natyrën konspektive të veprës dhe, pa dyshim, të subjektit krijues, nuk mund të mohohet fakti se idiolekti tepër specifik migjenian ka lindur në kushte të një lirie maksimale prej normës gjuhësore të përçuar nga shkolla dhe gjithashtu prej idiolekteve poetikë, [pak a shumë standardë] në vështrim të kësaj norme të poetëve dhe të shkrimtarëve klasikë të letrave shqipe pararendës ose bashkëkohës të Migjenit.

24. "La lettura delle opere letterarie ci obbliga a un esercizio della fedelta e del rispetto nella liberta dell'interpretazione. C'e una pericolosa eresia critica, tipica dei nostri giorni, per cui di un'opera letteraria si puo fare quello che si vuole, leggendovi quanto i nostri piu incontrollabili impulsi ci suggeriscono. Non e vero. Le opere letterarie ci invitano alla liberta dell'interpretazione, perche ci propongono un discorso dai molti piani di lettura e ci pongono di fronte alle ambiguita e del linguaggio e della vita. Ma per poter procedere in questo gioco, per cui ogni generazione legge le opera letterarie in modo diverso, occorre essere mossi da un profondo rispetto verso quell' che io ho altrove chiamato l'intenzione del testo." Umberto Eco, *Sulla letteratura*, Saggi Bompiani, Milano, 2002, f. 11.

25. Është e tepërt të thuhet se asnjë prej këtyre dallesave grafike nuk figuron në autografin e "Kangë në vete".

26. Jani Thomai etj., *Fjalor i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2006, f. 902-903.

27. *Po aty*, f. 924.

28. "La lingua croata o serba conta tre dialetti: l'orientale, l'oçidentale ed il meridionale (1), i quali fra loro non differiscono che nella pronunzia di una lettera, cioè dell'antica vocal ě (jat). Questa nel dialetto orientale suona e, nell'oçidentale i e nel meridionale je o ije. Es.: vêra (fede) – vera (orient.); vira (oçid.); vjera (merid.) […]

(1) Il dialetto meridionale è ora adottato anche dai Croati (i quali prima usavano ie invece dell'attuale ije, p. es.: rieč (parola) anzichè riječ); come pure dai Serbi della Bosnia-Erzegovina e del Montenegro. Al contrario il dialetto orientale è usato soltanto dai Serbi oltre il fiume Drina (la Serbia propriamente detta) e da alcuni Serbi al di qua della Drina i quali vogliono immitare lo stile della Serbia.". Giovanni Andrović, *Grammatica della lingua jugo-slava (croata o serba)*. Terza edizione riveduta ed ampliata secondo l'uso moderno, Editore – Ulrico Hoepli, Milano, 1934-XI, f. 3.

29. Shuteriqi e vijon kështu sqarimin: "Poeti mendon te sundimtarët e liq të popullit jugosllav në të kaluarën, që, nga mendjelehtësia e tyre mbaheshin me ëndërra për të shtrirë sa më shum sundimin, ëndërra që fshiheshin nën parrullat "atdhe e fe". Ata i meritojnë premtimet e gënjeshtra ("e kristalta") që u bën sot fashizmi. Me fjalë të tjera, poeti, i zemëruar, thotë: mirë t'ju bëhet." Dh. Shuteriqi, *vep. cit.* f. 385.

30. *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë, 1980, 1107.

31. *Po aty*, f. 960.

32. Pëllumb Xhufi, *Dilemat e Arbërit. Studime mbi Shqipërinë mesjetare*, Pegi, Tiranë, 2006, f. 251.

33. *Po aty*, f. 260, 267.

34. *Po aty*, f. 273.

35. *Po aty*, f. 276.

36. Roberto Moroko dela Roka, *vep. cit.* f. 56-57.

37. Skënder Luarasi, *vep. cit.*, f. 10, 11.

38. Rinush Idrizi, *Migjeni*, Shtëpia Botuese Enciklopedike, Tiranë, 1992, f. 60.

39. Rinush Idrizi, *po aty*.

40. Skënder Luarasi, *vep. cit.*, f. 15-16.

41. Po ai, *po aty*, f. 16, 17, 18.

42. Rinush Idrizi, vep. cit., f. 105-106.

43. Ndre Mjedja, *Vepra letrare*, "Uegen", Tiranë, 2002, f. 84-86.

44. Faik Konica, *Ca kujtime mbi atë Gjeçovin*, në: *Faik Konica, Vepra*. Mbledhur e përgatitur nga Nasho Jorgaqi e Xhevat Lloshi, "Naim Frashëri", Tiranë, 1993, f. 82.

45. Që Millosh Gjergj Nikolla mund të kishte vepruar lehtësisht ndryshe, siç nënvizon I. Kadare në citimin që i prin kësaj trajtese, e provon, sa për të sjellë një shembull, rasti i poetit Mateja Matevski, me origjinë po nga Reka e Dibrës, prindërit e të cilit flisnin shqip dhe të cilin maqedonasit e kanë cilësuar kur-e-kur poet kombëtar të tyrin.

46. Ne kemi bindjen se Millosh Gjergj Nikolla e vepra e tij do të kenë luajtur një rol të dorës së parë në procesin e rikulturimit etnik shqiptar të bashkësisë ortodokse shkodrane, të çlirimit nga dilemat e ambigui tetit etno-identitar të shumëkujt nga 'kojshitë-farefis', ambiguitet i cili, për një pjesë, duhet të ketë qenë realisht i thellë. Ndryshe nuk ka si shpjegohen pohimet kaq të sigurta të Shuteriqit e të Lukës, apo, aq më pak, pohimi pak si tepër ekskluziv i Dela Rokës.

Altin Stafa
Mjek Neuroradiolog
Bologna, Itali
altin.stafa@ausl.bologna.it

# Gjuha shqipe në shërbim të neuroradiologjisë bashkëkohore

# Albanian Language in Service of the Contemporary Neuroradiology

*"Eshtë e bukur ajo gjuhë që të ndihmon të shprehësh ndjenja fisnike…"* (Anonime)

Kurioziteti që mbartin në vetvete të ashtuquajturat "gjuhë të vogla", i ka shtyrë gjithmonë gjuhëtarët dhe antropologët të rrëmojnë në thellësitë e tyre fonetike dhe semantike. Por çfarë ndodh kur është vetë gjuha ajo që "gërmon" në thellësi të mekanizmave fiziologjike e nervore të cilët e shndërrojnë atë nga një grup tingujsh në një flamur të llojit fisnik Homo sapiens?

Çfarë ndodh në këndet e fshehtë të trurit të njeriut kur ai dëgjon një gjuhë që nuk e kupton? Si reagon korja e trurit të tij?

Literatura neurofiziologjike bashkëkohore është mjaft e pasur në këtë fushë dhe horizontet e saj po bëhen gjithonë e më të largët… Deri këtu, asgjë e re.

Risia qendron gjetkë: ndoshta për të parën herë, në një studim shkencor që mbart vlerën e një eksperimenti të vërtetë, shkenca mjekësore nën drejtimin e mjekëve neuroradiologë, thërret në ndihmë gjuhën shqipe!

**Qëllimi:** Përcaktimi me saktësi i zonave funksionale të kores së trurit (korteksi cerebral) që janë përgjegjëse për dekodifikimin gjuhësor, edhe në rastin e gjuhëve të panjohura.


**Vlera shkencore:** Kompletimi dhe konfirmimi i "hartës" funksionale të trurit.

**Vlera klinike:** Përgatitja e një strategjie të sigurtë preoperative, për t'i dhënë neurokirurgut mundësinë të ruajë të paprekura zonat e rëndësishme, gjatë ndërhyrjes kirurgjikale në pacientët me dëmtime të trurit, sidomos tumore.

Ky ishte një ndër objektivat e studimit të ekipit të mjekëve neuroradiologë të Departamentit të Neuroshkencave në Spitalin Bellaria të Bolonjës, Itali, nën drejtimin e Prof. Marco Leonardi dhe Dr. Raffaele Agati.

Për t'i paraqitur sa më qartë lexuesit jo specifik këtë argument të ndërlikuar, është i domosdoshëm një spjegim i thjeshtuar i pjesës teknike.

Dihet prej kohësh që truri i njeriut, dhe veçanërisht korteksi cerebral, është i organizuar në zona të caktuara, secila prej të cilave përgjegjëse për një proçes të veçantë: të parit, të ecurit, të folurit, të dëgjuarit, të kuptuarit etj. (Fig.1).




Objektivi i studimeve të këtij lloji, të shumta gjatë viteve të fundit, është ai i identifikimit të secilës zonë dhe të proçesit përkatës. Cila është zona përgjegjëse për një proces të caktuar? Si është e mundur t'i jepet përgjigje kësaj pyetjeje? Teknika që merr përsipër këtë detyrë është Rezonanca Magnetike Funksionale - RMF (*fMRI – Functional Magnetic Resonance Imaging*).

I gjithë truri i njeriut përshkohet nga një rrjet i dendur kapilarësh që furnizojnë me oksigjen neuronet, qelizat e trurit. Kur kryhet një proces i caktuar, p.sh. lëvizja e dorës, zona përgjegjëse në koren e trurit kërkon më shumë gjak për atë kohë aktivizimi. Gjaku që arrin në këtë rast (aktivitet me ritëm të lartë), mbart më tepër oksigjen në krahasim me fluksin e furnizimit në gjendje prehjeje (aktivitet me ritëm të ulët). Oksigjeni që kalon pranë neuroneve aktive mbartet nga hemoglobina. Në bazë të sasisë së oksigjenit, hemoglobina ndryshon orientimin e saj në brendësi të fushës magnetike gjatë ekzaminimit RMF. Pra, jemi në gjendje të dallojmë hemoglobinën me oksigjen nga ajo pa oksigjen. E, ky është edhe çelësi i këtij studimi.

Si zhvillohet eksperimenti?

Kryhet një ekzaminim cerebral RMF, tek një vullnetar në gjendje qetësie (prehjeje, me dorën të palëvizur). Më pas, kryhet i njëjti ekzaminim gjatë lëvizjes së dorës (lëvizje e përsëritur për 30 sekonda). Në fund, me anë të programeve kompjuterike të posaçme, kryhet një proces i ngjashëm me zbritjen aritmetike: nga imazhi i dytë hiqet imazhi i parë. Rezualtati është një zonë e vogël e "ndriçuar" nga një sinjal me intesitet më të lartë. Kjo është zona përgjegjëse për lëvizjen e dorës.

E njejta logjikë dhe e njejta strategji mund të përdoret për të identifikuar vendndodhjen e neuroneve përgjegjëse edhe për shumë proçese të tjera, p.sh. për proçesin e të

kuptuarit dhe dekodifikimit të gjuhës së folur.

Ja njera nga provat e kryera nga mjekët neuroradiologë të Spitalit Bellaria në Bolonja, Itali, gjatë studimit të tyre.

Gjatë ekzaminimit RMF, një vullnetari italian iu lexua një tekst në italisht dhe më pas një tekst në një gjuhë të panjohur për të, në shqip.

Legjenda e vjetër e Kostandinit dhe Doruntinës, simbol i lashtë i besës shqiptare, jehoi për pak minuta brenda tunelit të ftohtë të aparaturës së rezonancës magnetike…

Dhe ndonëse vullnetari italian i përqendruar për të perceptuar ndonjë fjalë gjysëm të njohur, nuk arrinte të imagjinonte trokthin e pluhurt të kalit të Kostandinit, rezultati përfundimtar ishte befasues.

Eshtë e njejta zonë cerebrale që aktivizohet si gjatë dekodifikimit të gjuhës së njohur ashtu edhe gjatë tentativës për të dekodifikuar një gjuhë të panjohur! (Fig.2 dhe Fig.3)

Struktura cerebrale përgjegjëse për dekodifikimin e kodit gjuhësor lokalizohet në lobin temporal të hemisferës cerebrale dominante: majtas për personat që përdorin dorën e djathtë dhe djathtas për mëngjarashët. Kjo strukturë, e njohur me emrin Zona 41 Brodmann, bashkëpunon me një tjetër zonë, Zona Wernicke ose Zona 42 Brodmann, e cila merret me logjikën sintaksore dhe interpretative të fjalisë.

Janë pikërisht këto dy zona që aktivizohen si në rastin e dekodifikimit të një gjuhe të njohur, ashtu edhe në përpjekjen për të dekodifikuar një gjuhë të panjohur.

Ky rezultat ka një rëndësi të veçantë klinike. Tek pacientët e prekur nga tumorët cerebralë, gjatë përgatitjes




**Fig. 2 - Aktivizimi cerebral kortikal gjatë dëgjimit italisht**




**Fig. 3 - Aktivizimi cerebral kortikal gjatë dëgjimit shqip**

së strategjisë së ndërhyrjes neurokirurgjikale, është e rëndësishme njohja e saktë e rrugës që duhet ndjekur për të bërë të mundur heqjen e tumorit, pa dëmtuar zonat funksionale të papushtuara nga tumori. Në këtë mënyrë, ndërlikimet pas operacionit janë më të pakta dhe rezultatet më pozitive.

Studimi i ekipit të neuroradiologëve të Spitalit Bellaria të Bolonjës, përfshiu një numër të madh zonash funksionale (lëvizje, dëgjim, prekje, etj.). Rezultatet e këtij studimi janë duke iu paraqitur këto ditë komunitetit shkencor ndërkombëtar.

Për rëndësinë klinike që ky studim paraqet dhe, pse jo, për kënaqësinë e natyrshme që të jep prezantimi i gjuhës nënë në burimet e shkencës bashkëkohore, autori i këtij artikulli, si mjek dhe si shqiptar, ndihet krenar për bashkëpunimin me këtë ekip mjekësh neuroradiologë.

*"Gjuha jonë, sa e mirë…!"*

P.S. *Ky artikull u mendua dhe u shkrua për një grup lexuesish jo specialistë në fushën e neurofiziologjisë dhe të neuroradiologjisë dhe ka për qëllim informacionin e përgjithshëm. Për më shumë informacione teknike, më poshtë renditen disa nga zërat e shumtë bibliografike që trajtojnë këtë argument në mënyrë të detajuar.*


D. Cevolani, R. Agati, L. Albini Riccioli, S. Battaglia, H. Hacker, M. Leonardi: *Pre-Surgical Use of Functional Paradigms in Brain fMRI Mapping: Our Initial 3 T Experience*, Rivista di Neuroradiologia, Volume 17, December 2004, p. 836.

B. Hakyemez, C. Erdogan, N. Yildirim, I. Bora, A. Bekar, M. Parlak: *Functional MRI in Patients with Intracranial Lesions near Language Areas*, The Neuroradiology Journal, Volume 19, June 2006, p. 306.

Christoph Stippich: *Functional magnetic resonance imaging (fMRI) of language and visual cortex*, Rivista di Neuroradiologia, Volume 16/Sup. 3, September 2003, p.15.

G. Basso, M.L. Gorno-Tempini, G. Calandra-Buonaura, M. Serafini, G. Pagnoni, L. Mavilla, C.A. Porro, P. Baraldi, P.F. Nichelli: *Localizzazione cerebrale funzionale delle aree del linguaggio per mezzo di un compito di decisione lessicale Functional Localization of Language Brain Areas by Means of a Lexical Decision Task,* Rivista di Neuroradiologia, Volume 13, February 2000, p. 139.

R. Schlösser, S. Hunsche, J. Gawehn, H. Böcher-Schwarz, A. Perneczky, G. Gründer, P. Stoeter: *fMRI Activation Paradigms for the Evaluation of Language Areas in the Human Brain Stability and Clinical Applications*, Rivista di Neuroradiologia, Volume 11/Sup 2, November 1998, p. 162.

P.M. Matthews: *Brain Plasticity and Clinical Applications of fMRI*, Rivista di Neuroradiologia, Volume 18, August 2005, p. 493.

Tharin S., Golby A.: *Functional brain mapping and its applications to neurosurgery*, Neurosurgery. 2007 Apr. 60 (4 Suppl 2): 185-201; discussion 201-2.

Lee A., Kannan V., Hillis A.E.: *The contribution of neuroimaging to the study of language and aphasia*. Neuropsychol. Rev. 2006 Dec. 16 (4): 171-83.

Smits M., Visch-Brink E., Schraa-Tam C.K., Koudstaal P.J., van der Lugt A.: *Functional MR imaging of language processing: an overview of easy-to-implement paradigms for patient care and clinical research*. Radiographics. 2006 Oct. 26 Suppl 1: S145-58.

Dr. Ardian Morina
School of Mechanical Engineering
University of Leeds
a.morina@leeds.ac.uk

# Aplikimi i parimeve të tribologjisë drejt përdorimit efikas të energjisë në automjetet motorike

# Application of tribology principles towards efficient use of fuel energy in automobiles

*Inxhineria përkufizohet si shkenca dhe arti i aplikimit të principeve shkencore dhe matematikore drejt adaptimit optimal të burimeve natyrore me qëllim zhvillimin ekonomik dhe rritjen e standardit jetësor të njerëzimit. Në këtë kuptim, rëndësi të madhe ka edhe tribologjia si degë e rëndësishme e saj. Në këtë artikull fillimisht është dhënë një hyrje e shkurtër për shkencën e tribologjisë dhe rëndësinë e saj. Shkrimi më pas përqendrohet në tribologjinë e komponentëve të motorëve të automjeteve motorike.*

**Tribologjia**

Tribologjia është shkencë ndërdisiplinore e cila studion fërkimin, harxhimin dhe lubrifikimin. Natyra ndërdisiplinore e saj rrjedh pasi sqarimi i fenomeneve komplekse te fërkimit, harxhimit dhe lubrifikimit mund të arrihet vetëm me analiza të detajuara të dinamikës së makinave dhe fluideve, me njohuri të plotë të metalurgjisë dhe veçorive fizike e kimike të materialeve në kontakt, mënyrës së lubrifikimit, gjenerimin dhe shpërndarjen e nxehtësisë në kontakt si dhe analizat e sforcimeve. Fjala tribologji është fjalë relativisht e re në fjalorin e botës shkencore. Për herë të parë është përdorur nga Profesor Peter Jost në raportin e tij të famshëm "Lubrication (Tribology) Research and Education", raport ky i porositur nga Departamenti Britanik i Edukimit dhe Shkencës dhe publikuar më 9 mars 1966. Kjo fjalë rrjedh prej fjalës greke *tribos* dhe përkufizon "shkencën dhe teknologjinë e sipërfaqeve në kontakt dhe në lëvizje relative ndaj njëra tjetrës, si dhe çështjeve dhe praktikave të lidhura me të".

Fërkimi është rezistenca që paraqitet ndaj lëvizjes tangenciale të një trupi të ngurtë ndaj një trupi tjetër. Në disa sisteme, si për shembull tek frenat, fërkimi është i dëshirueshëm por në shumicën e sistemeve inxhinierike ai është humbje e energjisë dhe duhet të minimizohet. Si pasojë e lëvizjes së një trupi ndaj një trupi tjetër, do të paraqitet dëmtimi i vazhdueshëm i sipërfaqeve kontaktuese, fenomen i cili është harxhim. Njëra ndër mënyrat e kontrollimit të fërkimit dhe harxhimit është lubrifikimi, një proces i krijimit të një shtrese të ngurtë, të lëngshme apo gazi në mes të dy trupave në lëvizje dhe në kontakt.

**Aspekte financiare të tribologjisë**

Shpenzimet e mëdha të sistemeve tribologjike në çdo ekonomi shtetërore janë shumica të shkaktuara prej humbjeve të mëdha në energji dhe materiale që paraqiten paralelisht në çdo paisje funksionale mekanike. Kur këto humbje shihen vetëm në një makinë ato nuk janë domethën nëse por po të konsiderohet se këto humbje paraqiten në miliona makina të tipit të njëjtë, atëherë shpenzimet janë tepër të mëdha. Është raportuar se me aplikimin e principeve bazë të tribologjisë, ekonomia e Britanisë së Madhe mund të kursejë 515 milion sterlina (në vlerë të vitit 1965) në vit[1]. Figura 1 tregon se në cilat drejtime mund të arrihen kursimet dhe nivelin e tyre.





**Figura 1. Kursimet ekonomike në Britaninë e Madhe përmes aplikimit efektiv të tribologjisë (në milionë sterlina të vlerës së vitit 1965)**

Analizat zyrtare ekonomike që janë bërë gjatë 40 viteve të fundit në disa shtete kanë treguar që vëmendja në tribologjinë e makinave, veçanërisht në edukim, punë hulumtuese dhe aplikim, mund të sigurojë kursime diku rreth 1.3-1.5% të Prodhimit Kombëtar Bruto të një vendi të industrializuar dhe 20% të kësaj mund të arrihet pa ndonjë

investim të madh. Për shembull, kursimet ekonomike që ekonomia e Britanisë së Madhe arrin nëpërmes aplikimit të principeve tribologjike janë afërsisht 9 miliardë sterlina në vit. Përveç përfitimeve financiare, aplikimi i principeve tribologjike ka ndikim masiv në parandalimin e ndotjes së mjedisit.

**Tribologjia e automjeteve motorike**

Aplikimi efektiv i principeve tribologjike në automjete motorike rezulton në reduktimin e fërkimit në motor dhe reduktimin e harxhimit të komponentëve lëvizëse. Si pasojë, efikasiteti i konsumit të karburanteve në automjete dhe jetëgjatësia e makinave do të rritet. Figura 2 tregon rritjen e vazhdueshme të efikasitetit të konsumimit të karburanteve në automjete që nga vitet e 70-të ku ndikim të madh ka edhe aplikimi i principeve tribologjike. Përveç përfitimit financiar, përmirësimi i efikasitetit të konsumimit të karburanteve çon në reduktim të konsiderueshëm të çlirimit të gazit $CO_2$ në atmosferë.





**Figura 2. Përmirësimi i efikasitetit të konsumimit të karburanteve në automjete (përshtatur nga 2)**

Automjetet e vogla të pasagjerëve dhe ata tregëtarë vlerësohen se çlirojnë rreth 20% të sasisë totale të $CO_2$ të çliruar në atmosferë prej burimeve hidrokarbure në SHBA[3]. Sipas statistikave të fundit të qeverisë britanike[4], në vitin 2005 vetëm në Britaninë e Madhe kanë qenë të regjistruara 33 milionë automjete motorike. Shikuar në nivel ndërkombëtar shifrat janë edhe më impresionuse: numri i përgjithshëm i automjeteve motorike në përdorim në Evropë, Japoni dhe SHBA është rreth 530 milionë automjete. Duke ditur që ky numër nuk përfshin të gjithë Azinë (pa Japoninë), Rusinë dhe shtetet tjera të ish-bllokut sovjetik, Australinë, Afrikën dhe Amerikën Jugore atëhere bëhet i qartë ndikimi i automjeteve motorike në ndotjen e mjedisit.

Reduktimi i emetimit të gazit $CO_2$ prej automjeteve mund të arrihet duke rritur efikasitetin e tyre nëpërmes reduktimit të konsumimit të karburanteve (rritjes së ekonomisë së karburanteve). Figura 3 ilustron mënyrat me të cilat mund të arrihet kjo[4]. Përparimet janë duke u arritur në të dy fushat 1 dhe 2 të paraqitura në figurën 3. Për shembull, reduktimi i peshës dhe i rezistencës aerodinamike[6] ka ndikim esencial në arritjen e zvogëlimit të shpenzimeve të karburanteve në 30% në veturen Volkswagen të tipit Lupo 3L TDI. Me zhvillimin e mëtejshëm të materialeve dhe lidhjeve të reja[7] dhe me përdorimin gjithnjë më të madh të kompoziteve dhe strukturave nanoinxhenierike në sektorin e autoindustrisë[8], pritet që trendi i zvogëlimit të peshës të vazhdojë.





**Figura 3. Teknikat për reduktimin e shpenzimit të karburanteve në automjetet motorike (përshtatur nga 5)**

Reduktimi i konsumit të karburanteve në automjete motorike, përveç rëndësisë në kontrollimin e ndotjes së mjedisit, ka shumë rëndësi në reduktimin e konsumit të energjisë në nivel botëror dhe varësinë nga lëndët djegëse fosile. Me maximumin e prodhimit të naftës të parashikuar për mesin e viteve 2010 e 2020, burimet e ripërtëritshme të energjisë do të duhet të jenë në gjendje të mbulojnë kërkesat gjithnjë më të mëdha për energji.

**Humbja e energjisë në motorët e automjeteve motorike**

Motorët me djegie të brendëshme janë makineria primare e automjeteve motorike. Figura 4 tregon komponentët kryesorë të këtyre motorëve, pistonin dhe sistemin e valvulave. Performanca e qendrueshme e këtyre motorëve është arsyeja që automjetet janë mënyra më e preferuar e transportit në botë. Mirëpo, këta motorë i kanë edhe disa të meta





**Figura 4. Komponentët kryesorë të motorëve me djegie të brendëshme[9]**

siç është shkalla relativisht e ulët e efikasitetit termik dhe mekanik ku një sasi e konsiderueshme e energjisë së fituar nga djegia e karburantit humbet si energji termike.





**Figura 5. Shpërndarja e energjisë në motorët me djegie të brendshme[10]**

Humbjet mekanike, të cilat janë kryesisht si rezultat i fërkimit, paraqiten në disa sisteme tribologjike të motorëve.





**Figura 6. Humbjet mekanike në motorët me djegie të brendëshme[10]**

Këto humbje në terma financiare janë shumë të larta. Për ilustrim, humbjet e përafërta vjetore për Shqipërinë dhe Kosovën[12] janë:

Kjo llogaritje është e mundur duke pasur parasysh numrin e automjeteve të regjistruara në Shqipëri[11] dhe Kosovë[12] si dhe duke supozuar efikasitetin e tyre të jetë mesatarisht 7l/100km.

Një reduktim prej 10% të humbjeve mekanike rezulton në reduktim prej 1.5% të shpenzimeve në karburante. Për shembullin e mësipërm këto kursime do të jenë:

Këto kursime mund të arrihen pa ndonjë investim por vetëm me përdorim të vajrave motorike të përshtatshme.

Sistemet tribologjike kryesore të motorëve me djegie të brendëshme janë kushinetat, sistemi i valvolave (boshti gungor, përcjellësat dhe valvolat) dhe sistemi i pistonëve (pistoni, unazat e pistonit dhe cilindri). Përdorimi i vajrave motorike të përshtatshme është vendimtar për fërkimin dhe një harxhim të kontrolluar. Specifikimi i vajrave motorike të optimizuar do të jetë kompromis në mes të qëndrueshmërisë së motorëve, efikasitetit të energjisë dhe kërkesave ligjore për çlirimin e gazrave. Pasi këto sisteme tribologjike punojnë në shpejtësi dhe ngarkesa të ndryshme, formulimi i një vaji të vetëm që do të reduktonte fërkimin, siguronte harxhim të ulët dhe qëndrueshmëri të motorit në tërësi është një sfidë e madhe.

**Reduktimi i humbjeve mekanike në motorë të automjeteve motorike**

Burimet e humbjeve mekanike d.m.th. humbjeve për shkak të fërkimit përcaktohen nga regjimi lubrifikues në të cilin sistemet tribologjike funksionojnë. Ky regjim është në funksion të kushteve mekanike si presioni kontaktues, shpejtësia dhe viskoziteti i vajit motorik.

Figura 7 tregon regjimet lubrifikuese për sistemet kryesore tribologjike të motorëve me djegie të brendëshme. Në sistemet tribologjike ku lubrifikimi kryhet me shtresë të plotë ndarëse të vajit si për shembull tek kushinetat, fërkimi përcaktohet nga veçoritë rheologjike të vajrave. Në rastin e sistemeve tribologjike që punojnë në regjimin e përzier dhe kufitar (sistemi i valvolave) fërkimi është funksion i përbërjes kimike të vajrave motorike. Në këto kushte fërkimi dhe harxhimi i ulët sigurohet prej formimit të një shtrese shumë të hollë dhe të qëndrueshme në kontakt, të njohur si triboshtresë. Triboshtresat formohen si rezultat i ndërveprimit në mes të aditivëve kimikë të vajrave me sipërfaqet e lubrifikuara. Legjislacionet që parandalojnë ndotjen e mjedisit i kufizojnë llojet e aditivëve kimike

| | |
|---|---|
| **Fuqia efektive (në rrota) gjatë udhëtimit në qytet**<br>**Çmimi i fuqisë së humbur/l (duke konsideruar euro1/l karburant)**<br>**Humbjet totale/vit për Shqipërinë (264.000 vetura, 14.2 km/l, 10.000 km/vit)**<br>**Humbjet totale/vit për Kosovën (250.000 vetura, 14.2 km/l, 10.000 km/vit)** | **12%**<br>**0.88 euro**<br>**~164.000.000 euro**<br>**~155.000.000 euro.** |
| **Kursimi vjetor pas reduktimit prej 10 % të humbjeve mekanike (14.5 km/l)** | **Shqipëria ~3.800.000 euro**<br>**Kosova ~3.600.000 euro** |

të vajrave që mund të përdoren duke e bërë procesin e reduktimit të harxhimit dhe fërkimit më sfidues.





**Figura 7. Regjimet lubrifikuese të sistemeve kryesore tribologjike në motorët me djegie të brendëshme (përshtatur nga 2)**

Reduktimi i viskozitetit (trashësisë) së vajrave motorike do të ketë ndikim të menjëhershëm në zvogëlimin e humbjeve të përgjithëshme të motorëve. Kjo është treguar në mënyrë skematike në figurën 8 me shigjetën e kuqe. Por me këtë rast, lubrifikimi efikas i sistemeve tribologjike që funksionojnë në regjimin kufitar dhe të përzier do të rrezikohet. Kjo parandalohet me përdorimin e aditivëve për redukim të fërkimit dhe harxhimit, siç janë Molybdenum Dialkyl Dithiocarbamate (MoDTC) dhe Zinc Dialkyl Dithiophosphate (ZDDP)[13,14], treguar në skemë me shigjetën e gjelbër.

Sipas kësaj, parimi kyç në formulimin e vajrave motorike me karakteristika të reduktimit të konsumit të karburanteve është reduktimi i viskozitetit (për të zvogëluar fërkimin në unazat e pistonit dhe në kushineta) përderisa në të njejtën kohë të shtohen aditivët kimikë (për të reduktuar fërkimin në sistemin e valvolave si dhe në unazat e pistonit)[15]. Kompleksiteti i këtij procesit rritet pasi shumë nga aditivët funksionojnë në kontakt me sipërfaqet e lubrifikura. Në këtë aspekt





**Figura 8. Minimizimi i humbjeve totale të energjisë në motorë me djegie të brendshme (përshtatur nga 15)**

është esenciale të merren parasysh ndërveprimet midis aditivëve në vaj dhe procesi i "garës" për pjesët aktive të sipërfaqeve në mënyrë që të sigurohet reduktimi optimal i fërkimit dhe mënjanohet harxhimi. Ky proces bëhet edhe më sfidues kur duhet të lubrifikohen materiale të ndryshme prej atyre të bazuara në hekur dhe aditivët e përdorur duhet të jenë pa ndikim negativ në ndotjen e mjedisit.

## Përfundime

Aplikimi i principeve tribologjike ka ndikim të madh në zvogëlimin e humbjeve të energjisë dhe materialeve si pasojë e fërkimit dhe harxhimit. Për çdo shoqëri kjo rezulton në kursime të konsiderueshme financiare por efekti maksimal arrihet me investime në edukim dhe punë shkencore hulumtuese. Në motorët e automjeteve dizajni, përzgjedhja e materialeve dhe vajrave motorike duhen bërë me kujdes për të siguruar që harxhimi i komponentëve lëvizës dhe fërkimi të jenë shumë të ulët. Përdorimi i vazhdueshëm i vajrave të përshtatshme motorike siguron që performanca e optimizuar e fërkimit dhe harxhimi i ulët të ruhen gjatë gjithë kohës që automjeti është në punë.

## Shënime Bibliografike

1 G. W. Stachowiak and A. W. Batchelor, "Engineering Tribology." Butterworth-Heinemann, 2001.

2. R. I. Taylor and R. C. Coy, *Proceedings of Institute of Mechanical Engineering*, Part J 214, 1 (1999).

3. A. Neville and A.Morina, in "Wear-Materials, Mechanisms and Practice" (G.W. Stachowiak, ed.). John Wiley & Sons Ltd, Chichester, UK, 2005.

4. DTLR. *Transport Statistics Great Britain 2006*, The stationery Office, London, 2006.

5. K. Ukuno and T. Bessho, *Surface Modification Technologies XIV*, Ed. T.S. Sudershan and M. Jeandin, ASM International, 135 (2001).

6. S. Curro, *Economical and earth-friendly, the Lupo 3L TDI*, AL Alluminio E Leghe., 119 (2000).

7. R. Powell, *JOM*, 49 (2002).

8. H. Presting and U. Konig, *Materials Science and Engineering C 23*, 737 (2003).

9. S.C. Tung, M.L. McMillan, *Tribology International 37*, 517 (2004).

10. C.M. Taylor, *Wear 221*, 1 (1998).

11. Banka Botërore, *Raport Nr. 29257-AL*, 2004, *Shqipëria: Ruajtja e rritjes së qendrueshme edhe përtej tranzicionit.*

12. Qeveria e Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifkimit Hapësinor, 2004, *Strategjia e Kosovës për mjedisin dhe zhvillimin e qendrueshëm.*

13. A. Morina, A. Neville, M. Priest, and J.H. Green, T*ribology Letters* 24, 243 (2006).

14. A. Morina, A. Neville, M. Priest, and J.H. Green, *Tribology International* 39, 1545 (2006).

15. S. Korcek, J. Sorab, M. D. Johnson, and R.K. Jensen, *Industrial Lubrication and Tribology*, 52, 209 (2000).

Rrok Ndoja
Matematikan
Kuvendi i Shqipërisë
rrokndoja@hotmail.com

# Shmangiet – një shteg hulumtimesh gjeometrike

# Deviations – A Path of Geometrical Investigations

Në këtë artikull, i cili paraqet vetëm një pjesë të momenteve dhe arritjeve të një punimi më të plotë në trajtë monografie** , nëpërmjet riparaqitjes në mënyrë sintetike të konceptit të shmangies së pikës nga drejtëza, kalohet në përgjithësimin e tij për një bashkësi të fundme drejtëzash, duke shkuar më tej me përdorimin e ponderimit me numra realë pozitivë.

Konceptet që krijohen dhe disa pohime që lidhen me to përbëjnë bazën e një metode të re për zgjidhjen e problemeve dhe për kërkim, metodës së shmangieve. Në mënyrë shumë të permbledhur, shoqëruar me disa shëmbuj zbatimi, sqarohet shkurt permbajtja, vlerat dhe përdorimi i kësaj metode. Ndër zbatimet më interesante dallohet përgjithësimi i konceptit të polares së një pike në lidhje me një bashkesi drejtëzash, prej të cilit mundësohet edhe zbulimi i ndonjë cilësie të re të panjohur më parë në disa figura e modele mjaft te njohura dhe tejet të studiuara.

**Fjalë çelës:** shmangie e pikës nga drejtëza, barasshmangie e pikave të planit, shmangie e ponderuar, vijë e nivelit të shmangies, vijë e nivelit të largesës etj.

Zanafilla e këtij punimi ka nisur me një shqyrtim të hollësishëm dhe të përgjithshëm të dy cilësive të thjeshta të njohura: *shuma e largësive të çdo pike të bazës së trekëndëshit dybrinjënjëshëm nga brinjët anësore është konstante* dhe *shuma e largësive të çdo pike të trekëndëshit barabrinjës nga brinjët e tij është konstante*. Duke e shtrirë problemin e barazimit të shumës së largësive të pikave nga brinjët për trekëndëshat e çfarëdoshëm, u vu re se, në përgjithësi, kur dy pika të konturit të një trekëndëshi e kanë të njëjtë shumën e largësive nga brinjët, të gjitha pikat e segmentit me skaje këto dy pika e kanë po aq këtë shumë. Interesimi për fatin e cilësisë në pikat e tjera të drejtëzës, jashtë segmentit në fjalë, më çoi në përfundimin se cilësia ruhej po të merreshin me shenjë negative, sipas një rregulli të caktuar, një ose dy prej këtyre largësive. Për këtë u gjet me vend si i nevojshëm fiksimi i një pike të çfarëdoshme brënda trekëndëshit (që më vonë u quajt *pikë reference*), në lidhje me të cilën të përcaktoheshin shenjat e largësive. Kësisoj, nga koncepti i largesës u kalua tek ai i *shmangies*, i cili më tej u përgjithësua në nivele të ndryshme për një bashkësi të fundme drejtëzash (pastaj pikash e planesh). Zhvillimi i mëtejshëm i ideve dhe rezultateve të punimit ka ardhur në mënyrë evolutive, kryesisht graduale, pa përjashtuar në raste të veçanta hopet, siç edhe ndodh në procesin e punës hulumtuese dhe krijuese.

**Shmangiet e pikave nga drejtëzat në plan**

Le të jenë në plan një bashkësi e fundme drejtëzash $\{d_1, d_2, ..., d_n\}$, një pikë O, jashtë çdonjërës nga drejtëzat e kësaj bashkësie dhe M, një pikë e çfarëdoshme.

***Shmangie e pikës M nga drejtëza $d_i$, në lidhje me pikën O***, quhet numri $\delta (M, d_i, O)$, që shpreh largësinë e pikës M nga drejtëza $d_i$, i marrë me shenjën – ose +, sipas rastit të ndodhjes ose të mosndodhjes së pikës M në gjysmëplanin e caktuar nga drejtëza di dhe pika O[1].

***Shmangie e pikës M nga bashkësia e drejtëzave*** $\{d_1, d_2, ..., d_n\}$ quhet numri $\delta (M, d_1, d_2, ..., d_n) = \sum_{i=1}^{n} \delta (M, d_i, O)$.

Shënimet e reduktuara $\delta (M, d_1, d_2, ..., d_n)$, $\delta (M, d_i)$, $\delta (M, O)$, $\delta (M)$ etj. përdoren kur nënkuptohet pjesa e informacionit që mungon. Pika O quhet ***pikë reference*** për shmangiet, shkurt, p.r. Kur dy pika reference shënohen O dhe $O_{(i, ..., j)}$, këto kanë ndërmjet tyre drejtëzat $d_i, \ldots, d_j$ dhe anasjelltas.


Nisur nga këto përkufizime, duke përdorur e kombinuar metoda analitike e sintetike, vërtetohen njëri pas tjetrit pohimet dhe rrjedhimet e mëposhtëme:

**Pohim 1:** Në qoftë se pika M ndan segmentin e orientuar $\overrightarrow{M_1M_2}$ në raportin $k=\frac{\overrightarrow{M_1M_2}}{\overrightarrow{MM_2}}$ dhe pikat $M_1$ e $M_2$ kanë përkatësisht shmangiet $\delta_1$ e $\delta_2$ nga $\{d_1, d_2, ..., d_n\}$, në lidhje me p.r-në O, atëhere: $\delta (M, d_1, d_2, ..., d_n, O) = \frac{\delta 1 + k\delta 2}{1 + k}$

**Rrjedhime:**

– Nëse $\delta_1 = \delta_2$, atëherë $\delta (M) = \delta_1$, d.m.th. të gjitha pikat e drejtëzës $M_1M_2$ kanë të njëjtën shmangie.

Piet Mondrian: Kompozim A (1923)



Një drejtëz të tillë e quajmë **vijë niveli e shmangies** $\delta$ **nga bashkësia e drejtëzave të dhëna, në lidhje me p.r.-në e dhënë**, shkurt, v.n.sh.

– Nëse tri pika jo në vijë të drejtë kanë të njëjtën shmangie, të gjitha pikat e planit kanë po atë shmangie. Themi se ka **barasshmangie të pikave të planit nga bashkësia e drejtëzave të dhëna, në lidhje me p.r.-në e dhënë**. Kuptohet, kur dy v.n.sh. priten, ka barasshmangie.

Meqë, për çdo bashkësi drejtëzash $\delta(O, d_1, d_2, ..., d_n, O) < 0$, barasshmangia e pikave të planit ka kurdoherë vlerë negative.

**Pohim 2:** Drejtëza paralele me një v.n.sh. nga $\{d_1, d_2, ..., d_n\}$ në lidhje me një p.r. O është gjithashtu v.n.sh. nga kjo bashkësi, në lidhje me atë p.r.

Drejtëza që nuk është v.n.sh. quhet **vijë thellësie e shmangieve**, shkurt v.th.sh. Çdo v.th.sh. mund të shihet si bosht numerik, në të cilin çdo pike i përgjigjet numri i vetëm real që shënon shmangien e saj dhe anasjelltas.

Kuptohet që mbi v.th.sh.-në shmangiet rriten vetëm në njërin kah dhe zvogëlohen në tjetrin. Marrëdhënies "ndërmjet" vendosjes së një pike në lidhje me dy të tjera i korrespondon këtu marrëdhënia përkatëse e vlerave të shmangieve të tyre dhe anasjelltas.

Duket lehtë se nëpër çdo pikë të planit kalon të paktën një v.n.sh. nga $\{d_1, d_2, ..., d_n\}$ në lidhje me një p.r. O.

Kur dy pika të planit kanë shmangie të ndryshme, nëpër çdo pikë të planit kalon vetëm një v.n.sh. (në të kundërt, do të kishte barasshmangie të pikave të planit). Në këtë rast, të gjitha v.n.sh-të janë paralele dhe të gjitha pikat me të njëjtën shmangie gjenden mbi një v.n.sh. Një pikë me shmangie pozitive ose zero mjafton për të provuar se nuk ka barasshmangie të pikave të planit.

Për të hequr prej një pike të dhënë $M_0$ një v.n.sh. nga bashkësia $\{d_1, d_2, ..., d_n\}$, në lidhje me një p.r. të dhënë O, mund të ndiqet kjo rrugë: në pikën O ndërtohet vektori $\overrightarrow{OR} = \sum_{i=1}^{n} \overrightarrow{e_i}$, ku $\overrightarrow{e_i}$ është vektor njësi me fillim në O pingul me $d_i$ dhe me kah drejt $d_i$.

Nëse $\overrightarrow{OR} \neq \overrightarrow{0}$, atëherë drejtëza që kalon në pikën $M_0$ pingul me $\overrightarrow{OR}$, është v.n.sh.-ja e kërkuar. Nëse $\overrightarrow{OR} = \overrightarrow{0}$, atëherë ka barasshmangie të pikave të planit, prandaj çdo drejtëz që kalon në $M_0$ është v.n.sh.

Për t'u bindur, shënohen në një sistem koordinativ këndrejtë ekuacionet e drejtëzave $d_i$: $a_ix + b_iy + c_i = 0$, ku $c_i < 0$, dhe për pikën fikse $M_0(x_0; y_0)$ e pikën e çfarëdoshme M(x; y) shprehet analitikisht kushti i barazimit të shmangieve të tyre nga $\{d_1, d_2, ..., d_n\}$.

Po të jenë $P_1, P_2, ..., P_n$ gjysmëplanet e caktuara përkatësisht nga drejtëzat $d_1, d_2, ..., d_n$, që përmbajnë pikën O, prerja e këtyre gjysmëplaneve formon një figurë konvekse[2], që e quajmë me emrin e përgjithshëm **konveksitet**. Nëse ndër drejtëzat $d_1, d_2, ..., d_n$ priten të paktën dy, atëherë konveksiteti që përftohet do të jetë i kufizuar nga një vijë e thyer e mbyllur ose jo dhe do të quhet sipas rastit **shumëkëndësh i kufizuar** ose **shumëkëndësh i pakufizuar**. Ky i fundit ka gjithnjë dy brinjë të pakufizuara, ndërsa të tjerat, po të ketë, i ka të kufizuara.

**Largesë të pikës M nga bashkësia e drejtëzave** $\{d_1, d_2, ..., d_n\}$ quajmë shumën e largësive të kësaj pike nga secila prej drejtëzave të kësaj bashkësie. Simbolikisht largesën e pikës M nga drejtëza $d_i$ e shënojmë: $d(M, d_i)$, ndërsa largesën e pikës M nga bashkësia $\{d_1, d_2, ..., d_n\}$:

$d(M, d_1, d_2, ..., d_n) = \sum_{i=1}^{n} d(M, d_i)$.

**Pohim 3:** Në qoftë se pika $M_2$ ndodhet në intervalin $M_1M_3$ ,skajet e të cilit nuk bëjnë pjesë njëkohësisht në asnjë prej shumëkëndëshave të përftuar nga bashkësia e drejtëzave $\{d_1, d_2, ..., d_n\}$

dhe $d(M_1, d_1, d_2, ..., d_n) \leq d(M_2, d_1, d_2, ..., d_n)$,

atëhere: $d(M_2, d_1, d_2, ..., d_n) < d(M_3, d_1, d_2, ..., d_n)$ .

**Pohim 4:** Shumëkëndëshi i përftuar nga $\{d_1, d_2, ..., d_n\}$ që përmban p.r.-në, në lidhje me të cilën ka barasshmangie të pikave të planit nga kjo bashkësi drejtëzash, është i kufizuar dhe i vetëm.

**Pohim 5:** Ndër të gjitha pikat e planit, pikat e atij konveksiteti të përftuar nga bashkësia e drejtëzave $\{d_1, d_2, ..., d_n\}$, që përmban p.r.-në, në lidhje me të cilën ka barasshmangie të pikave të planit, dhe vetëm ato, arrijnë vlerën më të vogël të largesës nga kjo bashkësi drejtëzash.

**Pohim 6:** Në qoftë se largesa nga një bashkësi e fundme drejtëzash $\{d_1, d_2, ..., d_n\}$ e një pike M, pikëprerje e disa prej drejtëzave të kësaj bashkësie, është jo më e madhe se largesa e çdo pikëprerjeje fqinje të saj që ndodhet mbi drejtëzat që kalojnë nga kjo pikë, atëherë në M arrihet vlera më e vogël e largesës nga bashkësia e drejtëzave të dhëna.

Koncepti i shmangies dhe ai i largesës zgjerohen dhe përgjithësohen më tej me anë të ponderimit me numra realë pozitivë.

– **Shmangie e ponderuar e pikës M nga drejtëza $d_i$, sipas numrit real pozitiv $k_i$, në lidhje me p.r.-në O**, quhet numri $\delta(M, k_id_i, O) = k_i\,\delta(M, d_i, O)$.

– **Shmangie e ponderuar e pikës M nga bashkësia e drejtëzave me elemente $d_1, d_2, ..., d_n$, sipas kufizave të vargut të numrave realë pozitivë $k_1, k_2, ..., k_n$, në lidhje me p.r.-në O**, quhet numri: $\delta(M, k_1d_1, k_2d_2, \ldots, k_nd_n, O) = \sum_{i=1}^{n} \delta(M, k_id_i, O)$.

– **Largesë të pikës M nga drejtëza $d_i$, të ponderuar sipas numrit pozitiv $k_i$**, quajmë numrin $d(M, k_id_i) = k_i\,d(M, d_i)$.

– **Largesë të pikës M nga bashkësia $\{d_1, d_2, ..., d_n\}$, të ponderuar sipas vargut të numrave pozitivë $k_1, k_2, ..., k_n$**, do të quajmë numrin $d(M, k_1d_1, k_2d_2, \ldots, k_nd_n = \sum_{i=1}^{n} d(M, k_id_i)$.

Largesa e ponderuar e çdo pike të konveksitetit ku ndodhet pika e referencës është e kundërta e vlerës së shmangies së ponderuar të saj në lidhje me atë p.r. (kupto: nga e njëjta bashkësi drejtëzash, të ponderuara sipas të njëjtit varg).

Të gjitha pohimet e renditura më sipër janë të vërteta edhe në rastin e shmangieve të ponderuara. Në formulimet e tyre, kudo ku thuhet **shmangie, barasshmangie, vijë e nivelit të shmangies, vijë e thellësisë së shmangies apo largesë** shtohet cilësimi **e ponderuar, sipas kufizave të vargut të numrave realë pozitivë $k_1, k_2, ..., k_n$**. Në simbolikën e shkurtuar, me iniciale, shtohet kudo p. (p.sh.: v.n.sh.-v.n.sh.p.; v.n.l.-vn.l.p.; v.th.sh.-v.th.sh.p. etj).

Argumentimi i ndërtimit të vijës së nivelit të shmangies së ponderuar (me iniciale: v.n.sh.p.) që kalon në pikën $M_0$, është i njëllojtë, veçse $\overrightarrow{OR} = \sum_{i=1}^{n} k_i \overrightarrow{e_i}$.

**Polarja e një pike në lidhje me një bashkësi drejtëzash**

Duke zgjedhur vargun e numrave realë pozitivë për ponderimin e shmangieve mund të zgjidhen e shpjegohen situata të ndryshme në marrëdhëniet që lindin në praninë e një numri të fundëm drejtëzash në plan. Në vijim po sjellim një zgjedhje që paraqet interes.

Le të jenë $x_1, x_2, ..., x_n$, largësitë nga drejtëzat $d_1, d_2, ..., d_n$ të një pike M që ndodhet jashtë çdonjerës prej drejtëzave të mësipërme.

Konsiderojmë vargun $\frac{1}{x_1}, \frac{1}{x_2}, \ldots, \frac{1}{x_n}$, që ka si kufiza të tij numrat e anasjelltë të vargut të largësive të pikës M.

Eshtë e qartë se $\delta(M, \frac{1}{x_1} d_1, \frac{1}{x_2} d_2, \ldots, \frac{1}{x_n} d_n, M) = -n$.

Lehtë bindemi se për n = 2 v.n.sh.p.-ja zero nga bashkësia $\{d_1, d_2\}$, sipas vargut $\frac{1}{x_1}, \frac{1}{x_2}$, kur si pikë reference merret pika M, koinçidon plotësisht me polaren e pikës M në lidhje me drejtëzat $d_1$ dhe $d_2$. Për n = 3, v.n.sh.p.-ja zero nga bashkësia $\{d_1, d_2, d_3\}$ sipas vargut $\frac{1}{x_1}, \frac{1}{x_2}, \frac{1}{x_3}$ koinçidon me polaren e pikës M dhe në lidhje me trekëndëshin[3]. Kjo polare nuk ekziston (zhduket në infinit), kur pika M është pikëprerje e mesoreve të trekëndëshit të përftuar nga drejtëzat $d_1, d_2$, dhe $d_3$. Në këtë rast ka barasshmangie të ponderuar të pikave të planit sipas atij ponderimi.

Në përgjithësi, **polare e pikës M ndaj bashkësisë $\{d_1, d_2, ..., d_n\}$** quhet v.n.sh.p.-ja zero nga $\{d_1, d_2, ..., d_n\}$, sipas vargut të inversëve të largësive përkatëse të kësaj pike nga drejtëzat e bashkësisë, në lidhje me këtë pikë, si p.r.

Kur drejtëza d është polare e pikës M, pika M quhet **pol i drejtëzës d**.

Në mbyllje të kësaj pjese teorike po paraqesim këtë përfundim të rëndësishëm:

Për çfarëdo bashkësi drejtëzash $\{l_1, l_2, ..., l_n\}$ që kalojnë përkatësisht në pikat $A_1, A_2, ..., A_n$ të një drejtëze d, polarja e një pike fikse M të kësaj drejtëze ndaj $\{l_1, l_2, ..., l_n\}$ ekziston dhe kalon nga një pikë tjetër fikse $M_0$ e kësaj drejtëze kur:

$\frac{1}{x_1}\overrightarrow{e_1} + \frac{1}{x_2}\overrightarrow{e_2} + \ldots + \frac{1}{x_n}\overrightarrow{e_n} \neq \overrightarrow{0}$, ku $\overrightarrow{e_1}, ..., \overrightarrow{e_n}$ janë vektorë njësi me drejtim e kah të njëjtë përkatësisht me vektorët $\overrightarrow{MA_1}, ..., \overrightarrow{MA_n}$, ndërsa $x_1, ..., x_n$ janë gjatësitë e këtyre të fundit. Pika $M_0$ mund të përcaktohet mbi drejtëzën (v.th.sh.p.-në) d, si ekstremitet i vektorit $\overrightarrow{MM_0}$, me vlerë algjebrike x, që plotëson barazimin:

$$\sum_{i=1}^{n} \frac{1}{\bar{x}_n} = \frac{n}{\bar{x}} \qquad \left(\bar{x} = \frac{n}{\sum_{i=1}^{n} \frac{1}{\bar{x}_n}}\right)$$

ku $\bar{x}_i$ shënon vlerën algjebrike të vektorit $\overrightarrow{MA_i}$.

Kur $\frac{1}{x_1}\overrightarrow{e_1} + \frac{1}{x_2}\overrightarrow{e_2} + \ldots + \frac{1}{x_n}\overrightarrow{e_n} = \overrightarrow{0}$, drejtëza d do të jetë v.n.sh.p. nga $\{l_1, l_2, ..., l_n\}$, sipas vargut $\frac{1}{x_1}, \frac{1}{x_2}, \ldots, \frac{1}{x_n}$. Në këtë rast, kur ekziston, polarja e pikës M ndaj $\{l_1, l_2, ..., l_n\}$ është paralele me drejtëzën d.

Prej sa u tha më lart, mund të pohohet, nga ana tjetër se:

Kur d është v.th.sh.p., atëhere: $\frac{1}{x_1}\overrightarrow{e_1} + \frac{1}{x_2}\overrightarrow{e_2} + \ldots + \frac{1}{x_n}\overrightarrow{e_n} \neq \overrightarrow{0}$.

Kur d është v.n.sh.p., atëhere: $\frac{1}{x_1}\overrightarrow{e_1} + \frac{1}{x_2}\overrightarrow{e_2} + \ldots + \frac{1}{x_n}\overrightarrow{e_n} = \overrightarrow{0}$. (*)

**2. Metoda e shmangieve. Zbatime**

Koncepti i shmangies së pikave, përgjithësimi i tij dhe disa nga arritjet teorike u dhanë vetëm për drejtëzat në plan, por ai shtjellohet po aq gjërësisht edhe për pikat në drejtëz dhe për planet në hapësirë. Ky koncept, siç duket edhe nga përkufizimi, është i lidhur ngushtë me atë të largësisë, i cili nga ana e tij hyn në marrëdhënie me shumë koncepte të tjera. Prandaj me anë të shmangieve mund t'u jepet përgjigje jo vetëm një vargu problemesh që trajtojnë marrëdhënie largësish, por edhe një numri problemesh që mund të kenë natyrë krejtësisht tjetër.

Përfundimet teorike që u shtjelluan deri këtu përbëjnë bazën e një metode që po e quajmë **metoda e shmangieve**. Në mënyrë të përmbledhur kjo metodë konsiston pak a shumë në sa vijon: ta zemë se disa objekte gjeometrike (pika, drejtëza, plane, ...) jepen në një situatë konkrete dhe kërkohet të zbulohet a të vërtetohet një marrëdhënie e caktuar midis tyre. Duke bërë zgjedhjet e përshtatshme, situata e dhënë përkthehet në situatë shmangiesh, shqyrtohet dhe zgjidhet si e tillë.

Kështu merret informacioni a përfundimi i nevojshëm, i cili interpretohet në gjuhën e problemit të shtruar që në fillim.

Me anë të kësaj metode zgjidhen në mjaft raste probleme të tilla si: vërtetimi i incidencës së tri a më shumë pikave mbi një drejtëz apo i komplanaritetit të dy a më shumë drejtëzave, përcaktimi mbi një drejtëz i vendit të një pike në kuptimin e relacionit "ndërmjet" ose i vendndodhjes së përpiktë të saj në lidhje me dy pika të tjera, përcaktimi i gjendjes së ndërsjellë të dy drejtëzave në plan apo të dy planeve në hapësirë, probleme të ndryshme të largesës si ato me minimum, maksimum, baraslargesë, disa probleme me kërkim vendi gjeometrik, kur ky i fundit rezulton drejtëz, plan, segment, shumëkëndësh, shumëfaqësh etj., etj. Probleme të

tilla ndeshen të standartizuara më vete ose në përbërje të problemeve të ndryshme të përziera.

Rol të rëndësishëm në zhdërvjellësinë dhe efektivitetin e metodës luan zgjedhja ose lëvizja e pozicionit të pikës së referencës. Zgjedhja e përshtatshme e p.r.-së krijon kushte të favorshme për llogaritje të thjeshtuara të vlerave të shmangieve, për të vjelë më lehtë informacion mbi largesat e pikave në një mjedis të caktuar (drejtëz, pjesë drejtëze, konveksitet, plan, hapësirë, ...) etj., ndërsa lëvizja e pozicionit të p.r.-së në përgjithësi ndërron situatën e shmangieve dhe jep mundësi për një këndvështrim të ri. Gjithashtu në efiçiencën e metodës një rol të posaçëm luan edhe përcaktimi i vargut të numrave që përdoret për ponderimin e shmangieve dhe të largesave.

Ndonëse, në tërësi, përdorimi i metodës kërkon krijimtari, për zgjidhjen e disa problemeve të veçanta mund të rekomandohen rrugë konkrete. Për shembull, ja se si veprohet në një rast për të vërtetuar se tri pika të një plani $M_1$, $M_2$, $M_3$ ndodhen mbi një drejtëz: Në një konveksitet të një bashkësie drejtëzash të pranishme merret një p.r. O, e tillë që në lidhje me të, të mos ketë barasshmangie të pikave të planit nga kjo bashkësi. Mbasi provohet se nga kjo bashkësi drejtëzash $\delta(M_1, O)$, $\delta(M_2, O)$, $\delta(M_3, O)$ janë të barabarta, problemi quhet i zgjidhur: tri pikat ndodhen mbi një v.n.sh. Në një rast tjetër, për t'ja dalë mbanë kësaj detyre, mund të përdoret ponderimi i shmangieve sipas një vargu numrash pozitivë të zgjedhur si duhet. Ka rast që për të provuar se dy drejtëza të dhëna janë paralele tregohet se këto janë v.n.sh.(p.) nga e njëjta bashkësi drejtëzash në lidhje me të njëjtën p.r., kurse për të provuar se dy drejtëza priten tregohet se njëra prej tyre është v.n.sh.(p.) ndërsa tjetra jo etj.

Metoda paraqet interes, veç të tjerash, për faktin se në një farë mënyre mbart edhe vlera euristike. Duke e përdorur me mjeshtri atë në rrethana të caktuara rastis që zbulohet ndonjë cilësi a marrëdhënie e re e panjohur më parë. E kjo ndodh edhe në figura ose modele tejet të studiuara si trekëndëshi, paralelogrami, trapezi, katërkëndëshi i plotë, katërfaqëshi etj.

Duhet pranuar objektivisht se metoda e shmangieve nuk mund të ketë një përdorim aq të gjerë e aq universal sa, bie fjala, metoda e koordinatave. Megjithatë, brenda një hapësire problematikash të caktuara, për përballimin e një vargu problemesh, ajo paraqitet origjinale, e fuqishme dhe nganjëherë edhe superiore në krahasim me metodat e tjera në qarkullim, mbasi hap shtigje interesante që të çojnë hera-herës në zgjidhje mjaft të lehta e befasisht të shkurtëra.

Shembujt e mëposhtëm, të dhënë vetëm në plan (ndonëse edhe këtu të pakët, për arësye vendi) mund të ndihmojnë në krijimin e një ideje më konkrete se si përdoret dhe si funksionon kjo metodë.

**Shembuj zbatimi**

*1. Të tregohet lloji i trekëndëshit dhe lloji i katërkëndëshit, në të cilin ekzistojnë tri pika jo në vijë të drejtë, në çdonjerën prej të cilave shuma e largësive nga brinjët është e njëjtë.*

– Po të vendoset p.r.-ja O brenda trekëndëshit ABC, tri pikat e dhëna sipas kushtit sigurojnë se ka barasshmangie të pikave të planit nga {AB, AC, BC}, prandaj $\delta(A, AB, AC, BC, O) = \delta(B, ...) = \delta(C, ...)$. Këto barazime tregojnë se lartësitë e trekëndëshit ABC janë të barabarta, pra që trekëndëshi është barabrinjës.

– Po të vendoset p.r.-ja O brenda katërkëndëshit konveks ABCD, tri pikat e dhëna sipas kushtit sigurojnë barasshmangien e pikave të planit nga {AB, BC, CD, DA}. Ky fakt bën të pamundur prerjen e përgjysmoreve AA' dhe CC' të këndeve të jashtme në kulmet A dhe C (pasi pika e prerjes do të kishte shmangien zero). Rrjedhimisht: $\hat{B} = \hat{D}$. Për të njëjtat arsye përgjysmoret BB' dhe DD' të këndeve të jashtme në kulmet B dhe D janë paralele, gjë që sjell: $\hat{A} = \hat{C}$. Pra, katërkëndëshi ABCD është paralelogram.

*2. Të provohet se pikat e prerjes së përgjysmoreve të këndeve të jashtme në çiftet e kulmeve të përkundrejta të katërkëndëshit të plotë ndodhen mbi një drejtëz.*

Për katërkëndëshin e plotë ABCDEF pikat $P_1$, $P_2$, $P_3$, janë prerjet e përgjysmoreve të këndeve të jashtme në çiftet e kulmeve (A, C), (B, D) dhe (E, F).


Po të jetë O një pikë brenda katërkëndëshit ABCD, atëherë: $\delta(P_1, AB,BC,CD,DA, O) = \delta(P_1, AB,DA) + \delta(P_1, BC,CD) = 0 + 0 = 0$.

Po kështu: $\delta(P_2, ...) = \delta(P_2, AB, BC) + \delta(P_2, CD, DA) = 0 + 0 = 0$.

Së fundi: $\delta(P_3, ...) = \delta(P_3, AB, CD) + \delta(P_3, BC, DA) = 0 + 0 = 0$.

Nga këto barazime del se $P_1$, $P_2$, $P_3$ ndodhen në një drejtëz, mbi v.n.sh.-në zero nga {AB, BC, CD, DA} në lidhje me p.r.-në O.

(Cilësia është shumë më e përgjithshme: Pikat e prerjes së polareve të një pike çfarëdo të planit ndaj çifteve të drejtëzave që kalojnë në kulmet e përkundrejta të një katërkëndëshi të plotë ndodhen në një drejtëz. Vërtetimi, duke përdorur shmangiet e ponderuara, është po kaq i thjeshtë).




3. *Gjatësitë e brinjëve të trekëndëshit ABC përballë kulmeve A, B, C janë a, b, c. Po të jenë $k_1$, $k_2$, $k_3$, tre numra pozitivë të dhënë dhe $x_1$, $x_2$, $x_3$, largësitë e një*

*pike çfarëdo M të planit nga drejtëzat BC, AC, AB, të gjenden ato pika të planit për të cilat funksioni $f(M) = k_1x_1 + k_2x_2 + k_3x_3$ merr vlerën më të vogël.*

Zgjidhja e problemit bazohet në krahasimin e raporteve $\frac{k_1}{a}, \frac{k_2}{b}, \frac{k_3}{c}$.

Në qoftë se $k_1 = k_2 = k_3$, atëherë $k_1h_a = k_2h_b = k_3h_c$, ku $h_a, h_b, h_c$, janë lartësitë e kulmeve A, B, C, përkatësisht të barabarta me $\frac{2S}{a}, \frac{2S}{b}, \frac{2S}{c}$.

Meqenëse: $k_1 h_a = d(A, k_1 BC, k_2 AC, k_3 AB)$
$k_1 h_b = d(B, k_1 BC, k_2 AC, k_3 AB)$
$k_1 h_c = d(C, k_1 BC, k_2 AC, k_3 AB)$,
atëhere ka barasshmangie të ponderuar të pikave të planit nga {BC, AC, AB} sipas vargut $k_1, k_2, k_3$, në lidhje me një p.r. O brenda trekëndëshit ABC. Në këtë rast çdo pikë M e trekëndëshit ABC arrin vlerën më të vogël të largesës së ponderuar nga {BC, AC, AB} sipas vargut $k_1, k_2, k_3$. Kjo vlerë është: $f(M) = d(M, k_1 BC, k_2 AC, k_3 AB) = d(A, ...) = k_1 h_a$

Nëse nga këto raporte vetëm dy janë të barabarta, p.sh. $\frac{k_1}{a} = \frac{k_2}{b}$ dhe $\frac{k_1}{a} < \frac{k_3}{c}$, atëhere $k_1h_a = k_2h_b < k_3h_c$. Në këtë rast vlera më e vogël e largesës së ponderuar nga {BC, AC, AB}, sipas vargut $k_1, k_2, k_3$, arrihet në çdo pikë M të segmentit AB. Kjo vlerë është:

$f(M) = d(A, k_1 BC, k_2 AC, k_3 AB) = k_1h_a$.

Sikur $\frac{k_1}{a} = \frac{k_2}{b}$ dhe $\frac{k_1}{a} > \frac{k_3}{c}$, dmth $k_1ha = k_2h_a > k_3h_c$, atëherë vlera më e vogël e largesës së ponderuar nga {BC, AC, AB} sipas vargut $k_1, k_2, k_3$ arrihet në pikën C. Kuptohet që kjo vlerë është: $f(M) = d(C, k_1BC, k_2AC, k_3AB) = k_3h_c$ .

Nëse këto raporte janë dy nga dy të ndryshme dhe ta zemë $\frac{k_1}{a} < \frac{k_2}{b} < \frac{k_3}{c}$, atëhere $k_1h_a < k_2h_b < k_3h_c$ dhe vlera më e vogël e largesës së ponderuar nga {BC, AC, AB}, sipas vargut $k_1, k_2, k_3$, arrihet në kulmin A, pra: $f(M) = d(A, k_1BC, k_2AC, k_3AB) = k_1h_a$.

4. *Të provohet që nëse drejtëza e çfarëdoshme d kalon në pikën M të prerjes së mesoreve të trekëndëshit, duke prerë brinjët e këtij në pikat P, Q, R, prej të cilave pika P ndodhet e vetme në njërën anë të pikës M, atëhere:*

$$\frac{1}{MP} = \frac{1}{MQ} + \frac{1}{MR}$$

Vërtet, nëse A, B, C dhe M janë kulmet dhe pikëprerja e mesoreve të një trekëndëshi, atëhere $\delta(A, \frac{3}{h_a}BC, \frac{3}{h_b}AC, \frac{3}{h_c}AB, M) = -3$ dhe po kështu $\delta(B, ....) = -3$ e $\delta(C, ...) = -3$. Do të thotë se në lidhje me pikën M, ka barasshmangie të ponderuar të pikave të planit sipas vargut të inverseve të largësive të kësaj pike, të marrë si p.r. Nga kjo rrjedh se çdo drejtëz që kalon në M është v.n.sh.p. që plotëson kushtet e pohimit (*) të faqes 45, që në këtë rast shpreh barazimin e kërkuar

5. *Drejtëzat d dhe d' që kalojnë në qendrën e rëndesës G të trekëndëshit të formuar nga drejtëzat d1, d2, d3 i presin këto të fundit përkatësisht në pikat A, B, C dhe A', B', C'. Të provohet se pika G është gjithashtu qendër rëndese edhe për çdo trekëndësh tjetër të përftuar nga drejtëzat që kalojnë në pikat A, B, C dhe secila dallimisht në njërën prej pikave A', B', C'.*

Vërtet, për çdo trekëndësh konkret të përftuar kësisoj (p.sh.: i drejtëzave AB', BC', CA'), meqë pohimi (*) plotësohet mbi secilën prej drejtëzave d dhe d', këto të fundit janë v.n.sh.p. nga bashkësia e drejtëzave brinjëmbajtëse të trekëndëshit në shqyrtim, sipas inverseve të largësive përkatëse të pikës G prej tyre, në lidhje me këtë pikë, të marrë si p.r., Ka, pra, barasshmangie të ponderuar asisoj të pikave të planit, kështuqë pika G rezulton qendër e rëndesës edhe për këtë trekëndësh (Në rastin e fiksuar, po të jenë P, Q, R kulmet e trekëndëshit përballë drejtëzave AB', BC', CA' , barazimi $\delta(P, AB', BC', CA', G) = -3$, tregon se $d(P, AB') = 3d(G, AB')$. Po kështu prej barazimeve $\delta(Q, ...) = -3$ dhe $\delta(R, ...) = -3$ njëlloj rrjedhin: $d(Q, BC') = 3d(G, BC')$ dhe $d(R, CA') = 3d(G, CA')$).

## Shënime Bibliografike

**Monografia: *Shmangiet-një shteg hulumtimesh gjeometrike*, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2006 - Recensentë: Prof.Dr. Agim Karçanaj, Nikolin Preka, parathënie nga Prof. Aleko Minga, ISBN 99943-909-1-0

Referenca:

[1] Ndoja Rr. *Shmangiet – një shteg hulumtimesh gjeometrike*; Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2006.

[2] *Enciklopedija elementarnoj matematiki*; vëll. V, Moskë, 1966.

[3] *Matematiçeskij enciklopediçeskij sllovar* (Sovj. Enciklopedija.), Moskë, 1988.



# Leonhard Euler (1707-1783)

Leonhard Euler lindi në Bazel, Zvicër, më 15 prill 1707 dhe vdiq në St. Petersburg, Rusi, më 18 shtator 1783. Ishte djali i Paul Eulerit, një ministër protestant dhe Margaret Brucker, vajza e një tjetër ministri protestant.

Euler konsiderohet si një nga matematikanët e mëdhenj të të gjitha kohërave dhe më shquari i shek. XVIII. Ai zbuloi shumë koncepte të rëndësishme dhe provoi teoremat matematike në fushat e njehsimeve të mbyllura ose të rrethuara, të teorisë së numrave dhe të topologjisë. Në punën e tij shkencore Euler përshkroi thellësisht konceptet më të rëndësishme të funksionit matematik, ashtu siç njihen edhe sot në terminologjinë e matematikës moderne. Veçanërisht, kontributet e tij të mëdha njihen në degët e gjeometrisë analitike, trigonometrisë, teorisë së numrave, gjeometrisë dhe njehsimeve matematike. Për Eulerin janë shkruar plot 87 libra e artikuj, ndër të cilat përmendim:

– ***Biography in Dictionary of Scientific Biography*** (New York 1970-1990).
– ***Biography in Encyclopedia Britannica***
– M. J. Condorcet, ***Eulogy for Euler***
– C. B. Boyer, ***The Age of Euler, in A History of Mathematics***
– R. Fueter, ***Leonhard Euler*** (Basel,1948).
– ***Leonhard Euler 1707-1783: Beiträge zu Leben und Werk*** (Basel-Boston, 1983).
– G. du Pasquier, ***Leonhard Euler et ses amis*** (Paris, 1927).
– O. Speiss, ***Leonhard Euler*** (1929).
– R. Thiele, ***Leonhard Euler*** (Leipzig,1982).

Babai i Eulerit dëshironte që djali i tij ta ndiqte në kishë dhe e dërgoi në Universitetin e Bazelit për tu përgatitur për ministër kishtar. Kështu, ai hyri në Universitet në vitin 1720, kur ishte 14 vjeç, fillimisht të merrte një edukim të përgjithshëm, para se të fillonte studimet e specializuara. Johann Bernoulli shumë shpejt zbuloi potencialin e madh për matematikë të Eulerit gjatë shkollimit privat që ai kryente. Në vitin 1723 Euler merr diplomën Master për filozofi, duke bërë krahasimet dhe kontrastet me idetë filozofike të Descartes dhe Newtonit. Ai filloi studimet për teologji në vjeshtë 1723, i ndjekur nga dëshirat e babait të tij, por duke qenë se ai duhej të bëhej besnik kristian gjatë tërë jetës, nuk mundi të gjejë atë entuziazëm për teologjinë, greqishten dhe hebraishten, sa e gjeti për matematikën. Euleri kryen studimet në vitin 1726. Gjatë kësaj kohe në Bazel ai studioi punën e shumë shkencëtarëve të mëdhenj si: Varignon, Descartes, Newton, Galileo, van Schooten, Jacob Bernoulli, Hermann, Taylor apo Wallis.

Pierre Louis Moreau de Maupertuis ishte President i Akademisë së Berlinit ku Euler u caktua si drejtues i matematikës. Më pas u bë profesor i fizikës në Akademi më 1730 dhe më vonë u bë anëtar me të drejta të plota të saj. Gjatë kohës së qendrimit prej 25 vjetësh në Berlin Euler shkroi rreth 380 artikuj dhe vazhdoi të marrë pjesë të pagës nga Rusia e me këtë pagesë ai bleu libra dhe instrumenta për Akademinë e St. Petersburgut. Pas vitit 1730 puna kërkimore shkencore e Eulerit përqendrohet në kartografi, teorinë e numrave, mësimin e shkencës, njehsimin e variacioneve, ekuacionet diferenciale, magnetizmin, ndërtimin e anijeve, makinave, mekanika racionale etj. Publikimet e shumë artikujve dhe libri i tij *Mechanica* (1736-37), të cilat prezantuan për herë të parë dhe gjerësisht dinamikën Njutoniane në formën e analizës matematike, ishin një kontribut i madh në fushën e matematikes. Euler sistemoi matematikën me anën e përshkrimit të simboleve: ***e*** - numri i Neperit dhe ***f(x)*** për f një funksion i x. Gjithashtu, ai ka kontribute të mëdha edhe në optikë, mekanikë, elektricitet dhe magnetizëm. Artikulli i tij *Introducio in analysin infinitorum* (1748) i ndarë në dy pjesë, hodhi themelet e analizës matematike. Libri i tij i parë për njehsimet diferenciale ishte *Analysis Infinitorum*, i cili u ndoq nga Institutiones Calculi Differentialis dhe ishte futur aty si një përshkrim më 1755. Seria e punëve të Eulerit kompletohet nga publikimet e bëra në tre vëllime përsëri nga the Institutiones Calculi Integralis (1768-1770). Më 1770 Euler publikon *Anleitung zur Algebra* në dy vëllime, i cili u përkthye frengjisht nga Lagrange më 1794. Në hidrodinamikë Euler krijoi dhe futi ekuacionet e përgjithshme të lëvizjes. Puna e tij më e rëndësishme në astronomi është *Theoria Motuum Planetarum et Cometarum*, publikuar më 1744, *Theoria Motus Lunaris*, më 1753 dhe *Theoria Motuum Lunae* më 1772. Gjatë viteve 1770-1771 ai publikoi kërkimet e tij shkencore në optikë në tre vëllime me titullin *Dioptrica*. Së fundi, shkroi edhe disa punë elementare në fizikë dhe mbi disa parime themelore të filozofisë matematike të publikuara në vitet 1768-72 në tre vëllime me titull *Lettres ... sur quelques sujets de physique...*, të cilët për gjysëm shekulli qëndruan si një libër mësimor standard për atë fushë.

**Pregatiti Arben POROÇANI**

Denar Biba
M.A.
Universiteti "Kristal",
Tiranë

# Roli dhe pozita e prokurorisë në shtetin e së drejtës

# The Prosecution's Role and Position in the Rule of Law

Tashmë, kur prej më shumë se një dekade e gjysmë bota perëndimore rrëzoi edhe murin e fundit ndarës, marrëdhëniet ndërmjet individëve dhe shteteve po njohin vetëm rritje. Procesi është pasuar, për të mos thënë nxitur, edhe nga përparime pa precedent të teknologjisë dhe infrastrukturës. Demokratizimi, ekonomia e tregut dhe globalizimi i pashmangshëm, janë fenomene që në një mënyrë a në një tjetër po rimodelojnë jetët tona.

Nga ana tjetër, nuk mund të mohohet se këto zhvillimeve të mirëpritura janë bashkëshoqëruar edhe nga rritja e të gjitha llojeve të kriminalitetit, intensifikimi dhe sofistikimi i formave të tij. Është pikërisht një situatë e tillë, që kërkon në mënyrë të detyrueshme një forcim të mëtejshëm të luftës ndaj krimit nga të gjitha instancat shtetërore, që nga organet e policisë e deri tek parlamentet.

Në këtë betejë mes të mirës dhe të keqes, roli dhe pozita e institucionit të prokurorisë – si një prej agjencive kryesore të administrimit të drejtësisë penale – është i dorës së parë dhe tepër i dallueshëm.

Ky punim, sikundër thuhet edhe në titull, është një paraqitje e rolit dhe pozitës së prokurorisë në shtetin modern, kryesisht në ato evropiane, për të përfunduar me analizën e legjislacionit dhe situatës faktike në vendin tonë.

**Roli i prokurorisë në zinxhirin e administrimit të drejtësisë penale**

Nocioni i *prokurorisë si institucioni shtetëror i veshur me pushtetin për të realizuar ndjekjen penale ndaj veprimeve (apo mosveprimeve) që janë përcaktuar nga ligji si veprime kriminale* është i njohur dhe i praktikuar në të gjitha shtetet moderne të botës, ndonëse nën emërtesa të dallueshme.

Në historinë e institucioneve, shërbimi i prokurorisë i gjen rrënjët e tij si në konceptin e "ministère public" francez të përpunuar në Kodin e Napolonit në fillimin e shek. XIX, sipas të cilit janë zyrtarët publikë ata që kanë monopolin mbi ndjekjen penale, brenda një sistemi inkuizitor, ashtu edhe në modelin anglo-sakson të ndjekjes penale, që mund të fillohet si nga i dëmtuari/viktima ose nga policia, në një sistem akuzator.[1]

Në Rekomandimin REC (2000) 19 të datës 6.10.2000, të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës mbi "Rolin e Prokurorit publik në sistemin e drejtësisë", jepet edhe përkufizimi, sipas të cilit "**Prokurorët publikë janë autoritete publike, të cilët në emër dhe për llogari të shoqërisë dhe për interesa publike sigurojnë zbatimin e ligjit aty ku shkelja e ligjit parashikon një sanksion penal, duke marrë parasysh si të drejtat e individit ashtu edhe efektivitetin e nevojshëm të sistemit të drejtësisë penale**".

Përpjekjet për të qenë në konformitet me kriteret e mësipërme e kanë shndërruar sistemin e drejtësisë penale në ditët tona në një sistem tepër të komplikuar dhe të kushtueshëm. Ndërsa numri i krimeve ordinere është në shifra të larta dhe i atyre të sofistikuara në rritje, gjykatat janë të mbingarkuara dhe shpeshherë çështjet gjykohen në kufijtë e afateve procedurale.

Është mëse e nevojshme, madje e domosdoshme ekzistenca e filtrave që do të mundësojnë rregullimin e fluksit të çështjeve drejt gjykatës, duke lejuar vetëm ato për të cilat ka prova të mjaftueshme fajësie. Dështimi për të arritur dhe mbajtur standardet e kërkuara që sigurojnë se fajësia është provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, do të shkaktonte humbjen e besimit të qytetarëve tek shteti i të drejtës, me pasojat mjaft të dëmshme që kjonënkupton. Pikërisht, pozicioni si "gate-keeper" i sistemit, është edhe roli i prokurorisë në administrimin e drejtësisë penale.



Shërbimi i prokurorisë realizon (minimalisht) funksionet që vijojnë:

i. ka kompetencë të mbledhë vetë informacion mbi sjelljet e të dyshuarve për një krim, ose të instruktojë policinë për ta bërë këtë;

ii. në bazë të këtij informacioni ai ka kompetencë të akuzojë një të dyshuar;

iii. përfaqëson gjatë gjykimit interesat e publikut/shtetit.

Në mënyrë empirike, edhe *komisionet hetimore* (që janë pjesë e legjislativit) shpesh hetojnë mbi veprime të supozuara kriminale të kryera nga funksionarë të ekzekutivit gjatë zbatimit të detyrave të tyre. Megjithatë, kompetenca e këtyre komisioneve dallon jashtëzakonisht nga ato të prokurorisë. Së pari, ato nuk janë pjesë permanente e shërbimit që kryen ndjekjen e krimit dhe veprimtaria e tyre bazohet në diskrecionin e parlamentit. Për më tepër, fokusi i tyre është i kufizuar[2].

**Pozicioni i prokurorisë në skemën e tre pushteteve dhe (pa)varësia funksionale**

Në botën moderne, falë futjes dhe adoptimit të ideve të reja politike mbi demokracinë, shtetin e së drejtës dhe ndarjen e pushteteve, nocioni prokurorisë i është nënshtruar ndryshimeve të vazhdueshme, në shumë drejtime.

Aktualisht, prokuroritë në shtetet moderne janë të pozicionuara:

a) në varësinë direkte të ekzekutivit (si p.sh në Sh.B.A., ku Prokurori i Përgjithshëm është anëtar i Kabinetit të Presidentit), apo si

b) institucione të pavarura.

Në rastin e parë, teorikisht, por edhe praktikisht, ekziston mundësia që kjo marrëdhënie të çojë në situata ku akuza publike ose të akuzojë njerëz përmes provave të falsifikuara (si në Rusinë e Putinit), ose të refuzojë njoftimin e akuzës ndaj njerëzve *de facto* të arrestuar (duke i sfilitur ata në një gjendje ligjore pambarimisht të harruar – si në rastin e të burgosurve në kampin e "Guantánamo Bay", Kubë) mjaft që kjo ti shërbejë qëllimeve të politikës.[3]

Në rastin e dytë, hierarkia e prokurorëve është instaluar me të njëjtat (apo pothuajse me të njëjtat) liri që tradicionalisht gëzohen edhe prej gjyqtarëve. Ata janë përgjegjës kryesisht vetëm ndaj parlamentit dhe shefi i tyre (kryeprokurori) është përgjithësisht i zgjedhur për një periudhë mjaft të gjatë kohore ose dhe përjetësisht. Në terma të teorisë politike, kjo duhet kuptuar sikur prokuroria e pavarur bëhet kolona e katërt në arkitekturën e ndarjes së pushteteve, krahas më legjislativin, ekzekutivin dhe gjyqësorin.[4]

Në respekt të normave të njohura e të gjithë pranuara demokratike, shtetet individuale kanë mundësi të gjera në lidhje me rregullimin si të statusit, ashtu edhe të të drejtave të prokurorit publik. Rrjedhimisht, shërbimi i prokurorisë mund të organizohet:

a) në lidhje të ngushtë me ekzekutivin (madje të jetë edhe një pjesë integrale e tij – ShBA),

b) relativisht i lidhur me të (Austri, Gjermani[5], Poloni etj.),

c) ndryshe, ai mund të pozicionohet totalisht i ndarë nga ekzekutivi dhe, sëbashku me gjyqësorin, të përbëjnë të ashtuquajturën "magjistraturë", gjë që duket se përbën edhe modelin më të përhapur në Europë.[6]

Sidoqoftë, përtej pozicionit *de jure* në organigramën shtetërore, ajo çfarë realisht vlen të diskutohet në lidhje me institucionin e prokurorisë është pavarësia e tij nga pushtetet e tjera, e në mënyrë të veçantë nga ekzekutivi (është i njohur fakti se qëllimi origjinal i trupëzimit për herë të parë në një kushtetutëtë – në Kushtetutën e ShBA-së – të parimit të *ndarjes së pushteteve* dhe *kontrollit dhe balancës* ishte parandalimi i tiranisë së ekzekutivit)[7].

Në ditët e sotme, "shteti i së drejtës" dhe "ndarja e pushteteve" janë shenja dalluese të të gjithë mendimit filozofik, ligjor dhe shtetformues perëndimor. Zbatimi praktik i gjithë çfarë këto dy teori nënkuptojnë supozohet se garanton liritë e individit dhe barazinë e tij politike, që, në fund të fundit, është edhe qëllimi themelor e në funksion të të cilit janë ideuar ato.

Ndarja e pushteteve nënkupton një ndarje funksionale të punëve ndërmjet legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit. Kjo ndarje mbështetet nga një dallim i qartë institucional, me ndonjë mbivendosje të studiuar për të realizuar kontrollin dhe balancimin e secilës degë të pushtetit, në mënyrë që të parandalohet përqendrimi i tij në një degë të vetme.

Funksioni i gjyqësorit në këtë kuadër është pak a shumë:

1) të vendosë nëse veprime të kryera nga anëtarët e dy degëve të tjera janë brenda kornizës së shtetit ligjor, dhe

2) të gjykojë mosmarrëveshjet ndërmjet individëve dhe të vendosë nëse individë të caktuar duhen penalizuar sepse ata dhunuan ligjin.[8]

**Në mënyrë që të përmbushë rolin e tij si gardian i shtetit të së drejtës, gjyqësori duhet të jetë i pavarur nga degët e tjera të qeverisjes. Por gjyqësori nuk mund të iniciojë vetë procedura gjyqësore. Ky tipar është veçanërisht domethënës përsa i përket rolit të tij për të penalizuar dhunimin e ligjit, pasi e drejta për t'iu drejtuar gjykatës [në lidhje me çështje penale] është kryesisht një monopol që mbahet nga autoritetet e prokurorisë. Pikërisht për këtë, argumentohet se pavarësia e gjyqësorit mund të pritet të shpalosë funksionet e saj dobiprurëse vetëm nëse edhe prokuroria gëzon pavarësi nga organet e ekzekutivit, si në kuptimin personal ashtu edhe në atë funksional.[9]**

Me fjalë të tjera, këtu është në lojë pasiviteti i gjykatësit, që [...] është një kufizim i pushtetit të tij dhe në të njëjtën kohë një garanci për paanshmërinë e tij, ose një vlerë, nevoja për të cilën ndjehet jashtë mase në procesin penal,

ku të drejtat e individit përballen me pretendimin ndëshkues të shtetit.[10]

Çështja e varësisë apo pavarësisë së shërbimit të prokurorisë mund të shikohet nga këndvështrime të ndryshme, duke qenë se niveli i (pa)varësisë është rezultat i ndërveprimit të një numri jo të vogël elementësh. Doktrina[11] bën dallimin mes (pa)varësisë së brendshme dhe të jashtme, si dhe mes aspekteve institucionale dhe funksionale të saj.

*(Pa)varësia e jashtme*

Kjo ka të bëjë me pyetjen se "me kë pushtet shtetëror është e lidhur (apo është në varësi) shërbimi i prokurorisë?", duke nënkuptuar me pushtete shtetërore ato të artikuluara nga teoria e "*Trias Politika*" e Montesquieu: legjislativin, ekzekutivin dhe gjyqësorin.

Në disa vende, varësia institucionale përkon me autonominë funksionale (Britani e Madhe).

Në vende të tjera (Francë, Belgjikë, Gjermani, Holandë) varësia institucionale është kombinuar edhe me varësinë funksionale. Prokuroria këtu vepron nën mbikëqyrjen e Ministrit të Drejtësisë, i cili mund të hartojë udhëzime në lidhje me vendimet që duhet të marrin prokurorët[12].

Ndërsa në Itali, shërbimi i prokurorisë është i lidhur me pushtetin gjyqësor. Për pasojë, këtu prokuroria është një institucion i pavarur me autonomi të plotë funksionale.

*(Pa)varësia e brendshme*

Kjo është e lidhur me strukturën e brendshme të prokurorisë – e centralizuar apo e decentralizuar – dhe me lidhjen hierarkike.

Në Britani prokuroria është shumë e decentralizuar.

Në Francë, Belgjikë dhe Holandë struktura është shumë e centralizuar dhe e karakterizuar nga një varësi hierarkike.

Struktura e brendshme e prokurorisë italiane është e decentralizuar dhe pa ndonjë varësi hierarkike. Pavarësia e prokurorëve ngjason me atë të gjyqtarëve. Ndërkohë, prokurorët italianë nuk janë të pajisur me pushtet diskrecionar në lidhje me veprimtarinë e tyre, pasi Italia aderon totalisht në *parimin e ligjshmërisë*[13].

Në shumicën e vendeve shërbimi i prokurorisë është i organizuar së brendshmi në mënyrë hierarkike. Drejtuesi i prokurorisë ka pushtetin të lëshojë udhëzime apo instruksione për vartësit e tij. Ky pushtet kufizon autonominë e brendshme të prokurorëve dhe influencon në nivelin e pavarësisë së tyre.

Më tej, (pa)varësia e prokurorisë (realisht e prokurorëve, pasi janë individët që përbëjnë institucionin dhe jo anasjelltas) është edhe rezultat i një serie normash e procedurash që kanë të bëjnë me *emërimin*, *zgjedhjen* dhe *caktimin në funksion* të prokurorëve, si dhe të *promovimit* dhe *largimit* të tyre nga detyra[14].

Duke qenë se caktimi në detyrë i prokurorëve të niveleve të ultë, për shkak të aplikimit të parimit të hierarkisë, u takon kryesisht prokurorëve më të lartë (apo ministrit të drejtësisë) dhe funksionon përgjithësisht duke u bazuar tek meritat personale-profesionale, është pikërisht caktimi (propozimi, miratimi) i kryeprokurorit ai që gjykohet të jetë vendimtar në lidhje me pavarësinë e institucionit, pasi ai vendos mbi një seri çështjes të brendshme të tij (p.sh e drejta për të nxjerrë udhëzime)[15].

Ndryshe nga sistemi ligjor amerikan – ku prokurorët e shtetit janë si rregull të zgjedhur nga vota e popullit, – në Europë, përgjithësisht, prokurorët janë funksionarë të emëruar. Zgjedhja e tyre duhet konsideruar më saktë si një *caktim*, pasi asnjë element demokratik nuk është dominues në këtë procedurë[16].

Moment tjetër kyç në lidhje me rolin e prokurorisë dhe pavarësinë e saj është edhe *kontrolli* apo *llogaridhënia*.

Në vendet ku shërbimi i prokurorisë është pjesë e ekzekutivit, shefi i këtij shërbimi "jep llogari" përpara parlamentit në lidhje me politikat e ndjekura nga institucioni që ai drejton. Rregulli është që ai nuk informon për ushtrimin e detyrës në lidhje me raste të veçanta. Ai është përgjegjës vetëm në respekt të faktit nëse ka nxjerrë ose jo udhëzime mbi politikat e punës.

Ndërkohë, kushdo që ka një interes lidhur me ndjekjen e një ngjarjeje të supozuar kriminale mund të regjistrojë një ankesë ndaj çdo veprimi të prokurorit në gjykatën pranë të cilit funksionon ky i fundit[17].

"Lidhja" e vetme e funksionit të prokurorisë me politikën (ekzekutivin, legjislativin) qëndron në dy pikëpamje. *Së pari*, ekziston një mënyrë e të konsideruarit të punës së prokurorisë nën një "politikë kriminale" të caktuar, pjesë integrale e kornizës politike të hartuar (konform ligjit dhe kushtetutës) nga organet politike të shtetit – legjislativi dhe ekzekutivi – politikë e cila varjon bazuar tek tiparet specifike të forcës politike që ka pushtetin në vend. *Së dyti*, bëhet fjalë për ato raste kur shërbimi i prokurorisë (dhe në vijim edhe gjyqësori) gjenden të përfshirë në çështje me protagonistë elementë funksionarë të dy pushteteve të tjerë të shtetit[18].

Megjithatë, parimi i ndarjes së pushteteve dhe i pavarësisë së gjyqësorit kërkon që masat legjislative dhe administrative përmes të cilave vihet në efiçencë një politikë e caktuar kriminale të mos shkelin kufijtë e territorit gjyqësor, i cili është i vetmi që përcakton faktet mbi të cilat do të jepet dënimi dhe që vendos se çfarë dispozitash ligjore do të aplikohen në lidhje me këto fakte.

Për pasojë, çdo lloj ndikimi i legjislatorit apo ekzekutivit mbi gjyqësorin duhet parë si e ndaluar, përveçse në formën e masave të përgjithshme e abstrakte të drejtuara për të ardhmen.

Në këtë kontekst, duke u rikthyer tek prokuroria dhe pavarësia e saj, problemi kryesor qëndron në faktin nëse, nga këndvështrimi i garancive, ajo duhet të konsiderohet si pjesë e trupit gjyqësor. Si argument për këtë qëndron observimi që gjykatat nuk munden të iniciojnë procedura *ex propio motu.* Për pasojë, nëse shërbimit të prokurorisë nuk i jepet e njëjta pavarësi si edhe gjyqësorit, garancitë e pavarësisë së këtij të fundit do të jenë të pamjaftueshme[19].

**Prokuroria në Shqipëri**

*Pas kësaj trajtese bazuar tek doktrina perëndimore mbi rolin e prokurorit në shtetin modern dhe pozicioni i tij në këndvështrimin e teorisë së ndarjes së pushteteve, në vijim materiali do të fokusohet tek sendërtimi shqiptar i sa më sipër.*

Kushtetuta e RSH parashikon në nenin 148:

1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj.

2. Prokurorët janë të organizuar dhe funksionojnë pranë sistemit gjyqësor si një organ i centralizuar.

3. Në ushtrimin e kompetencave të tyre prokurorët u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve.

Nga leximi i nenit 148 të sipërcituar mund të deduktojmë një sërë tiparesh të prokurorisë shqiptare:

i. në dallim nga koncepti komunist i viteve nën diktaturë, ku prokuroria para së gjithash kishte për funksion të saj *kontrollin e zbatimit të saktë dhe uniform të ligjeve*, funksioni i prokurorisë sot është *ndjekja penale dhe përfaqësimi i akuzës në gjyq.*[20]

ii. ajo konsiderohet si "prokuroria e shtetit" (v. asaj "publike");

iii. veç ndjekjes penale dhe përfaqësimit në gjyq të akuzës, ligji (Kodi i Procedurës Penale – tani e në vijim KPP) i ngarkon asaj edhe detyra të tjera (p.sh ndjekja e ekzekutimit të vendimeve penale të dhëna nga gjykata).

iv. Kushtetutbërësi shqiptar nuk e ka vendosur prokurorinë as si pjesë integrale të ekzekutivit (rasti ShBA), as nën varësinë e tij (Gjermani), por as nën varësinë strikte të gjyqësorit (Itali, Spanjë, Portugali, etj. ku prokurori për pothuajse çdo veprim duhet të konsultohet apo të marrë leje nga gjyqtari i çështjes). **Prokuroria në RSH është një autoritet/institucion shtetëror i pavarur (në kuptimin që nuk varet nga ndonjë pushtet tjetër por vetëm nga Kushtetuta dhe ligji) i mirëdallueshëm në spektrin institucional shtetëror, e që organizohet e funksionon pranë sistemit gjyqësor.**

v. Prokuroria shqiptare është e organizuar në mënyrë të centralizuar.

Nga studimi i ligjit "Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në RSH" dhe nga KPP të RSH, në vijim rezulton se:

iv. Prokuroria funksionon si një organ hierarkik;[21]

v. Prokuroria shqiptare, ndonëse Kushtetuta jonë nuk parashikon asgjë në këtë drejtim[22], për arsye faktike të adoptimit nga ana e legjislatorit të një KPP shumë të ngjashëm me atë italian (shumë nene janë përkthime identike), e gjen veten si zbatuese e *parimit të ligjshmërisë* – gjë që do të thotë se prokurori shqiptar nuk mund të ushtrojë diskrecion në lidhje me fillimin e çështjes; ndjekja penale duhet të fillojë në lidhje me të gjitha rastet e raportuara në të cilat ka tregues të mjaftueshëm se një vepër penale është konsumuar (përveç rasteve kur ligji e ndalon ndjekjen penale[23]).

vi. Gjithashtu, çdo veprim i prokurorit është i kontrollueshëm dhe i ankimueshëm në gjykatë[24].

Neni 149 i Kushtetutës vijon me mënyrën dhe procedurën e emërimit dhe shkarkimit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe prokurorëve të tjerë:

1. Prokurori i Përgjithshëm emërohet nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit.

2. Prokurori i Përgjithshëm mund të shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të Kuvendit, për shkelje të Kushtetutës ose për shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, për paaftësi mendore a fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e Prokurorit.

3. Prokurorët e tjerë emërohen dhe shkarkohen nga Presidenti i Republikës me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm.

4. Prokurori i Përgjithshëm informon herë pas here Kuvendin për gjendjen e kriminalitetit.

Duke iu referuar të ashtuquajturave *travaux préparatoire* për hartimin e Kushtetutës (botimi "Debati Kushtetues", vëllimi 2, faqet 94-100, 325-329) kuptoj se sa i madh ka qenë interesi i politikës së kohës për rolin, statusin dhe funksionet e Prokurorit të Përgjithshëm (individualisht, dukshëm në dallim nga interesi për prokurorinë si institucion në përgjithësi). Nuk mund të mos theksoj si faktor mjaft të rëndësishëm në lidhje me këtë edhe praktikën e deri atëhershme të trajtimit politik të këtij funksionari(!).

Në analizë të fundit, ajo çfarë kemi sot, 8 vjet pas miratimit të Kushtetutës, është një Prokuror i Përgjithshëm, i cili emërohet nga Presidenti i Republikës, me pëlqimin e parlamentit. Mes një numri jo të vogël variantesh të njohura në botë (të paktën 6[25]), në opinionin tim, ne kemi adoptuar një mënyrë zgjedhjeje, e cila përfshin në mënyrë të konsiderueshme e pa asnjë ekuivok përfaqësuesin e sovranit – parlamentin, por duke ia lënë kompetencën

ligjore përfaqësuesit të unitetit kombëtar (që jo rastësisht ka edhe një mandat më të gjatë se i pari) – Presidentit të Republikës.

Diçka duket se ndryshon në rastin e shkarkimit. Tanimë nuk është Presidenti ai që inicion procedurën, por Kuvendi. Nga ana tjetër, duhet "pëlqimi" i detyrueshëm i Presidentit që vullneti i shumicës të Kuvendit të sendërtohet ligjshmërisht. Kjo procedurë, mbështetur në një logjikë sempliste e të paanshme, duhet të ishte e kundërta simetrike e momentit të dhënies së pëlqimit nga Kuvendi, përpara emërimit nga Presidenti. Është e qartë për të gjithë që, propozimi i Presidentit nuk është detyrues; për pasojë asnjë individ (me çfarëdolloj kredencialesh) nuk do të mund të ulej në karrigen e kryeprokurorit të Republikës, nëse Kuvendi nuk do të votonte në shumicë "pro" dekretit përkatës presidencial. Pra, roli i Kuvendit gjatë emërimit është determinant. Në lidhje me shkarkimin mekanizmi është përmbysur.

Pra në një përballje mes konceptit të *demokracisë* (pushtetit të shumicës), të mishëruar tek parlamenti dhe shumica e thjeshtë që nevojitet për të dhënë pëlqimin (e quajtur ndryshe edhe "qeverisëse" e që identifikohet lehtë edhe me kryeministrin) dhe konceptit të Republikës (*res publica* – gjëja publike, ose e mira e përgjithshme), baballarët e Kushtetutës shqiptare, besoj për arsye të forta, kryesisht historike, ia besuan fjalën e parë dhe të fundit pikërisht Presidentit të Republikës, në mënyrë të tillë, që Prokurori i Përgjithshëm i shtetit (Republikës) të ishte sa më larg interesave meskine, të ngushta dhe shpesh të përkohshme të politikës[26].

Nga ana tjetër, nuk ka nevojë për asnjë argument ligjor, politik a filozofik që të shprehem se koha dhe *mënyra* sesi kërkohet nga Kuvendi shkarkimi i Prokurorit më të lartë të vendit, padyshim që ndikon në pavarësinë e krejt institucionit që ai drejton. Natyrisht që nuk mund të jetë kështu kur bëhet fjalë për një kauzë të drejtë dhe bindëse. Në këtë rast, të vetmit që do të trembeshin do të ishin prokurorët e kriminalizuar.

**Quis custodiet ipsos custodiet?**

Në mënyrë që të ruhet besimi i publikut dhe mbështetja e tij ndaj shtetit ligjor, prokuroria (e përfaqësuar nga Prokurori i Përgjithshëm) është nën një detyrim të vazhdueshëm për të demonstruar se edhe ajo i respekton ligjet. Në këtë kontekst, sugjerohen ngritja e të ashtuquajturave "checks & balances" për të provuar integritetin e institucionit.[27]

Komponentin "llogaridhënie" të prokurorit të përgjithshëm, kushtetuta (neni 149/4) e ka ndërtuar në formën e një detyrimi të të parit për të informuar përfaqësuesit e popullit "herë pas here"(?). Kjo paqartësi ka marrë përgjigje në Ligjin Nr.8737, datë 12.2.2001, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në RSh":

Neni 53 "Marrëdhëniet me Kuvendin"

1. **Prokurori i Përgjithshëm informon Kuvendin ose komisionet parlamentare të paktën një herë ne gjashtë muaj ose sa herë që kërkohet prej tyre**. Njoftimi përmban të dhëna dhe shpjegime për numrin, llojet, shtrirjen territoriale, intensitetin dhe format e kriminalitetit në Republikën e Shqipërisë, si dhe drejtimet dhe përparësitë në luftën ndaj kriminalitetit.

2. Nuk lejohet njoftimi për çështje konkrete, me përjashtim të çështjeve të dërguara me vendim të Kuvendit.

3. Kuvendi mund t'i kërkojë Prokurorit të Përgjithshëm sugjerime për rregullimin ligjor të çështjeve të ndryshme.

4. Prokurori i Përgjithshëm bashkëpunon me komisionet e hetimeve parlamentare sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Kuvendi, në kontekstin e të drejtës kushtetuese të shtetasve për të marrë informacion në lidhje me çështjet e interesit publik, në respekt të parimeve kushtetuese, mund të ushtrojë mbi Prokurorinë edhe kontrollin parlamentar (të ngrejë komisione hetimore). Megjithatë, Gjykata Kushtetuese, përmes Vendimit nr.26/2006, "vlerëson se mjetet e *kontrollit parlamentar mbi Prokurorinë nuk mund të përdoren asnjëherë, si instrument për të shqyrtuar dhe vlerësuar vendimet* e marra nga ana e prokurorëve *për çështje konkrete*. Parlamenti mund të ndikojë në institucionin e Prokurorisë vetëm nëpërmjet pushteteve të tij *ligjvënëse*."

Ligji organik i prokurorisë parashikon gjithashtu edhe marrëdhënien e prokurorisë me ekzekutivin:

Neni 54 "Marrëdhëniet me Këshillin e Ministrave"

1. Çdo vit, jo më vonë se data 31 Mars, Ministri i Drejtësisë, në emër të Këshillit të Ministrave, i përcjell Prokurorit të Përgjithshëm rekomandimet që duhet të mbahen parasysh për vitin në vazhdim në luftën kundër kriminalitetit.

Neni 56 "Marrëdhëniet me Ministrinë e Drejtësisë"[28]

1. Ministri i Drejtësisë kontrollon në mënyrë të planifikuar ose në bazë të informacioneve të dhëna nga organe, institucione ose persona të interesuar, **ligjshmërinë e veprimtarisë së prokurorëve**.

2. Objekti i kontrollit të Ministrisë së Drejtësisë në organin e prokurorisë është:

a) ndjekja e ecurisë së çështjeve që përmbahen në rekomandimet vjetore të dhëna nga Këshilli i Ministrave për luftën kundër kriminalitetit;

b) respektimi i afateve të hetimit;

c) respektimi i afateve të paraburgimit;

ç) respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të subjekteve të procedimit penal dhe në veçanti, të të ndaluarve dhe të arrestuarve;

d) rregullshmëria dhe vijueshmëria e kryerjes të veprimeve hetimore;

dh) respektimi i detyrimit ligjor të prokurorit për fillimin

e ndjekjes penale;

e) ecuria e politikes penale dhe, ne veçanti e politikës së dënimeve që ndiqet nga prokurorët:

ë) rregullshmëria e mbajtjes dhe administrimit të statistikave dhe regjistrimit te veprave penale;

f)respektimi i parimeve të drejtësisë, barazisë dhe ligjshmërisë së veprimtarisë së prokurorit në marrëdhëniet e tij me subjektet e tjera të procedimit penal.

3. Kontrolli në çdo rast duhet të jetë i paralajmëruar dhe për çështje për të cilat kanë përfunduar hetimet paraprake.

4. Për rezultatin e kontrollit vihet në dijeni Presidenti i Republikës, Prokurori i Përgjithshëm dhe prokurori veprimtaria e të cilit ka qenë objekt kontrolli.

Përveçse sa më sipër, "llogaridhënia", apo më mirë të them "kontrolli" ndaj veprimtarisë praktike të prokurorisë në bazë të legjislacionit shqiptar realizohet edhe në dy nivele të tjera:

1) *nga brenda* shërbimit të prokurorisë; prokurori më i lartë ka të drejtë të kontrollojë punën e një prokurori më të ulët si dhe ta udhëzojë atë[29];

2) *nga jashtë*, në kuptimin që çdo veprim i prokurorit në lidhje me një çështje të caktuar mund të ankimohet në gjykatën pranë të cilit funksionon shërbimi i prokurorisë.

**Në vend të përfundimeve**

Ky punim, duke qenë kryesisht me karakter përshkrues, informativ, nuk kishte për synim kryesor të vetin daljen me konkluzione në lidhje me institucionin e prokurorisë. Nga ana tjetër, nuk mund të anashkaloj faktin se situata aktuale politike (që, në njëfarë mënyre, funksionoi si nxitës për realizimin e këtij studimi) prej disa muajsh ka në qendrën e vet pikërisht institucionin e prokurorisë. Në këtë kontekst, gjykoj se është e dobishme pjesëmarrja e sa më shumë juristëve në debat, në mënyrë që të përfitohet më e mira e mundshme.

Një forcë e re politike ka ardhur në pushtet. Drejtuesit e saj zhvilluan një fushatë zgjedhore në moton e "zero tolerancës" ndaj krimit, veçanërisht ndaj atij të korrupsionit. Është plotësisht i kuptueshëm interesi i ekzekutivit shqiptar dhe i shumicës qeverisëse në Kuvend, në lidhje me aktorët institucionalë që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në këtë luftë.

Ndërkohë, siç shpjegova më lart, roli i prokurorisë në luftën ndaj krimit është tepër specifik. Praktikisht, dihet që në fund do të jetë gjykata, pra një tjetër pushtet – i pavarur – përtej legjislativit dhe ekzekutivit, që do të dënojë përfundimisht shkelësit e ligjit. Në mënyrë që të ruajë këtë pavarësi, si dhe paanshmërinë e nevojshme për të realizuar një gjykim konform kërkesave të procesit të rregullt, gjykata nuk mund dhe nuk duhet të iniciojë *ex propio motu* procedurat gjyqësore. Këtë funksion ligji (i frymëzuar nga doktrina e ndarjes së pushteteve) ia njeh prokurorisë. Në përmbushje të këtij funksioni, duke qenë se ngjarjet apo sjelljet që mund të marrin rëndësi penale i tejkalojnë si aftësitë e ndërhyrjes publike ashtu edhe burimet që janë në dispozicion për këtë, prania e filtrave seleksionues është e pashmangshme në praktikë. Veçanërisht në lidhje me këtë, roli i prokurorisë fiton një rëndësi të posaçme: veprimet dhe vendimet e vëna në jetë nga prokurori[30] marrin pjesë efektivisht në formulimin dhe sidomos në vënien në zbatim të politikave penale. Në vijim, është po prokurori pala që përfaqëson në mënyrë institucionale shtetin në procedimet përkatëse. Pikërisht sa më sipër janë edhe arsyet se pse qarqet politiko-vendimmarrëse janë kaq shumë të interesuara për prokurorinë.[31]

Si për paradoks, është po monopoli i prokurorisë për të penalizuar dhunimin e ligjit dhe fakti që gjyqësori nuk mund ta bëjë vetë këtë, që e bën pavarësinë e prokurorisë një kusht *sine qua non* për pavarësinë e gjyqësorit; nevoja dhe dobia e kësaj të fundit është e padiskutueshme.

Kjo marrëdhënie vazhdimisht e tendosur mes politikës dhe sistemit të drejtësisë (gjyqësor & prokurori) duket se ka baza të hershme, që na çojnë tek lëvizjet masive evropiane kundër monarkive absolute dhe parlamentet e parë, produkte të revolucioneve demokratike-borgjeze (p.sh Francë 1789). Është pikërisht kjo periudha historike kur, nën ndikimin e Iluminizmit, pikëpamja se ligji nuk ishte gjë tjetër veçse "vullneti i përgjithshëm" (i shumicës natyrisht) fitoi mjaft terren dhe nisi të predominojë jo vetëm në Europën kontinentale por edhe jashtë saj, në vendet e *common law*. U desh të kalonin shumë vite dhe dy Luftëra Botërore që pikëpamja tjetër, ajo që e paraqet ligjin si produkt të kulturës ligjore dhe jo vetëm të vullnetit të politikës të merrte sërish jetë, e bashkë me të, të njihej edhe pohimi se ekzistojnë parime ligjore të cilat janë të paprekshme, madje edhe nga autoritetet politike dhe se rendi ligjor është një sistem racional konceptesh i zhvilluar nga gjyqtarët dhe juristët e tjerë, pohim që kulmoi pas Luftës II Botërore me përhapjen e paimagjinueshme të konceptit të *kontrollit kushtetues* të ligjeve, ligje që nxirreshin pikërisht prej përfaqësuesit të sovranit – parlamentit.[32]

Personazhe të ndryshme, kryesisht të botës së politikës, kanë hedhur së fundi idenë se prokuroria duhet të vendoset pranë ekzekutivit. Meqenëse historikisht, prokuroria moderne e ka origjinën e saj tek ekzekutivi, personalisht më duket kjo nevojë e ekzekutivit gati, gati, si një nevojë fiziologjike, subkoshienciale, e trupit në kërkim të organizmit të humbur...

Ndërkohë harrohet, apo nuk merret parasysh tendenca e padiskutueshme, të paktën në Europë[33], drejt një prokurori publik me akoma më shumë pavarësi *vis-à-vis* politikës dhe e lidhjes së statusit të tij gjithnjë e më shumë me atë të gjyqtarit.[34]

Rezervat, apo me raste, armiqësia e hapur, e gjejnë bazën tek "mungesa e supozuar e legjitimitetit" të prokurorisë, mungesë që rrjedh nga largësia e institucionit nga ekzekutivi dhe gjyqësori. Argumenti në lojë është ai se "legjitimiteti i dhënë përmes zgjedhjeve duhet të përshkojë të gjitha pushtetet demokratike, përfshi këtu edhe prokurorinë dhe se kjo e fundit, nëse do të lihet të funksionojë *e vetme*, mund të bjerë pre e interesave të ngushta apo e influencave të paligjshme".[35]

Në botimin e Prezencës së OSBE në Shqipëri "Debati Kushtetues" (vëll. 2, fq. 94) thuhet shprehimisht se: "Fillimisht[36], Prokuroria u mendua të ishte pjesë e ekzekutivit, ose e thënë ndryshe nën autoritetin e ekzekutivit. Por kjo ide nuk gjeti konsensus [...]. Atëherë u mendua të bëjmë ose veprojmë ashtu siç kanë vepruar shumica e kushtetutave të tjera, d.m.th, nga njëra anë të mos përcaktojmë saktësisht dhe ngushtësisht një pozicion të caktuar të prokurorisë dhe, nga ana tjetër, ti japim këtij organi disa garanci konstitucionale që të mos nëpërkëmbet".

Personalisht mendoj se në parim, asgjë të keqe nuk do të kishte edhe nëse prokuroria vendoset pranë/në varësi të ekzekutivit. Problemi këtu nuk është edhe aq tek prokuroria, sesa tek ekzekutivi dhe politika në përgjithësi. Akuzat më të rënda të kësaj të fundit ndaj prokurorisë dhe kryeprokurorit janë pikërisht për stepje për të proceduar individë me imunitete apo lidhje politike. Nëse pranojmë se kështu ka ndodhur deri më sot, kur prokuroria ka qenë një institucion i pavarur që i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve, çfarë hetimesh për politikanë të korruptuar mund të presësh nesër kur ajo të jetë vënë në vartësinë e politikës?[37]

Nga ana tjetër, nisma penale, për karakteristikat e saj organike dhe veçanërisht për lidhjen e vet strukturore me institucionet politike, mund të përdoret lehtësisht për qëllime të tjera nga ato të shpallurat formalisht, ose të paktën, mund të krijojë dyshimin për një shfrytëzim militant të saj. Në fund të fundit, në shumë vende, ndërhyrja ndaj korrupsionit politik administrativ ofron një shembull emblematik të veprimit që është i aftë të kryejë funksioni hetimor dhe i ekspozimit të mundshëm ndaj interesave sektare.[38]

Shqetësimi i drejtë në lidhje me këtë keqpërdorim të mundshëm të prokurorisë mund të gjente ngushëllim tek ekzistenca e një gjyqësori të panjollë, plotësisht të pavarur nga presionet politike dhe të paanshëm në gjykim, por kjo duket ende larg, kur fare afër, më 6 nëntor, në *Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit 2006*, "Transparency International" e renditi Shqipërinë të 111 në botë, dhe gjyqësorin shqiptar, si institucionin e dytë më të korruptuar në vend.

Në këtë rreth vicioz, zgjidhja e Kushtetutës së 1998 duket se është pragmatikisht më e mira[39].

Kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë se sistemi i drejtësisë në përgjithësi dhe institucioni i prokurorisë si pjesë integrale e tij nuk kanë nevojë për reforma. Natyrisht reformat duhet të jenë ligjore dhe programatike, e jo thjesht ndërrime emrash.

Personalisht mendoj se ndër të tjera, edhe në Shqipëri ka ardhur koha që monopoli i prokurorisë së shtetit për të penalizuar shkeljet e ligjit të kufizohet përmes prezantimit të iniciativës private. Një reformë të tillë Hungaria e realizoi përpara 3 vjetësh (2003). Është e vërtetë se, në bazë të përvojës evropiane, e drejta individuale për të zhvilluar hetime ekziston në një kuptim të kufizuar, vetëm përsa i përket një serie veprash penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore (si p.sh. shpifja, fyerja apo cenimi i jetës private) dhe se ajo mund të ushtrohet vetëm në ato raste kur prokurori publik vendos të mos procedojë mbi rastin në fjalë[40], por gjithashtu, nuk mund të shpërfillet mundësia që ky mjet ofron për të zëvendësuar plogështinë e mundshme publike, ose edhe, në mënyrë të tërthortë, për të nxitur ndërhyrjen e organeve hetimore shtetërore pikërisht me qëllim që të parandalojë nismën private.

Debati është i hapur.

## Shënime Bibliografike


1. Rekomandimi REC (2000) 19 të datës 6.10.2000, i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës mbi "Rolin e Prokurorit publik në sistemin e drejtësisë".

2. Anne van Aaken, Eli Salzberger, Stefan Voigt "The Prosecution of Public Figures and the Separation of Powers: Confusion Within the Executive Branch", *German Working Papers in Law and Economics*, Vol. 2003, Paper 11, 2003.

3. Raoul Muhm , Gian Carlo Caselli (Hrsg.) "Die Rolle des Staatsanwaltes Erfahrungen in Europa – Il ruolo del Pubblico Ministero Esperienze in Europa – Le role du Magistrat du Parquet Expériences en Europe – The role of the Public Prosecutor Experiences in Europe", Vecchiarelli Editore Manziana (Roma) 2005.

4. *Ibidem*.

5. Këtu, kjo strukturë kulmon në dikasterin e drejtësisë. Është ministri ai, të cilit i përket përgjegjësia për të përcaktuar vijat udhëheqëse të politikave penale, për të cilat përgjigjet së bashku me qeverinë përpara parlamentit, për të formuluar direktivat me karakter për përgjithshëm, si dhe për tu dërguar udhëzime organeve hetimore lidhur me trajtimin e çështjeve të veçanta. Gjithashtu ministrit i takojnë edhe të gjitha masat që kanë të bëjnë me statusin e prokurorëve: me rekrutimin, me përparimin në karrierë dhe me nismën disiplinore.

6. Dokumenti CDL (2001) 134 i Komisionit të Venecias, raport nga Ms H. Suchocka (anëtare, Poloni).

7. Richard A. Brisbin, Jr., "The Judiciary and the Separation of Powers." The Institutions of American Democracy: The Judicial Branch. Ed. Kermit L. Hall & Kevin T. McGuire. New York: Oxford University Press, 2005.

8. *Supra* nr. 2.

9. *Ibidem.*

10. Karlo Guarnieri, Patrizia Pederzoli "Magjistratura në demokracitë bashkëkohore", Sh.B "Dituria", Tiranë, 2004.

11. Prof. Peter Tak "East Meets West - Aspects of Prosecution in Countries in Transition", *European Journal of Crime, Criminal Law and Criminal Justice*, Vol. 7/4, 412–432, 1999.

12. Sidoqoftë, në këto vende, pushteti i Ministrit të Drejtësisë për të dhënë instruksione kufizohet nga maksima "*la plume est serve, la parôle est libre*" (pena është skllave, fjala është e lirë), që nënkupton se prokurorët janë të lidhur (kufizuar) nga udhëzimet me shkrim të eprorit gjatë fazës procedurale paragjyqësore, por ata e rimarrin lirinë e tyre në momentin që i drejtohen gjykatës.

13. Diskrecioni i prokurorëve dallon nga vendi në vend në varësi të parimit që ka adoptuar sistemi respektiv i të drejtës (penale). Njihen dy parime: ai i "ligjshmërisë" (ose ndryshe i "detyrueshmërisë") dhe ai i "oportunitetit" (apo i "mundësisë").

**Parimi i ligjshmërisë** urdhëron që çdo çështje, në të cilën ka prova të mjaftueshme se një vepër penale është konsumuar, duhet të dërgohet në gjykatë.

**Parimi i oportunitetit**, në kontrast me sa më lart, për të njëjtat prova, i jep prokurorit diskrecion në lidhje me vendimin për të ndjekur penalisht apo për të adaptuar një zgjidhje tjetër (p.sh pajtim) të çështjes.

Një dallim tjetër mund të bëhet midis rregullimeve që vendosin *monopolin publik* të veprimit penal dhe atyre që, përkundrazi, lejojnë *veprimin privat*. Në rastin e parë, kompetenca përkatëse i përcillet vetëm prokurorëve, ndërsa në të dytin, të njëjtat prerogativa u njihen formalisht edhe qytetarëve individualë (*Supra* 9).

15. *Ibidem.*

16. *Supra* nr.2.

17. *Ibidem.*

18. Alessandro Pizzorusso "Public prosecution and politics", Raport Sesionit IV të Konferencës së Prokurorëve të Përgjithshëm të Europës, organizuar nga KE, Sllovaki, Qershor 2003. Dok. Nr. CPGE (2003) 03.

20. Duket se opinoni shqiptar, e veçanërisht strukturat e tij politike, ende nuk e kanë të qartë këtë ndryshim thelbësor të funksioneve.

21. Neni 4/3 "Ligjshmëria e veprimtarisë": Urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë jepen me shkrim dhe janë të detyrueshme për prokurorin më të ulët.

Shkalla e hierarkisë në organin e Prokurorisë përcaktohet nga Prokurori i Përgjithshëm, në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë ligj.

22. Kjo p.sh në dallim nga Kushtetuta italiane, neni 112 i së cilës thotë shprehimisht: "Prokuroria publike [il ministero pubblico – *në origjinal*] ka detyrimin të iniciojë veprimin penal".

23. Neni 290 i KPP.

24. Shiko p.sh nenet 278, 291, 325 apo 329 të KPP.

25. 1) Emërohet nga Parlamenti; 2) emërohet nga Presidenti me miratimin e Parlamentit; 3) emërohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë (emri i këtij institucioni është i ndryshëm në vende të ndryshme); 4) emërohet nga Ministri i Drejtësisë; 5) është vetë Ministri i Drejtësisë që bën edhe funksionin e kryeprokurorit; 6) zgjidhet d.p.d nga populli.

26. "Parimet e sanksionuara në ligjin "Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese", mbi të cilat mbështetej statusi i prokurorisë, gjetën pasqyrim edhe në Kushtetutën e vitit 1998. Kështu, organi i prokurorisë ruan në esencë po atë funksion, po ato parime organizimi, duke parashikuar gjithashtu, se në ushtrimin e kompetencave të tyre prokurorët u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve (neni 148). Për t'i thënë një theks më të dukshëm pavarësisë së prokurorisë, në raport me ligjin "Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese", Kushtetuta ndryshon, në esencë, procedurën e emërimit dhe të shkarkimit të Prokurorit të Përgjithshëm, duke mos ia lënë këtë proces vetëm një organi kushtetues, si dhe duke specifikuar në Kushtetutë shkaqet e shkarkimit." (citim nga Vendimi nr.26, datë 4.12.2006, i Gjykatës Kushtetuese).

27. HDS.ODIHR/26/06 (11 Maj 2006)

28. Ky nen është bërë sëfundi objekt debati dhe shkak për acarimin e marrëdhënieve ndërmjet Prokurorisë dhe Ministrisë së Drejtësisë.

29. Shiko për më tepër edhe Vendimin nr.56, datë 29.01.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

30. Janë të shumë faktorët që mund të ndikojnë mbi lirinë e vlerësimit që ushtron realisht prokurori gjatë hetimit. Përmenden që nga karakteristikat e normës penale, shtrirja e saj, rregullimi i strukturave hetimore (të centralizuara apo jo), karakteristikat dhe statusi profesional i prokurorëve si dhe marrëdhëniet e tyre me aktorët e tjerë: *së pari* me gjykatësit dhe *së dyti* me forcat e policisë, duke qenë se janë pikërisht këto të fundit që ndërhyjnë në segmentin e parë të të gjithë procedimit, në hulumtimet, duke dhënë lëndën e parë me të cilën ushqehet puna e prokurorit, por edhe duke kushtëzuar stadet e mëpasshme të procedurës (*Supra* 10).

31. *Supra* 10.

32. *Supra* 18.

33. Në Francë, vetëm disa vite më parë, dyshimi i përhapur për ndërhyrje të drejtpërdrejta të qeverisë në çështje politikisht të ndjeshme e kanë shtyrë Presidencën e Republikës të ngrejë një komision studimi të ngarkuar të propozojë vijat orientuese të një rishikimi legjislativ. Disa prej këtyre propozimeve u përfshinë më pas nga qeveria Zhospen në kuadrin e një pakete reformash për drejtësinë, në të cilin figuronte edhe amendamenti kushtetues, që do të duhej të forconte kompetencat e Këshillit të Lartë të Magjistraturës (*Conseil Supérieur de la Magistrature*) mbi prokurorët, përkundrejt kompetencave të Ministrit të Drejtësisë.

34. Marc Robert "The Prosecutor's Office and politics", Raport i Sesionit IV të Konferencës së Prokurorëve të Përgjithshëm të Europës, organizuar nga KE, Sllovaki, Qershor 2003. Dok. Nr. CPGE (2003) 03.

35. *Ibid.*

36. Gjatë debatit për hartimin e Kushtetutës 1998.

37. Një analizë tepër e detajuar në lidhje me këtë gjendet në punimin e Anne van Aaken, Eli Salzberger, Stefan Voigt "The Prosecution of Public Figures and the Separation of Powers: Confusion Within the Executive Branch", German Working Papers in Law and Economics, Volume 2003, Paper 11.

38. *Supra* 10.

39. Me një rezervë, në lidhje me mandatin e pakufizuar të Prokurorit të Përgjithshëm. Nisur nga ajo çfarë realisht ka ndodhur, mendoj se një kryeprokuror me një mandat të ngjashëm me atë të anëtarit të Gjykatës së Lartë (9 vjet), praktikisht do të ishte në kushte optimale për të ruajtur pavarësinë e tij, ndërkohë që edhe politika nuk do ta shikonte si "të pa ndryshueshëm".

40. *Supra* 11.

# Vdiq shkencëtari i shquar shqiptar, akademik Musa A. Haxhiu



Më datën 17 shtator 2007 morëm lajmin e hidhur se në Ohio të Amerikës, pushoi së rrahuri zemra e të ndriturit, shkencëtarit, fisnikut dhe atdhetarit të devotshëm Akademik Prof. dr. Musa A. Haxhiu.

Ai u lind me 15 mars 1939 në Pejë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje. Diplomoi në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd më 1963. Gjatë viteve 1964-67 punoi në Spitalin për mjekim të tuberkulozit "A. Kelmendi" në Pejë. Specializoi në Beograd në lëmin e sëmundjeve të mushkrive në vitin 1968. Studimet pasdiplomike në lëmin e kardiologjisë i përfundoi në Beograd më 1971. Në vitin 1973 në Universitetin e Zagrebit mbrojti tezën e doktoratës dhe promovohet Doktor i Shkencave të Mjekësisë. Po këtë vit Dr. Haxhiu vazhdoi edhe 6 muaj specializimin dhe studimet plotësuese në Postgraduate Medical School në Londër, Britani e Madhe.

Gjatë viteve 1973-75 emërohet Dekan i Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë dhe kjo periudhë ishte periudha më e ndritur e këtij fakulteti. Prof.dr Haxhiu bëhet emër i njohur i shkencave mjekësore, prandaj gjatë viteve 1975-76 qëndroi në Pennsylvania University, Philadelphia, SHBA. Në vitin 1978 ftohet në një qendër tjetër të fuqishme shkencore, Silikose-Forschungsinstitut der Bergau-Berufs-genossenschaft, Bochum, RF. e Gjermanisë.

Në vitin 1977 emërohet Profesor inordinar i Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë për lëndën Fiziologjia patologjike.

Në vitin 1979, bazuar në arritjet profesionale dhe shkencore zgjidhet anëtar me korrespondencë i ASHA-së së Kosovës.

Në periudhën 1978-79 emërohet Kryetar i Lidhjes së Shoqatave të Fiziologëve të ish-Jugosllavisë, anëtar i disa asociacioneve profesionale dhe shkencore në vend dhe jashtë tij. Në vitin 1980, Akademik M. Haxhiu sërish qëndroi në Institutin Silikose Forschungsinstitut der Bergau-Berufs-genossenschaft, Bochum - Gjermani. Në vitin 1982 ftohet në Case Western Reserve Universiry, Cleveland, Ohio, USA.

Në vitin 1983 emërohet Profesor ordinar në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Në vitin 1990 zgjidhet Kryetar i ASHA-së së Kosovës;

Gjatë këtyre viteve, Prof.dr Musa Haxhiu formoi Institutin e Fiziologjisë Patologjike. Në këtë Institut për herë të parë filluan punën eksperimentale kirurgët, gastroenterologët dhe specialistët e degëve tjera të mjekësisë interne. Prof.dr Musa Haxhiu dha kontribut të çmuar në zhvillimin e kuadrit akademik të lëmive biomjekësore. Për një periudhë të shkurtër u ngritën pedagogë dhe profesionistë që bënë emër në shkencat mjekësore në Kosovë dhe jashtë saj.

Të mos harrojmë edhe një fakt tjetër që mendojmë se ka peshë të madhe historike. Pas demonstratave antikomuniste të vitit 1981 në Kosovë, kur filloi ndjekja e "shtrigave" nga pushteti serb, në luftë kundër inteligjencës shqiptare të Kosovës, në diferencimin ideopolitik në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve, Akademik Musa Haxhiu me guximin e intelektualit të kalibrit më të lartë, kundërshtoi njëmendësinë moniste.

Prej vitit 1990 Prof. Haxhiu jetoi dhe veproi në Ohio të SHBA-së, por pa u ndarë asnjëherë nga Kosova dhe përkrahja e shkencëtarëve të rinj, të cilëve iu mundësoi përfundimin e tezave të doktoraturave në Amerikë.


Akademik Musa Haxhiu pa dyshim është ekperti më i cituar në literaturën shkencore botërore jo vetëm ndër mjekët shqiptarë por edhe atyre europianë.

Ka botuar disa tekste Universitare dhe mbi 400 punime, kumtesa dhe ligjërime shkencore në të gjitha revistat më të njohura botërore.

Kontributi shkencor dhe profesional i Akademik Musa Haxhiut i bën nder kombit tonë dhe humanizmit në tërësi.

**Prof. dr. Isuf Dedushaj, Dr. sci Avdyl Krasniqi**

# Këndi i librit




## Ritmet e jetës. Orët biologjike që kontrollojnë ekzistencën e çdo qenieje të gjallë

**Gjendet në çfarëdo qenieje të gjallë qoftë ajo një bakter, një krimb apo një njeri: është ora biologjike.**

**Eshtë ai mekanizëm evolucionar që dikton ritmet e jetës, ju thotë zogjve kur duhet të emigrojnë apo salmonëve kur është momenti për të depozituar vezët. Dhe neve na tregon se duhet të flemë, të hamë, të pimë…**

**Fiziologjia jonë kontrollohet nga ky "timer" i brendshëm e po kështu janë edhe emocionet tona, humori etj. Mjafton të kujtojmë këtu se disa njerëz i ze melankolia gjatë muajve të dimrit, mungesa e gjumit ndikon rendimentin dhe efikasitetin tonë ditor etj.**

**Njeri nga autorët e librit, Russell Foster, është docent i neuroshkencës molekulare në Imperial College në Londër dhe konsulent në Nasa për fluturimet e ardhëshme drejt Marsit; Leon Kreitzman, bashkëautor i librit, është gazetar i specializuar në studimin e ritmeve biologjike dhe ndërlidhjet e tyre sociale. Së bashku, ata ju shpjegojnë lexuesve një shkencë relativisht të re, kronobiologjinë dhe aplikimet e saj në fushën mjekësore.**

**Në mbyllje të vëllimit jepet edhe një fjalor i termave më të përdorur dhe një bibliografi e pasur për këtë temë.**